



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

**Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë,
Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës**
2009- 2015

Dhjetor 2008

Përmbledhja ekzekutive

1. Hyrje

1.1. Preambula

Vizioni dhe Qëllimet.....	4
Principet	6
Drejtësia	6
Falënderimet	7

1.2. Informata paraprake

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit në Kosovë	8
Refugjatët, Personat e Zhvendosur dhe Emigrantët	10
Konteksti	11

1.3. Metodologjia

Të përgjithshme	12
Zhvillimi	12
Sektorët prioritar	13

2. Sektorët e Strategjisë

2.1. Anti-diskriminimi	14
2.2. Arsimi	18
2.3. Punësimi dhe Fuqizimi Ekonomik	25
2.4. Shëndeti dhe Çështjet Sociale	31
2.5. Strehimi dhe Vendbanimet Joformale	37
2.6. Kthimi dhe Riintegrimi	44
2.7. Regjistrimi dhe Dokumentacioni	54
2.8. Çështjet Gjinore	60
2.9. Kultura, Mediat dhe Informimi	64
2.10. Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi Politik	69
2.11. Siguria (Puna Policore)	74

Miratimi, Monitorimi dhe Zbatimi i Strategjisë	78
--	----

Shkurtesat

ABGJ	Agjensioni për Barazi Gjinore
AIE	Agjensioni për Integritim Europiane
AKP	Agjencioni Kosovar i Pronës
AKP,	Drejtorati për Strehim dhe Pronë
APM	Asociacioni i Prindërve dhe Mësuesve
BDA	Unioni Demokratik i Ashkalijve
BE	Bashkimi Evropian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
CoE	Këshilli i Europës
DOW	Mjekët e Botës
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
ECHR	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
FCNM	Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve
FIK	Fushatat e Informimit dhe Edukimit
GP	Grupi Punues
UN-HABITAT	United Nations Human Settlements Programme
ICCPR	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
ICESCR	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
ICRC	Komiteti i kryqit të Kuq Ndërkombëtar
IEK	Informimi, edukimi dhe komunikimi)
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
ILO	IPEC-Organizata Ndërkombëtare e Punës
IO	Institucioni i Ombudspersonit
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës
IRDK	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
KASH	Kornizën Afatmesme e Shpenzimeve
KÇP	Komisioni për Çështjet e Pronës
KCPSD	Qendra Kosovare për Edukim dhe Zhvillim të Sigurisë Publike
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KEDKG	Konventa për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave
KEDNJ	Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale
KEK	Energjetike e Kosovës
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKMPK	Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
KLSP	Këshillave Lokal për Siguri Publike
KNEDR	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial
KRAEF	Forumit të Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptasve të Kosovës
MAPH	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MFE	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MKK	Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve
MKRS	Ministria e Kultures, Rinisë dhe Sportit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme

Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës,
2009-2015

MPJ	Ministria e Puneve te Jashtme
MSH	Ministria e Shendetsise
MSHP	Ministria e Sherbimeve Publike
MTI	Ministria e Tregtise dhe Industrise
MTPT	Ministria e Transportit dhe Poste- Telekomunikacionit
NjDNj	Njësitë për të Drejtat e Njeriut
NPS	Njësitë i Standardeve Profesionale
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetsisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PDAK	Partia Demokratike e Ashkalijve të Kosovës
PDAK	Partia Demokratike e Ashkalijve Shqiptarë të Kosovës
PNDPCP	Pakti Nderkombetar mbi të Drejtat Civile dhe Politike
PREBK	Partia e Bashkuar e Romëve të Kosovës
PSSP	Perfaqesuesi Special i Sekretarit te Pergjithshem
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PVPE	Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian
QAP	Qendra për Arsimit Profesional
QPS	Qendra për Punë Sociale
RADC	Qendra për Dokumentim e Romëve dhe Ashkalijve
SFH	Schëizerische Flüchtlingshilfe
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SPZHK	Plani Zhvillimor të Kosovës
UDHR	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuar
UNDP	Programin Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNHCR	Komesariati i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNHCR	Komisionarin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNIFEM	Fondi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuar për Gratë
UNIJA	Këshilli Danez për Refugjatë, shoqata e personave të zhvendosur UNIJA, etj.
UNKT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNMIK	Misioni i Administrimit të Përkohshëm në Kosovë
ZKM/ZQM	Zyra e Kryeministrit- Zyra për Qeverisje të Mirë, Drejta të Njeriut , Mundësi të Barabarta

Përmbledhja Ekzekutive

1. Hyrje

1.1. Preambula

Vizioni dhe Qëllimet

Visioni:

Republika e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, i lirë dhe demokratik ku do të vihen në jetë dhe respektohen standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si dhe të gjitha komunitetet do të mund të jetojnë pa frikë, të gëzojnë mundësi të barabarta dhe ta ndjekin vizionin e ndërtimit të së ardhmes së përbashkët.

Qëllimet:

- Promovimi dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë dhe integrimi i tyre i plotë në shoqerine kosovare;
- Hartimi i politikave dhe legjislacionit përkatës, si dhe sigurimi se legjislacioni është në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;
- Të promovojë në mënyrë aktive forcimin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit, në veçanti përmes dialogut dhe ndërtimit të institucioneve për zbatimin e të drejtave të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë;
- Përkrahja dhe inkurajimi i punës së OJQ-ve që përfaqësojnë interesat e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë, thellimi i bashkëpunimit me to, duke përfshirë Institucionin e Ombudspersonit;

Në 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi shpalljen e pavarësisë duke e deklaruar Kosovën shtet të pavarur sovran si dhe duke paraqitur aspiratat për të ndërtuar një shtet të lirë e demokratik ku do të vihen në jetë e respektohen standardet më të larta ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut si dhe ku të gjitha komunitetet do të mund të jetojnë pa frikë, të gëzojnë mundësi të barabarta dhe ta ndjekin vizionin e ndërtimit të së ardhmes së përbashkët. Këto aspirata u reflektuan në Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila u miratua në 9 prill 2008 dhe hyri në fuqi në 15 qershor 2008.

Kjo kushtetutë ka integruar standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe i kushton një vëmendje të veçantë komuniteteve minoritare të Kosovës. Në kapitullin e tretë të Kushtetutës të dedikuar posaçërisht për të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre thuhet shprehimisht se krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ata gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë. Kapitujt e veçantë për të drejtat e minoriteteve të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dëshmojnë qartë për vullnetin e mirë të Republikës së Kosovës për të bërë të mundur që çdo qytetar i Kosovës pa dallim përkatësie, të jetojë i lirë dhe me dinjitet të plotë në territorin e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të përkushtimit të marrë për të garantuar një jetë sa më të mirë të të gjitha komuniteteve, Republika e Kosovës i kushton vëmendje të veçantë komunitetit romë ashkali dhe egjiptas të cilat njihen zyrtarisht si komunitete të veçanta nga shteti i Republikës së Kosovës.

Ashtu, siç dihet në mbarë Evropën, romët, ashkalijtë dhe egjiptasit kanë qenë subjekt diskriminimi shekuj me radhë. Ata edhe sot ballafaqohen me diskriminim dhe paragjykime racore dhe gjenden në rrethin e ngushtë të diskriminimit, varfërisë dhe përjashtimit duke ngelur ndër komunitetet më të nëpërkëmbura në Evropë. Të gjithë treguesit social dhe ekonomik dëshmojnë qartë për këtë fakt të mjerueshëm, dhe nxjerrin në pah vështirësitë kushtetive jetësore të komuniteteve më të varfra të pazhvilluara.

As Kosova nuk bën përjashtim në këtë gjendje të mjerueshme për këto komunitete dhe sikundër në gjithë Evropën, fatkeqësisht romët, ashkalijtë dhe egjiptasit janë të të diskriminuar dhe janë ndër komunitetet më të varfra dhe më të pafavorizuara në Kosovë si dhe ndër komunitetet me më pak perspektivë për jetë më të mirë.

Shkatërrimet që la pas lufta në Kosovë dhe më pas procesi i zgjatur i përcaktimit të statusit final të Kosovës ka përkeqësuar në përgjithësi gjendjen ekonomike dhe sociale të popullsisë kosovare dhe ka prekur në mënyrë të veçantë edhe segmentet më të marginalizuara të kësaj shoqërie, ku edhe përfshihen këto tre komunitete.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vetëdijshme për këtë situatë dhe është e vendosur që të bëjë çmos për të krijuar kushte sa më të përshtatshme për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptase në mënyrë që ata të mund të gëzojnë të drejta të barabarta me të gjitha komunitetet e tjera etnike në Kosovë pa asnjë formë të diskriminimit. Ky angazhim dëshmohet dhe konkretizohet nëpërmjet miratimit të kësaj strategjie të posaçme e cila paraqet edhe masa afirmative që synojnë të zvogëlojnë dallimet ndërmjet romëve, ashkaliëve dhe egjiptasve në njërin anë dhe komuniteteve të tjera në anën tjetër.

Qeveria e Kosovës mu për këtë ka formuar Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) në vitin 2005 dhe mekanizmat tjerë institucionalë siç janë Zyra për Komunitete në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe Këshillin Konsultativ për Komunitete në kuadër të Presidencës.

Principet

Qeveria e Republikës Kosovës e ndjek principin e integritit në baza të barabarta dhe përkushtohet që të garantojë respektimin e identitetit dhe përkatësisë kombëtare së pjesëtarëve këtyre tri komuniteteve duke luftuar çdo formë diskriminimi.

Qeveria e Republikës së Kosovës duke dashur që të vërë në jetë sa më shpejtë parimet dhe zotimet e paraqitura në Kushtetutën e Republikës së Kosovës angazhohet që të përdorë masa afirmative për ta përmirësuar me shpejtësi gjendjen e këtyre tri komuniteteve.

Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës do ta ndjek në mënyrë strikte politikën e mundësive të barabarta, të përfshirjes sociale dhe anti-diskriminimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës do ta ndjek një qasje pjesëmarrëse dhe do t'i përfshijë përfaqësuesit dhe shoqërinë civile të këtyre komuniteteve në zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë – njëlloj siç kanë qenë të përfshirë në procesin e hartimit të Strategjisë.

Drejtesia

Republika e Kosovës e ka si prioritet rindërtimin e Kosovës si dhe eliminimin e pasojave të luftës. Në këtë kuadër Qeveria e Republikës së Kosovës është e angazhuar që të kurojë plagët e luftës duke bërë çmos që të sjellë drejtësinë në vend pa marrë parasysh përkatësinë e viktimave apo shkaktarëve dhe për të qartësuar fatin e të zhdukurve mes të cilëve ka edhe shumë pjesëtarë të komuniteteve në fjalë.

Gjithashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës prej vitesh është duke bërë përpjekje të mëdha për të mundësuar rikthimin e qytetarëve të Kosovës që janë larguar si pasojë e luftës. Drejtësia dhe pajtimi janë identifikuar si parakushte për të mundësuar bashkëjetesën paqësore të komuniteteve-grupeve etnike në Kosovë dhe për zhvillimin demokratik të shoqërisë kosovare.

Strategjia për Integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas përbën një kontribut të rëndësishëm në përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të ndërtuar një klimë tolerance, pajtimi dhe respekti të ndërsjellë mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë si dhe për të mundësuar një dialog politik në mes të Republikës së Kosovës dhe vendeve ku tani jetojnë përfaqësues të këtyre komuniteteve, si dhe me agjencitë e specializuara siç janë (IOM, UNHCR dhe tjera) për të mbajtur nën kontroll procesin.

Falënderimet

Hartimi i kësaj Strategjie ishte përpjekje e përbashkët e Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës/ Zyrës për Qeverisje të Mirë, dhe të gjitha Ministrisë e linjes në Qeverinë e Republikës, Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), përfaqësuesve të tri komuniteteve dhe të Misionit të OSBE-së në Kosovë, të cilat së bashku kanë koordinuar procesin e hartimit të kësaj strategjie.

Për këtë arsye Qeveria e Republikës së Kosovës shpreh mirënjohjen e thellë ndaj KFOS-it dhe OSBE-së për bashkëpunimin e ngushtë dhe ndihmën shumë cilësore të ofruar të cilat mundësuan edhe realizimin e hartimit të kësaj strategjie.

Gjithashtu, përfaqësuesit e ministrive relevante dhe të institucioneve tjera kosovare si dhe përfaqësues të disa organizatave ndërkombëtare të cilat dhanë kontribut të çmueshëm në hartimin e kësaj strategjie.

Posaçërisht i falënderojmë përfaqësuesit e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, dhe të Njësiteve për të drejta të njeriut në Ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës që morën pjesë në grupet punuese për përpilimin e strategjisë. Hartimi i strategjisë do të kishte qenë i pamundur pa ekspertizën dhe përkushtimin e tyre.

Gjithashtu, falënderojmë Këshillin e Evropës (CoE), ICO, Programin Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara (UNDP), UNICEF-in, UNIFEM-in, UN- HABITAT-in, Komisionarin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), për kontributin e tyre të çmueshëm.

1.2. Informata Paraprake

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit në Kosovë

Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e komunitetëve romë, ashkali dhe egjiptas që jetojnë aktualisht në Kosovë, dhe as për numrin e tyre nga Kosova që jetojnë si refugjatë, persona të zhvendosur, azilkërkues të refuzuar apo si punëtorë emigrantë jashtë Kosovës. Statistikat që lidhen me këto tri komunitete janë të paqarta dhe shpesh të pasakta ose kontradiktore. Por megjithatë mendohet se rreth 35.000 deri 40.000 romë, ashkalinj dhe egjiptas jetojnë aktualisht në Kosovë, dhe një numër më i madh jashtë Kosovës.

Komunitete të mëdha me qindra persona jetojnë në Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Fushë Kosovë, Obiliq, Pejë dhe në Graçanicë, Gjiilan, Mitrovicë dhe Leposavic.

Dhjetëra mijëra romë, ashkalinj dhe egjiptas që aktualisht jetojnë jashtë Kosovës u larguan nga Kosova gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Megjithatë, rindërtimi i pjesërishëm, si dhe procesi i kthimit në disa vende të Kosovës si në Gjiilan, Lipjan, apo Klinë, dëshmon mundësinë e një fillimi të ri.

Strategjia, në radhë të parë adreson, përmirësimin e gjendjes së komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase që jetojnë në Kosovë, dhe në të njëjtën kohë ofron edhe zgjidhje dhe rekomandime për re-integrimin e personave të kthyer. Vetëm në hapin e dytë, pas përmirësimit të gjendjes së këtyre komuniteteve dhe pas rritjes së kapacitetit të tyre integruar, komunitetet do të jenë në gjendje të pranojnë garantime kushte të përshtatshme për një numër të konsiderueshëm të personave të kthyer.

Procesi i kthimit si dhe procesi i pajtimit dhe krijimit të një klime sa më tolerante dhe dialogu ndëretnik në Kosovë, ku respektohen në mënyrë rigorozë të drejtat dhe liritë e minoriteteve tregojnë gatishmërinë e Republikës së Kosovës t'i pranojë qytetarët e saj romë, ashkali dhe egjiptas. Por, megjithatë, tri komunitetet janë ende në një gjendje shumë të rëndë në Kosovë, sidomos në fushën e punësimit.

Të gjithë indikatorët social dhe ekonomik theksojnë pozitën e pafavorshme dhe diskriminuese të këtyre tri komuniteteve në të gjitha fushat e jetës së përditshme, dhe sipas kushteve aktuale jetësore iu përkasin shtresave më të varfra të vendeve të pazhvilluara.

Raporti i Zhvillimit Njerëzor i UNDP-së (2004) ofron të dhëna të dobishme për gjendjen socio-ekonomike të tri komuniteteve në Kosovë¹

Të Hyrat për Kokë Banori
Romët, ashkalijtë dhe egjiptasit: €397 Serbët e Kosovës: €1.282 Shqiptarët e Kosovës: €1.051 Të tjerët: €866
Varfëria e skajshme (1 USD në ditë)
Romët, ashkalijtë dhe egjiptasit: 36.70% duhet të jetojnë në varfëri të skajshme. Serbët e Kosovës: 3.94% Shqiptarët e Kosovës: 12.87% Të tjerët: 16.82%
Shkalla e papunësisë
Romët, ashkalijtë dhe egjiptasit: 58.32% Serbët e Kosovës: 30.18% Shqiptarët e Kosovës: 45.85% Të tjerët: 42.96%

Të dhënat nga Studimi i Pagave dhe Aftësive i kryer nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (mars 2006) e konfirmojnë pozitën e pafavorshme të tri komuniteteve.

Kampioni i anketimit përfshiu 12.126 punëtorë të punësuar në 1547 ndërmarrje, kryesisht në kompani private; megjithatë, vetëm 0.1% të personave që punojnë në këto ndërmarrje janë romë, ashkalijtë dhe egjiptas, që do të thotë rreth 12 persona.²

Të Hyrat Mesatare Mujore
Romët, ashkalijtë dhe egjiptasit: € 144.30.

¹ Për më tepër informata, shih Raportin e Zhvillimit Njerëzor për Kosovën 2004, UNDP, Prishtinë 2004. Për më tepër informata për gjendjen e tri komuniteteve në sektorin e punësimit shih kapitullin "Fuqizimi Ekonomik dhe Punësim".

² Organizata Ndërkombëtare e Punës, Studimi mbi Pagat dhe Aftësitë. Mars 2006. Prishtinë 2006. Këto të dhëna dëshmojnë që praktika e zakonshme për t'i konsideruar "Të tjerë" të gjitha komunitetet joshqiptare dhe joserbe (romët, ashkalijtë, egjiptasit, boshnjakët, goranët, turqit, kroatët) nuk mund të ofrojnë rezultate të besueshme dhe realiste për shkak të dallimeve në mes romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në njërin anë dhe boshnjakëve dhe turqve në anën tjetër..

Serbët e Kosovës: € 196.60
Shqiptarët e Kosovës: € 224.10
Të tjerët: € 240.20

Rezultatet e studimit të kryer për Raportin e Zhvillimit Njerëzor të UNDP-së dëshmojnë faktin që romët, ashkali dhe egjiptasit, nëse janë të punësuar, kanë kryesisht pozita të ulëta. Të dhënat tregojnë përqindjen e fuqive respektive punëtore në pozitat udhëheqëse.

Stafi Legjislativ dhe Menaxhues
Romët, ashkali dhe egjiptasit: 7.90%
Serbët e Kosovës: 16.19%
Shqiptarët e Kosovës: 13.94%
Të tjerët: 15.58%

Stafi Profesional dhe Teknik
Romët, ashkali dhe egjiptasit: 11.68%
Serbët e Kosovës: 33.57%
Shqiptarët e Kosovës: 22.15%
Të tjerët: 25.91%

Të dhënat nga studimet mbi strukturën etnike të kompanive publike në Kosovë dëshmojnë për një gjendje veçanërisht të disfavorshme të komuniteteve romë, ashkali, egjiptas që për t'u zgjidhur ka nevojë për masat afirmative të parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në këtë Strategji.

Punësimi në Kompanitë	Punëtorë (total)	Romë, ashkali dhe egjiptas
Korporata Energjetike e Kosovës (KEK):	7564	3 (0.04%)
Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK):	2484	14 (0.56%)
Hekurudhat e Kosovës:	389	2 (0.51%)
Aeroporti i Prishtinës:	577	2 (0.35%)
KosovaTrans:	912	30 (3.29%)

Këto pesë ndërmarrje së bashku kanë punësuar 11.926 persona; 51 prej tyre ishin romë, ashkali dhe egjiptas (0.42%). Edhe në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK), tri komunitetet janë të nënfaqësuar me 0.71% të policëve apo 50 persona.

Të dhënat individuale nga struktura e Qeverisë dhe nga organizatat ndërkombëtare – si punëdhënës kryesor – tregojnë një pamje të ngjashme: një nën-përfaqësim të dukshëm të tri komuniteteve në mesin e fuqisë punëtore të këtyre institucioneve.

Megjithatë, të dhënat individuale nga disa komuna dëshmojnë ekzistencën e praktikave të mira në Kosovë, p.sh. Ndërmarrja Publike e Ujit dhe Kanalizimit në Gjakovë punëson rreth 5% romë, ashkali dhe egjiptas (11 persona) përderisa shkalla e romëve, ashkali dhe egjiptasve të punësuar në Ndërmarrjen Publike për Pastrimin e Qytetit është madje 56% (61 persona). Megjithatë edhe ky fakt tregon që pozicioni i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve është i pafavorshëm duke qenë se ata nuk gjenden në pozicione menaxheriale apo të punësuar në sektor më cilësor.

Mirëpo, ka përjashtime të vogla në disa komuna, për pjesëtarët e këtyre tri komuniteteve që merren me zanate-artizanate të caktuara dhe të cilët janë ekonomikisht më të suksesshëm dhe janë pranuar si partnerë afarist nga shumica.

Supozohet që praktikat paragjyquese të punëdhënësve potencial në njërin anë dhe niveli i ulët i trajnimit dhe edukimit profesional dhe mungesa e informimit në mesin e komuniteteve në anën tjetër kontribuojnë në gjendjen e mjerueshme në tregun e punës.

Pritet që gjendja ekonomike do të përkeqësohet pas kthimit (të detyruar) nga Evropa Perëndimore, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi dhe kthimit vullnetar të Personave të Zhvendosur nga Serbia; në veçanti duke marrë parasysh që të ardhurat e shumë familjeve që mbetën të jetojnë në Kosovë vareshin nga ndihmat financiare nga Evropa Perëndimore.³

Njëlloj brengosëse është edhe gjendja e tri komuniteteve në fushën e edukimit.

Të dhënat për edukim të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në Kosovë⁴
Analfabet: 16%
Fëmijët që vijojnë mësimet në shkollimin fillor: 75%
Fëmijët që vijojnë mësimet në shkollimin sekondar: 25%
Ata që vijojnë mësimet në apo kanë mbaruar shkollën e mesme: 1.4% .

Tabela vijuese mbi shkallën e shkrim-leximit nuk dëshmon vetëm pozitën e pafavorshme të tri komuniteteve.

Shkalla e Shkrim-Leximit⁵
Grupmosha 15-24: jo-roma 98% Roma: 65% femrat rome: 56%
Grupmosha 25-34: jo-roma 98% Roma: 76% femrat rome: 69%

Kjo tabelë dëshmon edhe pozitën e pafavorshme diskriminuese të femrave rome, ashkalike dhe egjiptase në fushën e edukimit. Një situatë e ngjashme mbretëron edhe në tregun e punës (p.sh. prej 50 policëve vetëm dy janë femra, derisa studimi i UNDP-së tregon që përqindja e femrave rome, ashkali dhe egjiptase në pozitë udhëheqëse është 0%). Shkalla e ulët e edukimit, varësia ekonomike dhe sociale dhe martesat e hershme e përkeqësojnë edhe me tepër pozitën e tyre dhe ngrisin shkallën e diskriminimit të femrave të këtyre tri komuniteteve.

Raste të diskriminimit mund të hasen në të gjitha fushat e jetës së përditshme të tri komuniteteve. Në edukim, në qasje në shëndetësi, në rindërtimin e pronës së shkatërruar, në pjesëmarrje dhe përfaqësim politik, në pjesëmarrje në programet për kthim, të tri komunitetet apo pjesëtarët e tri komuniteteve gjenden në disavantazh në krahasim me minoritetin tjetër serb ku ka qenë e përqendruar një vëmendje më e madhe e institucioneve ndërkombëtare që kanë mbikëqyruar administratën në Kosovë.

Refugjatët, Personat e Zhvendosur dhe Emigrantët

Rreth 45.000 deri 50.000 romë, ashkalijë dhe egjiptas të Kosovës jetojnë në Serbi (rreth 23.000 janë të regjistruar si persona të zhvendosur), 35.000 janë të regjistruar në Gjermani si azilkërkues të refuzuar dhe rreth 10.000 jetojnë si refugjatë në Mal të Zi, Maqedoni dhe Bosnje dhe Hercegovinë. Një numër i panjohur i tyre jetojnë si refugjatë, emigrantë ilegal apo punëtorë emigrant në mbarë Evropën Perëndimore. Një numër i konsiderueshëm prej tyre priten të kthehen në Kosovë në të ardhmen e afërt.

Sipas të dhënave të UNHCR-së, deri në tetor të vitit 2007, vetëm 6,899 romë, ashkalijë dhe egjiptas u kthyen në Kosovë që nga janari i vitit 2000. Në anën tjetër, një numër i

³ Në mesin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve, ndihmat nga të afërmit dhe miqtë përbëjnë 20.86% të të ardhurave të përgjithshme që është shkalla më e lartë në mesin e të gjitha komuniteteve etnike. Shih Raportin e Zhvillimit Njerëzor për Kosovën 2004, UNDP, Prishtinë 2004

⁴ UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor për Kosovën 2004. Prishtinë 2004. Për më tepër informata për edukimin, shih kapitullin "Edukimi".

⁵ UNDP, Fytyrat e Varfërisë. Bratislava 2005.

konsiderueshëm mendohet të jetë larguar në emigracion për shkaqe të rënda sociale, ekonomike nga Kosova gjatë kësaj periudhe.

Dokumentet kryesore politike për kthimin (vullnetar) të personave të zhvendosur janë *Rekomandimet e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) për Azhurnimin e Politikave dhe Procedurave të Kthimit* të majit të vitit 2006, *Manuali i Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm* i është duke u rishikuar dhe *Protokolli për Kthimin Vullnetar dhe të Qëndrueshëm*, i nënshkruar në qershor të vitit 2006 nga UNMIK-u, Qeveria e Serbisë dhe IPVQ-të.

Përveç kësaj, shumica e komunave hartuan *Strategjitë Komunale për Kthim* të cilat trajtojnë në mënyrë të veçantë kthimin vullnetar të personave të zhvendosur dhe refugjatëve, por jo edhe kthimin e detyrueshëm.

Dokumentet e sipërpermendura nxjerrin se rreth 11% të personave të zhvendosur nga Kosova të regjistruar në Serbi janë romë, ashkalinjë dhe egjiptas, megjithatë ekziston edhe një numër i madh qytetarësh nga Kosova që janë të zhvendosur në Serbi pa qenë të regjistruar si persona të zhvendosur. Shumica e këtyre personave të zhvendosur që nuk janë të regjistruar jetojnë në varfëri të skajshme pa pasur qasje në shërbimet themelore siç janë edukimi, kujdesi shëndetësor, përfitimet sociale apo pa qasje në tregun zyrtar të punës.

Gjatë periudhës së hartimit të kësaj strategjie, kthimi i azilkërkuesve të refuzuar nga Evropa Perëndimore ishte ende në kompetencat e rezervuara të UNMIK-ut, derisa kthimi i personave të zhvendosur nga Serbia kishte kaluar në kompetencat e Qeverisë së Kosovës. Rrjedhimisht, ekzistojnë dokumente të ndryshme politike për menaxhimin e politikave respektive të procesit të kthimit.

Në vitin 2007, UNMIK-u dhe IPVQ-të finalizuan *Strategjinë për Re-integrimin e Personave të Riatdhesuar* që trajton gjendjen e refugjatëve që janë të detyruar të kthehen në Kosovë. Vlerësohet që rreth 50% të personave të riadhesuar janë romë, ashkalinjë dhe egjiptas, në veçanti romë.

Pritet që në të ardhmen e afërt, një numër i konsiderueshëm do të jetë i detyruar të kthehet nga Evropa Perëndimore, kryesisht nga Gjermania, por edhe nga vendet siç janë Mali i Zi, Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina.

Kthimi i detyrueshëm krijon përgjegjësi shtesë për qeverinë qendrore dhe për autoritetet komunale; kthimi në shkallë të madhe në Kosovë do të stërngarkonte kapacitetin e politikës dhe shoqërisë kosovare, si dhe kapacitetet absorbuese të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase duke shkaktuar rrezikun e largimit të tyre masiv nga Kosova.

Kjo strategji ofron zgjidhje dhe rekomandime përmbajtësore për çështjet e kthimit dhe riintegrimin, por megjithatë, ajo nuk mund të zëvendësojë dokumentet e lartpërmendura politike.

Konteksti

Strategjia duhet të shikohet në kontekst të dokumenteve tjera të rëndësishme politike në Republikën e Kosovës dhe në nivelin ndërkombëtar. Rekomandimet e strategjisë nuk synojnë të zëvendësojnë dokumentet e përgjithshme politike, por të ofrojnë rekomandime shtesë të dobishme dhe realiste për përmirësimin e gjendjes së tri komuniteteve në të gjithë sektorët relevant.

Të gjitha strategjitë e tjera relevante apo dokumentet e përgjithshme politike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që janë në përfundim e sipër si: hartimi strategjisë 2009-2013 dhe doracaku për kthim të qendrueshëm i Ministrisë për Kthim dhe Komunitete dhe që adresojnë gjendjen e këtyre tri komuniteteve do të marrin parasysh Strategjinë për Integrimin e komuniteteve, Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë

Përvojat dhe praktikat më të mira nga dokumentet tjera politike në Kosovë, dhe në veçanti nga politikat për çështjet romë në rajon dhe rekomandimet e organizatave ndërqeveritare siç është Këshilli i Evropës, OSBE-ja dhe Kombët e Bashkuara shërbyen si pika të referimit në procesin e hartimit të kësaj strategjie.

Tejet të rëndësishme ishin rekomandimet e hollësishme dhe konkrete të Këshillit të Evropës për aspektet e ndryshme të jetës së romëve, ashkallijve dhe egjiptasve dhe Plani i Veprimit për Romët dhe Sinti në Rajonin e OSBE-së.⁶ Kjo strategji poashtu do të mbeshitet gjithashtu edhe praktikat më të mira evropiane si dhe nismat që janë duke u marrë përsipër në gjithë kontinentin për të zgjidhur problemet e këtyre komuniteteve anembanë.

Përveç dokumenteve politike sektoriale, dokumentet e përgjithshme politike siç janë Strategjia e Planit Zhvillimor të Kosovës (SPZHK) Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), Ligji për Financimin e Qeverive Lokale, nr.03/L-049 që paraqesin dokumentet kryesore të planifikimit financiar për Kosovën në disa vitet e ardhshme janë jashtëzakonisht të rëndësishme. SPZHK-ja dhe KASH-i duhet medoemos t'i referohet zbatimit të strategjisë dhe të parashoh burimet respektive financiare.

Qeveria e Republikës së Kosovës siguron bashkëpunim të ngushtë me partnerët e saj nga Bashkimi Evropian (Komisioni) që zbatimi i pjesëve relevante të strategjisë do të përfshihen si njëri prej prioriteteve të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE).

Rrjedhimisht, Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë fondet nga buxheti i saj për zbatimin e strategjisë, dhe gjithashtu i fton donatorët ndërkombëtarë të përkrahin duke dhënë burime shtesë të mjaftueshme financiare për integrimin e romëve, ashkallijve dhe egjiptasve në Kosovë.

Qeveria e Republikës së Kosovës siguron që çdo zhvillim i mëtutjeshëm që rrjedh nga shpallja e pavarësisë, siç janë ligjet e reja, do ta marrin parasysh gjendjen specifike të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase. “Këshilli Konsultativ për Komunitete”, që u formua në 15 Shtator 2008, përfshin përfaqësues të tri komuniteteve dhe do të bëjë përpjekje për ta përmirësuar gjendjen politike dhe sociale të tri komuniteteve. Po kështu pranë Zyrës së Kryeministrit është krijuar Zyra për Komunitetet që synon të nxisin nivelin e integritit dhe harmonisë ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike në Kosovë.

Për me tej, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, dhe Ligji mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë (nr. 03/L-047, 13 mars 2008); përfshijnë dispozita për zbatimin e masave afirmative që janë të domosdoshme për përmirësimin e gjendjes së romëve, ashkallijve dhe egjiptasve.

1.3. Metodologjia

E përgjithshme

Qëllimi i strategjisë është të kontribuojë në krijimin e shoqërisë kosovare ku romët, ashkallijtë dhe egjiptasit respektohen si qytetarë të barabartë, t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore dhe të mos janë subjekt i asnjë diskriminimi. Prandaj, Strategjia përcakton të drejtën e komuniteteve, romë, ashkali dhe egjiptas për pjesëmarrje të barabartë në të gjitha strukturat e shoqërisë duke përfshirë politikën dhe ekonominë kosovare.

⁶ Shtojca X i përmend të gjitha dokumentet relevante të cilat inspiruan dhe udhëzuan hartimin e strategjisë.

Procesi i hartimit të strategjisë dhe zbatimi i strategjisë ka aplikuar dhe do t'i ndjek direktivat vijuese:

1. Strategjia është hartuar me një qasje pjesëmarrëse, duke përfshirë përfaqësues të ministrive relevante dhe të tri komuniteteve.
2. Komunitetet do të përfshihen në zbatimin dhe monitorimin e strategjisë.
3. Hartimi dhe zbatimi i strategjisë duhet të shihen në kontekst më të gjerë; iniciativat e tjera të Qeverisë dhe të institucioneve ndërkombëtare janë pika të referimit.
4. Strategjia nuk synon të zëvendësojë por të plotësojë iniciativat e përgjithshme. Rrjedhimisht, strategjia ndjek një qasje kryesore sa herë që kjo është e mundur, e plotësuar me veprime afirmative sa herë që kjo është e nevojshme.
5. Rekomandimet e Këshillit të Evropës, Plani i Veprimit i OSBE-së për Roma dhe Sinti në Rajonin e OSBE-së si dhe rekomandimet e Kombeve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian janë direktive të rëndësishme për hartimin dhe zbatimin e strategjisë.
6. Zbatimi i sigurtë dhe realist i strategjisë i bazuar në burimet e identifikuara financiare është kyç për përmirësimin e gjendjes së romëve, ashkalijve dhe egjiptasve. Përfshirja e zbatimit të Strategjisë si njërin ndër prioritetet e Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE), apo në Strategjinë e Planit Zhvillimor të Kosovës (SPZHK) dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) si dhe dispozitat relevante në buxhetin e Kosovës janë garanci për zbatimin e sigurtë dhe realist.
7. Ky dokument kornizë do të plotësohet nga Planet e Veprimit për çdo sektor të Strategjisë, dhe do të bëjë të mundur përfshirjen e komenteteve, sugjerimeve, verejtjeve apo rekomandimeve specifike dhe konkrete të dhëna nga aktorët e ndryshëm që kanë qenë përfshirë apo janë kontaktuar gjatë procesit të hartimit si dhe do mundësojë përcaktimin e buxhetit të nevojshëm për masat e parashikuara.
8. Qeveria e Kosovës do të themelojë një mekanizëm përgjegjës për zbatimin e Strategjisë.

Procesi i Hartimit

Procesi i hartimit të strategjisë ka ndjekur qasjen pjesëmarrëse dhe qasjen e bazuar në të drejta. Në procesin e hartimit është përfshirë edhe dialogu në mes “bartësit të detyrës” dhe “bartësit të drejtave” dhe është paraparë vazhdimi i komunikimit dhe i bashkëpunimit gjatë tërë procesit të zbatimit dhe monitorimit, duke krijuar kështu pronësi mbi strategjinë dhe mirëkuptim të dyanshëm.⁷

Qasja pjesëmarrëse ka rezultuar në pjesëmarrjen efektive të përfaqësuesve qeveritarë dhe përfaqësuesve të tri komuniteteve dhe ka përfshirë edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile nga popullata shumicë.

Tryezat, punëtoritë dhe konferencat rajonale gjatë fazës përgatitore me sukses i kanë shërbyer synimit për përfshirjen e një game të gjerë të aktorëve nga qeveria dhe komunitetet. Kjo qasje ofron garanci që strategjia do të zbatohet me sukses dhe do të ketë përkrahjen e shoqërisë së gjerë.

Gjashtë grupe punuese janë themeluar për hartimin e sektorëve të ndryshëm të strategjisë:

⁷ Për më tepër informata për Qasjen e bazuar në të Drejta shih: Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Pyetjet e Shpeshta për Qasjen e bazuar në të Drejtat e Njeriut për Zhvillimin e Bashkëpunimit, Nju Jork, Gjenevë 2006.

- Strehimi dhe vendbanimet joformale, regjistrimi dhe dokumentacionet, kthimi dhe re-integrimi
- Edukimi
- Kultura, identiteti, mediat dhe informimi
- Punësimi dhe fuqizimi ekonomik
- Shëndeti dhe çështjet sociale
- Anti-diskriminimi, siguria, të drejtat e pakicave, pjesëmarrja dhe përfaqësimi politik
- Çështjet Gjinore

Grupet punuese të përbëra nga anëtarë të ministrive relevante dhe përfaqësues të tri komuniteteve dhe të kryesuara nga ekspertë vendorë apo ndërkombëtarë, përpunuan rekomandimet e strategjisë.

Ekspertë nga organizatat e tjera siç janë Këshilli i Evropës, UNHCR-i, UNDP-ja, UNICEF, HABITATI-i, Qendra Kosovare për Edukim, Qendra për të Drejtat e Strehimit dhe Dëbimit, Fondi për Edukimin e Romëve, Zyra e UNMIK-ut për Komunitete, Kthim dhe Pakica, Instituti i Shëndetit Publik, Misioni i OSBE-së në Kosovë si dhe organizata të ndryshme joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare që kontribuan me ekspertizën e tyre.

Lidhur me procesin e hartimit duhet marrë në konsideratë konteksti historik në të cilin është zhvilluar dhe që ka përkuar me shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës, hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratimi i ligjeve të reja të pakos së Ahtisaarit si dhe transferimi i autoritetit prej institucioneve ndërkombëtare drejt institucioneve shtetërore vendase.

Konkretisht një pjesë e legjislacionit është trashëguar prej UNMIK-ut dhe ngelet në fuqi ndërkohë që paralelisht legjislacioni vazhdon duke u zëvendësuar, ndryshuar apo plotësuar. Duke qenë se këto zhvillime janë duke ndodhur në mënyrë të shpejtë e intensive mund të ndodh që referencat ligjore apo institucionale të mos jenë të përditësuara sepse janë në ndryshim e sipër.

2. Sektorët e Strategjisë

2.1 Anti-diskriminimi

Përshkrimi i situatës

Gjatë tërë historisë, romët, ashkalinjët dhe egjiptasit – që nga zhvillimi dhe njohja e identitetit të tyre – janë ballafaquar me përjashtim sistematik dhe diskriminim në të gjitha fushat e jetës private dhe publike. Në Ish-Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) si në çdo shtet tjetër socialist, dallimet etnike, gjuhësore, fetare si dhe dallimet e tjera ishin fshehur nën flamurin socialist. Të gjithë qytetarët konsideroheshin të barabartë dhe nuk lejoheshin diskutime publike për përjashtimin real apo të perceptuar të grupeve të caktuara nga jeta publike.

Në anën tjetër, ishte vendosur një sistem i cili me kujdes balanconte të paktën grupet kryesore etnike të republikave të RSFJ-së në mekanizmat federal të ndarjes së fuqisë. Në këtë sistem, në Kosovë si në çdo vend tjetër të RSFJ-së, një numër shumë i vogël i romëve, ashkalijve dhe egjiptasve kishin pozita të larta dhe publike në qeveri, si gjykatës, prokurorë, në radio stacione dhe televizione apo si anëtarë të kuvendit.

Disa prej tyre që kishin pozita të tilla, vendosën mos ta zbulojnë identitetin e tyre për shkak të frikës nga diskriminimi. Romët, ashkalijtë dhe egjiptasit që kanë pozita të larta dhe udhëheqëse janë megjithatë përjashtim, derisa shumica e tyre gjithmonë kanë jetuar në kushte më të

mjerueshme se çdo grup tjetër. Lufta në Kosovë gjatë viteve 1998-99 theksoi edhe më tepër dallimet dhe urrejtjen etnike në Kosovë, dhe përkeqësoj gjendjen e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve.

Përrjashtimi dhe diskriminimi nuk janë zhdukur përkundër të gjitha ndryshimeve politike. Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit në Kosovë ende ballafaqohen me diskriminim dhe kanë shkallën më të lartë të papunësisë dhe të varfërisë. Kompanitë apo institucionet që janë themeluar apo riorganizuar në vitet e fundit siç është Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), Hekurudhat e Kosovës, Transporti i Kosovës, Aeroporti i Prishtinës, punësojnë afro 20.000 persona; megjithatë vetëm 0.5% prej tyre janë romë, ashkali dhe egjiptas.

Përveç papunësisë ata kanë edhe nivelin më të ulët arsimor, kohëzgjatjen më të ulët të jetës; një numër i konsiderueshëm prej tyre nuk janë të regjistruar dhe nuk kanë dokumente zyrtare; ata janë të ndjeshëm meqë jetojnë në vendbanime joformale ku nuk ka infrastrukturë adekuate dhe qasje të barabartë në shërbime. Femrat romë, ashkallike dhe egjiptase ballafaqohen me diskriminim të shumëfishtë për shkak të gjinisë dhe përkatësisë të tyre.

Kjo është arsyeja dhe domosdoshmëria, pse bëhet e nevojshme që në disa fusha Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ndër marrë veprime afirmative në mënyrë që të gjithë pjesëtarët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptase të kenë mundësi të barabarta. Politikat kundër diskriminimit duhet të aktualizohen në të gjithë sektorët e kësaj strategjie. Në kapitujt e saj të ndryshëm, strategjia rekomandon masa për sigurimin e mundësive të barabarta për këto komunitete.

Korniza Politike dhe Dokumentet e Referimit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka vendosur të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve në qendër të vëmendjes madje të drejtave të komuniteteve iu ka dedikuar posaçërisht kapitullin e tretë ku zberthehen me hollësi të drejtat e veçanta që gëzojnë qytetarët e Republikës së Kosovës që iu përkasin minoriteteve. Përveç kësaj, Konventat ndërkombëtare që aplikohen edhe në Kosovë përfshijnë dispozita specifike kundër diskriminimit, dhe më të rëndësishmet prej tyre janë (a) Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut⁸, (b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore⁹ dhe Protokollet e saj, (c) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike¹⁰ dhe Protokollet e saj, (d) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, (e) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas, (f) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve¹¹, dhe (h)

⁸UDHR, Neni 1: Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lirë dhe me dinjitet dhe të drejta të barabarta. Ata janë të pajisur me arsye dhe vetëdije dhe duhet të sillen njeri me tjetrin në frymë të vëllazërisë. 2: Të gjithë kanë të drejtë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e përmendura në këtë Deklaratë, pa asnjë dallim, siç është raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, qëndrimet politike apo qëndrime të tjera, origjina kombëtare apo sociale, prona, lindja apo ndonjë status tjetër. Përveç kësaj, nuk do të bëhet asnjë dallim në bazë të statusit politik, juridiksional apo ndërkombëtar të vendit apo territorit të cilit i takon ai person, qoftë ky i pavarur, jo vetëqeverisës apo me sovranitet të kufizuar. Dhe 7: Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë të drejtën e mbrojtjes së barabartë të ligjit pa asnjë diskriminim. Të gjithë gëzojnë të drejtën e mbrojtjes së barabartë nga çdo diskriminim që është në kundërshtim me këtë Deklaratë dhe kundër çdo nxitjeje të këtij diskriminimi.

⁹ ECHR, Neni 14: Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përmendura në këtë Konventë do të sigurohet pa asnjë diskriminim gjinor, racor, gjuhësor, fetar, mendim politik apo ndonjë mendim tjetër, pa dallim në prejardhjen kombëtare apo sociale, shoqërim me ndonjë pakicë kombëtare, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër.

¹⁰ IÇPR siguron në Nenin 24 të Drejtën e çdo fëmiju pa diskriminim për masat mbrojtëse nga ana e familjes, shoqërisë dhe Shtetit; të drejtën për t'u regjistruar menjëherë pas lindjes dhe të drejtën për nënshkruar. Neni 26 e siguron edhe mbrojtjen e barabartë dhe efektive të të gjithë personave para ligjit.

¹¹ ICRC, Neni 2.1. i definon obligimet e Shtetit për të siguruar që çdo fëmijë pa asnjë diskriminim i ka të garantuara të drejtat e përmendura në këtë Konventë. Mbrojtja nga diskriminimi është e definuar në Nenin 2.2: Palët e Shtetit do të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar që fëmiju është i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit apo

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare¹². Përveç këtyre, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore është e aplikueshme në Kosovë.

Këto standarde ndërkombëtare ofrojnë një kornizë të gjerë mbrojtëse për individët dhe komunitetet kundër diskriminimit.

Për më tepër, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe evropiane¹³, Qeveria e Kosovës më 30 korrik të vitit 2004 miratoi Ligjin kundër Diskriminimit (Ligji nr. 2004/3)¹⁴ dhe Udhëzimit Administrativ për implementimin e tij Nr-4/2006. Ky Ligj ka për qëllim të pengoj dhe luftoj diskriminimin, të promovoj barazinë efikase dhe të zbatoj principet e trajtimit të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës (Neni 1). Ligji bazohet mbi tri principe kryesore: trajtimi i barabartë, përfaqësimi i drejtë, mirëkuptimi dhe toleranca ndëretnike.

Në mënyrë që të zbatohet ligji, shoqatat dhe organizatat mund të përfshihen në ndjekjen e kërkesës. Institucioni i Ombudspersonit është mekanizmi kyç për promovimin e trajtimit të barabartë, i cili i pranon dhe heton ankesat. Me qëllim të vetëdijesimit për Ligjin Kundër Diskriminimit, Qeveria ka nisur fushatën e informimit publik me moton: “Të gjithë ndryshe, por të gjithë të njëjtë para ligjit” në pesë gjuhë, përfshirë edhe gjuhën rome. Veç kësaj, më 11 tetor 2005, Qeveria e Kosovës miratoi Planin e Veprimit për Zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit (2005-2007). Po ashtu, më 3 shtator 2008, Qeveria e Republikës së Kosovës shpalli muajin shtator muaj kundër Diskriminimi në Kosovë, nën moton “Të gjithë të barabartë dhe pa diskriminim” i cili do të vazhdojë gjatë vitit 2008 dhe 2009,

Shpallja e muajit kundër diskriminim ka për qëllim që përmes aktiviteteve të shumta dhe përmes shpërndarjes së ligjit kundër diskriminimit dhe Udhëzimit administrativ për implementimin e tij dhe materialeve tjera të përgatitura enkas për këtë fushatë - në pesë gjuhë të të gjitha komuniteteve dhe në Gjuhën rome, të bëjë promovimin e të Drejtave të Njeriut, Mundësive të Barabarta dhe kundër-diskriminimit, me theks të veçantë komuniteteve.

Megjithatë ende ngelet shumë për të bërë për të zbatuar plotësisht dhe realizuar në mënyrë sa më përshtatshme ato që merren përsipër nga ky ligj.

Aktualizimi dhe promovimi i të Drejtave të Njeriut përbrenda legjislacionit dhe politikave aplikuese përkrahet edhe me anë të caktimit të Koordinatorëve për të Drejtat e Njeriut në çdo Ministri. Përveç kësaj, secila komunë është dashur të caktojë Koordinatorët për të Drejtat e Njeriut, mirëpo, jo të gjitha komunat e kanë përmbushur këtë obligim.

ndëshkimit në bazë të statusit, aktiviteteve, mendimeve të shprehura, apo besimeve të prindërve, kujdestarëve ligjor apo pjesëtarëve të familjes së fëmiut.

¹² FCNM, Neni, 4: 1. Palët zotohen të garantojnë që pjesëtarët e pakicave kombëtare do të jenë të barabartë para ligjit dhe do të gëzojnë të drejtën e mbrojtjes së barabartë të ligjit. Në këtë drejtim, do të ndalohet çdo diskriminim që bazohet në përkatësinë në ndonjë pakicë kombëtare. 2. Palët zotohen të adoptojnë, sa herë që është e nevojshme, masat adekuate për të promovuar në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, barazinë e plot dhe efektive të të gjithë personave që i takojnë një pakicë kombëtare dhe të atyre që i takojnë shumicës. Në këtë drejtim, ata do të marrin parasysh kushtet specifike të personave që iu takojnë pakicave kombëtare. 3. Masat e miratuara në pajtim me paragrafin 2 nuk do të konsiderohen akte diskriminuese.

¹³Shih gjithashtu a) Urdhëresa e Këshillit të Bashkimit Europian 2000/43/EC e 29 qershorit 2000 dhe b) Urdhëresa e Këshillit të Bashkimit Europian 2000/78/EC e 27 nëntorit 2000.

¹⁴Shih gjithashtu Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/32 mbi Miratimin e Ligjit Kundër Diskriminimit nga Kuvendi i Kosovës më 20 gusht 2004.

Një tjetër evoluim i rëndësishëm i legjislacionit është edhe miratimi i Ligjit mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (nr. 03/L-047, 13 mars 2008). Ky ligj përmban dispozita të rëndësishme dhe të hollësishme që synojnë të përmirësojnë cilësinë e jetës, standardet ekonomike sociale, të drejtat dhe garancitë për komunitetet minoritete. Ky ligj synon të garantojë dhe promovojë sa më mirë të drejtat e komuniteteve minoritare duke prekur fusha të ndryshme si pjesëmarrja politike, gjuha, kultura, media, feja, arsimi dhe shëndetësia.

Gjithashtu janë miratuar edhe ligje të tjera si Ligji për Vete-qeverisjen Lokale 2008/03-L-040, Ligji për Financimin e Qeverive Lokale nr. 03/L-049 dhe Rregullorja për funksionimin e fondit për mbështetjen e mediave minoritare, multietnike dhe grupeve tjera të veçanta që adresojnë çështjet e komuniteteve ku hyjnë edhe këto tri komunitete.

Po kështu duke dashur të respektojë identitetin dhe kulturën e komuniteteve është miratuar Ligji No.03/L-064 Për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës i cili ka përcaktuar ditë të veçanta përkujtimore për to, mes të cilave ky ligj ka përcaktuar datën 8 prill si Ditën e Komunitetit Romë si dhe datën 15 shkurt- Ditën e Ashkalinjve. Të tjera ligje të Pakos së Ahtisaarit apo ligje të tjera që janë në proces hartimi apo miratimi kanë dispozita specifike që synojnë garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e kushteve të jetës së komuniteteve romë, ashkali, egjiptas.

Masat

Institucionet e Republikës së Kosovës

Institucionet qeverisëse të Republikës së Kosovës do ta sigurojnë zbatimin efektiv të legjislacionit kundër diskriminimit për luftimin e diskriminimit racor dhe etnik në të gjitha fushat, qasjen në arsim, punësim, strehim, shëndetësi dhe shërbime sociale dhe të qytetarisë. Institucionet e Republikës së Kosovës do t'i përfshijnë përfaqësuesit e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në proceset e hartimit, zbatimit dhe vlerësimit.

Institucionet qeverisëse të Republikës së Kosovës do të marrin parasysh në të gjitha masat dhe programet gjendjen e gruas romë, ashkallike dhe egjiptase, e cila vazhdimisht është viktimë e diskriminimit etnik dhe gjinor.

Institucionet qeverisëse të Republikës së Kosovës do të vlerësojnë rregullisht, si në nivelin lokal ashtu edhe në nivelin qendror rezultatet e këtyre politikave, strategjive dhe masave dhe do t'i përfshijnë përfaqësuesit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptasë në procesin e vlerësimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të hartoj dhe zbatoj politikë të qartë të "trajtimin të barabartë" në të gjitha fushat e jetës si në ekonomi, arsim, shëndetësi, strehim dhe qasje në shërbime.

Në pajtim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave, institucionet relevante të Republikës së Kosovës do të dokumentojnë të gjitha llojet dhe rastet relevante të diskriminimit për të vlerësuar më mirë gjendjen dhe për t'iu përgjigjur nevojave të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të botojë raporte periodike mbi çështjen e diskriminimit dhe politikat, strategjitë dhe masat për adresimin e kësaj çështjeje.

Me anë të inkurajimit të dialogut apo konsultimeve të mirëfillta, me institucionet relevante të Kosovës do të përmirësojnë marrëdhëniet në mes romëve, ashkalijve dhe egjiptasve dhe grupeve

të tjera etnike, me qëllim të promovimit të tolerancës, dialogut ndëretnik dhe tejkalimit të paragjykimëve dhe stereotipeve negative- diskriminuese në të dyja anët.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të nxis punësimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në sektorët nevralgjik të drejtësisë, Ombudspersonit dhe forcave të rendit për të ngritur besimin e këtyre komuniteteve për këto institucione.

Qeveria e Republikës së Kosovës do ta informojë dhe vetëdijesoj popullatën e Republikës së Kosovës për Ligjin Kundër Diskriminimit. Veç kësaj, fushatat specifike të vetëdijesimit për Ligjin Kundër Diskriminimit do të kenë në shënjestër komunitetet, romë, ashkali dhe egjiptasë. Këto fushata do të përfshijnë informata për ekzistimin e Njesisë Kundër Diskriminimit përbrenda Institucionit të Ombudspersonit dhe disponueshmërinë e zyrave të tyre rajonale.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të nxis punësimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në gjithë sektorin publik dhe në mënyrë të veçantë në ato pozicione që mundësojnë monitorimin e zbatimit të ligjit kundër-diskriminim apo që merren me ankimimin dhe vlerësimin e masave.

Qeveria e Republikës së Kosovës , në bashkëpunim me OJQ-të dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, do të organizojë trajnime për juristë, gjykatës dhe prokurorë mbi Ligjin Kundër Diskriminimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të përkrah zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të shoqërisë civile nga komunitetwt, Romë, Ashkali dhe Egjiptase për ta adresuar diskriminimin e pjesëtarëve të komunitetet dhe për të ofruar këshilla ligjore.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurohet për themelimin dhe forcimin e mekanizmave në nivelin lokal dhe qendror që merren me zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë qasje në drejtësi për romët, ashkalljtë dhe egjiptasit dhe zbatimin e procedurave adekuate kur rastet e diskriminimit të sillen para drejtësisë. Ato do ta lehtësojnë qasjen në drejtësi për pjesëtarët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase nëpërmjet masave siç janë ndihma ligjore dhe ofrimi i informatave në gjuhën rome.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë që të gjitha rastet e dyshuara të diskriminimit do të hetohen në hollësi dhe në mënyrë objektive si dhe do të ofrojë mbrojtjen e duhur për viktimat e abuzimeve ose për dëshmitarët.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të garantojë se nuk do të ketë mos-ndëshkueshmëri për autorët e akteve diskriminuese dhe të dhunës që mund të shfaqen në të ardhmen apo që janë manifestuar gjatë së kaluarës, duke siguruar që policia do të ndërmarrë veprime hetuese dhe ndëshkuese efektive.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të marr parasysh së në të gjitha masat dhe programet gjendjen e gruas rome, ashkallike dhe egjiptase, e cila është viktimë e diskriminimit etnik dhe gjinor.

Gjatë themelimit të mekanizmave dhe trupave për luftë kundër diskriminimit dhe gjatë zbatimit të politikave, strategjive dhe masave kundër diskriminimit, institucionet relevante të Republikës së Kosovës do të konsultohen dhe kërkojnë përkrahjen e nevojshme të këtyre komuniteteve dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Institucioni i Ombudspersonit duhet të fuqizohet dhe është e nevojshme që pavarësia e funksionimit të këtij institucioni të garantohet.

Shoqëria Civile

OJQ-të rome, ashkalike dhe egjiptase do të inkurajohen që të hartojnë raporte të rregullta mbi zbatimin e politikave, strategjive dhe masave kundër diskriminimit.

OJQ-të rome, ashkalike dhe egjiptase do të përkrahen që t'i vetëdijësojnë komunitetet e tyre për Ligjin Kundër Diskriminimit dhe si të identifikojnë rastet e diskriminimit.

OJQ-të rome, ashkalike dhe egjiptase do ndihmohen që t'i përkrahin pjesëtarët e komuniteteve të tyre që të kenë qasje në asistencë ligjore falas apo qasje në drejtësi për të gjitha rastet e diskriminimit.

OJQ-të rome, ashkalike dhe egjiptase do të duhej që t'i kushtojnë rëndësi të veçantë çështjeve gjinore, të bëjnë vetëdijësimin rreth diskriminimit të dyfishtë të femrave rome, ashkalike dhe egjiptase si dhe të nxisin përfshirjen e femrave në aktivitete e shoqërisë civile dhe politikës.

OJQ-ve rome, ashkalike dhe egjiptase duhet t'ju sigurohet pjesëmarrja në vendimmarrje dhe duhen konsultuar prej autoriteteve për politikën relevante për luftën kundër diskriminimit të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve.

Organizatat dhe OJQ-të ndërkombëtare

Pritet që rganizatrat dhe OJQ-të ndërkombëtare ta përkrahin Qeverinë e Republikës së Kosovës që të përmirësoj kushtet e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve dhe të ofroj trajnime për grupet e ndryshme të interesit për zbatimin dhe fushëveprimin e Ligjit Kundër Diskriminimit në Kosovë.

2.2. Arsimi

Përshkrimi i Gjendjes

Analiza e pozitës së romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në sistemin arsimor në Kosovë tregon një gjendje që lë shumë për të dëshiruar. Kjo gjendje karakterizohet me nivel të ulët të vijimit në shkollimin e detyrueshëm, me një numër tejet të vogël të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve që vijojnë mësimet në shkollim të lartë apo në universitet, me numër tejet të vogël të mësuesve romë, ashkali dhe egjiptas dhe me shkallë të lartë të largimit nga shkolla, në veçanti në mesin e vajzave.

Një tjetër problem që haset prej romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në sistemin arsimor është fakti që fëmijët e këtyre komuniteteve kryesisht vijojnë mësimet në shkolla shqipe, por edhe në shkolla dhe klasë në gjuhën turke dhe boshnjake.

Përveç kësaj, një numër i konsiderueshëm i fëmijëve vijojnë mësimet në gjuhën serbe në enklava serbe apo në komunat e veriut të Kosovës, si në Mitrovicë dhe Leposavic, ku si rezultat i situatës së tanishme politike institucionet e Republikës së Kosovës dhe Qeveria kanë qasje të kufizuar.

Megjithatë, nuk ka shkolla ku gjuha rome përdoret si gjuhë mësimore dhe gjuha rome nuk mësohet fare në shkollat e Kosovës.

Fatkeqësisht, ka tejet pak të dhëna – nganjëherë edhe të dhëna konfliktuoze – për gjendjen e tri komuniteteve në sistemin arsimor. Të dhënat për popullsinë rome janë më të shumta sesa ato për komunitetet ashkali dhe egjiptas. Megjithatë, të gjitha të dhënat japin një porosi të përbashkët: masa të menjëhershme janë të domosdoshme që të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes aktuale. Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji ka paraqet të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat të Ministrisë për Arsim (MASHT) për për edukimin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në Kosovë¹⁵

Numri i Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptasve që vijnë në mësimin parashkollor: **176**

Numri i Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptasve që vijnë në shkollën fillore: **4.153**

Numri i Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptasve që vijnë në shkollën e mesme: **204**

Ndërkohë programi për Përkrahjen e Edukimit (ESP) i Institutit për Shoqëri të Hapur ka botuar këto të dhëna të mëposhtme që trajtojnë vetëm popullsinë roma:

Të dhënat e ESP-së për edukimin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në Kosovë¹⁶

Numri i Romëve që vijnë në shkollën fillore Roma: **1.332 persona: 13.3% - 17.6%**

Numri i Romëve që kanë mbaruar shkollën fillore: **6417-8493 persona: 32.4%**

Numri i Romëve që vijnë në shkollën e mesme: **168 persona: 3.4% - 4.5%**

Numri i Romëve që kanë mbaruar shkollën e mesme: **891-1180 persona: 4.5%**

Numri i Romëve që vijnë në shkollimin terciar: **10 persona: 0.2% - 0.3%**

Numri i Romëve që kanë mbaruar shkollimin terciar: **79-105 persona: 0.4%**

Të dhënat nga Raporti për Zhvillimin Njerëzor në Kosovë i vitit 2004 tregojnë një gjendje të mjerë.

Të dhënat e UNDP-së për edukimin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në Kosovë¹⁷

Analfabetë: 16%

Fëmijët që vijnë në mësimet në shkollën fillore: **75%**

Fëmijët që vijnë në mësimet në shkollën e mesme: **25%**

Fëmijët që vijnë apo kanë mbaruar shkollën e mesme: **1.4.%**

Studimi i UNDP-së i vitit 2005 për romët në Evropën Juglindore dhe Qendrore “Fytyrat e Varfërisë” ka ofurar të dhëna edhe më negative për nivelin e aftësive për shkrim dhe lexim:

Niveli i aftësive për shkrim dhe lexim sipas UNDP-së¹⁸

Mosha 15-24: jo-Roma **98%** Roma: **65%** femrat Roma: **56%**

Mosha 25-34: jo-Roma **98%** Roma: **76%** femrat Roma: **69%**

Të dhënat nga ESP-ja si dhe të dhënat e UNDP-së për nivelin e aftësive për shkrim dhe lexim nuk flasin vetëm për një pozitë të pafavorshme; ato gjithashtu tregojnë përkeqësimin e gjendjes së tyre në edukim gjatë viteve të fundit.

¹⁵ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Statistikat Arsimore në Kosovë 2005-06.

Internet: <http://www.ks->

[gov.net/masht/DefaultPC.aspx?CaseID=2&LangID=EN&ModID=16&ItemID=974](http://www.ks-gov.net/masht/DefaultPC.aspx?CaseID=2&LangID=EN&ModID=16&ItemID=974)

¹⁶ Institutit për Shoqëri të Hapur, Programi për Përkrahjen e Edukimit, Monitorimi i Edukimit të Romëve, Baza Statistikore për Evropën Qendrore dhe Juglindore. Budapest 2006. Shumica e të dhënave janë të bazuara në kalkulime. Internet:

http://www.soros.org/initiatives/esp/articles_publications/publications/monitoring_20061218

¹⁷ UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor për Kosovë 2004, Prishtinë 2004

¹⁸ UNDP, Fytyrat e Varfërisë. Bratisllavë 2005

Arsyet për këtë gjendje të mjerueshme janë të shumëfishta: si pasojë e konfliktit të vitit 1998-99, shumë romë, ashkali dhe egjiptas ishin të detyruar të largohen nga Kosova ndërsa ata që mbetën në Kosovë kaluan nëpër një periudhë tensioni ndëretnik që disa herë i ka penguar fëmijët të shkojnë në shkollë;; të tjerët kishin vijuar mësimet në gjuhën serbe në vitet e 90ta dhe nuk mund ti vazhdonin mësimet në gjuhën shqipe.

Gjendja ekonomike e familjeve romë, ashkalinj dhe egjiptase, varfëria, tensionet ndëretnike, ngacmimet dhe diskriminimi në shkolla është fenomen dhe faktor i shpeshtë i cili ndaloj fëmijët të shkojnë në shkolla. Andaj këto rrethana sjellin nevojën e ndërmarrjes së masave tjera plotësuese afirmative që do të mundësonin regjistrim, vijimin më të madh të fëmijëve në shkolla dhe do ta ulnin shkallën e largimit të hershëm nga shkolla.

Megjithatë, mungesa e vetëdijësimit mbi rëndësinë dhe vlerën së edukimit formal, që mbretëron në mesin e disa segmenteve të caktuara të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas, kontribuon edhe më shumë në këtë gjendje. Ky vlerësim vlen posaçërisht për edukimin e vajzave.

Kjo gjendje do t'a përkeqësoj edhe më tej me kthimin e azilkërkuesve të refuzuar nga Evropa Perëndimore të cilët në shumicën e rasteve mund edhe të mos flasin gjuhët e përbashkëta të udhëzimit – shqip, serbisht/boshnjakisht apo turqisht, por gjuhën romë apo gjuhën që kanë folur në vendin pritës – gjermanisht, frëngjisht, etj.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vetëdijshme për gjendjen specifike të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në sistemin arsimor dhe do të ndërmarr masa specifike për përmirësimin e qasjes në të gjitha nivelet e arsimit dhe për ta përmirësuar kualitetin e arsimit për këto komunitete.

Korniza Ligjore dhe Politike

Sistemi arsimor në Kosovë po kalon nëpër periudhën e transformimit të sistemit të kaluar arsimor në një sistem modern në përputhje me kërkesat e shoqërisë moderne, fleksibile dhe bazuar në njohuri.

Në përgjithësi, legjisllacioni dhe politikat arsimore iu referohen dokumenteve dhe obligimeve më relevante ndërkombëtare. Në vitet e fundit, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi disa ligje që kanë të bëjnë me arsimin për ta zhvilluar më tej dhe modernizuar sistemin arsimor kosovar.

Ky kapitull duhet të marrë parasysh kornizën ekzistuese të ligjeve dhe obligimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë. Megjithatë, kapitulli do të sjellë edhe masa që synojnë përmirësimin e gjendjes së romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në sistemin arsimor duke u bazuar në praktikën më të mira të vendeve tjera.

Ligjet dhe Strategjitë Kombëtare për Arsim¹⁹

Kushtetuta e Kosovës ofron një input të rëndësishëm për arsimin e pjesëtarëve të komuniteteve

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve

Ligji për Arsimin Parashkollor (No.02/L-52)

Ligji për Arsimin Primar dhe Sekondar (2002/02)

Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë (2002/03)

Ligji për Inspektimin e Arsimit (2004/37)

Ligji për Arsimin dhe Trajnimin e të Rriturve (No.02/L-24)

¹⁹ Uebfaqja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Internet: <http://www.ks.gov.net/masht/DefaultPC.aspx?LangID=EN>

Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës,
2009-2015

Ligji për Arsimin dhe Trajnimin Vokacional (No.02/L-42)

Ligji për Botimin e Burimeve për Mësim, Materialeve për Lexim dhe Dokumenteve Pedagogjike (No.02/L-67)

Ligji Nr.03/L-068 për Arsim në Komunitat e Republikës së Kosovës

Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Para-Universitar në Kosovë 2007-2017

Strategjia për Zhvillimin e Arsimit të Lartë në Kosovë 2005-2015

Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Komponentin Arsimor të Kosovës 2007-2017²⁰

Draft Strategjia për Zhvillimin e Edukimit Vokacional në Kosovë

Mainstreaming me Evropën: Strategjia e Kosovës për Mësimin e Të Rriturve (2005-2015)

Masat

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse për zbatimin e masave të poshtëpërmendura.

Masat e Përgjithshme dhe Masat e Tërthorta

Të zhvillohet një vlerësim i nevojave në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e komuniteteve për të hartuar një politikë të suksesshme arsimore për komunitetet.

MASHT do të zbatojë modelin e Asistentëve Mësues për arsimin parashkollor (zëvendës edukatorët) dhe për arsim në shkollë fillore.

MASHT do të zhvillojë dhe zbatojë një program të akredituar të trajnimit për Asistentët Mësues

MASHT do të njohë dhe certifikojë profesionin e Asistentëve Mësues

Qeveria do të themelojë dhe kontribuojë në fondin e dedikuar për projektet e posaçme që përmirësojnë gjendjen e tri komuniteteve në sistemin arsimor

Qeveria në bashkëpunim me donatorët vendor dhe të huaj të kontribuojnë në këtë fond

MASHT do të themelojë një linjë buxhetore për alokimin e bursave për studentë që kanë performancë më të lartë se mesatarja dhe për studentë nga familjet me kushte të vështira ekonomike që vijojnë mësimet në shkolla sekondare, shkolla të larta sekondare apo në universitete

MASHT do të zbatojë një kuotë për punësimin e stafit pedagogjik dhe administrativ me origjinë rome, ashkali dhe egjiptase në sistemin arsimor

MASHT do të ofrojë libra shkollor falas për studentë nga familjet vulnerabile në të gjitha nivelet e sistemit arsimor

Anti-Diskriminimi

MASHT, në partneritet me OJQ-të, do të organizojë një studim mbi diskriminimin e romëve, ashkallive dhe egjiptasve në sistemin arsimor në Kosovë si dhe për ekzistencën apo jo të

²⁰ Ky dokument është miratuar nga Ministria e Arsimit para përgatitjes dhe miratimit të këtij dokumenti strategjik.

segregimit. Bazuar në këtë studim, MASHT do të adoptojë masa që adresojnë segregimin dhe diskriminimin në sistemin arsimor.

Qeveria do të miratojë akte ligjore që pengojnë dhe pamundësojnë çdo lloj të segregimit të fëmijëve në shkolla të ndara, në ndërtesa të ndara, në klasa të ndara apo brenda klasës bazuar vetëm në përkatësinë etnike. Përjashtime do të bëhen vetëm në raste kur fëmijët janë të ndarë për të qenë në gjendje t'i ndjekin mësimet në një gjuhë të caktuar apo për shkak të distancës nga shkolla me nxënës të përkatësisë tjetër etnike.

Qeveria do të zbatojë kushte ligjore që parashohin masa efektive për parandalimin e segregimit dhe për të lejuar neutralizimin e segregimit. Përveç kësaj, duhet të parashihen edhe masa efektive për ndërprerjen e diskriminimit.

Stafi shkollor dhe pedagogjik do të trajnohen në programe edukative që nxisin tolerancën harmoninë ndërtnike dhe ndërkulturore dhe të rrisin vetëdijësinë kundër diskriminimit

Pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas do të trajnohen për të qenë në gjendje ta dallojnë diskriminimin dhe segregimin në shkollë dhe të veprojnë në mënyrë adekuate.

Arsimi Fillor dhe i Mesëm

Të ofrohet transport falas për të gjithë fëmijët që vijnë në shkolla fillore dhe të mesme në lokacionet që janë më larg se dy kilometra nga shtëpitë e tyre.

MASHT-i do t'iu ofrojë mundësi donatorëve të përkrahin vijimin në shkollë të studentëve nga komunitetet që të ju ofrojnë bursa për këtë qëllim.

Shkollimi i Lartë Sekondar dhe Shkollimi Universitar

MASHT do të lejojë klasat përgatitore për studentë që synojnë të vijojnë mësimet në shkollimin e lartë sekondar dhe në shkollimin universitar.

MASHT do të organizojë dhe zhvillojë klasat përgatitore në nivelin lokal.

Autoritetet lokale arsimore në bashkëpunim me organizatat apo përfaqësuesit e komunitetit do të zhvillojnë fushata të vetëdijesimit për përparësitë e shkollimit të lartë me ndihmë të personaliteteve të suksesshme.

MASHT do të sigurojë hapësira në fjetinat të nxënësve dhe studentëve.

MASHT do të caktojë kuotën për studentë me origjinë rome, ashkali dhe egjiptase në shkollat sekondare, shkollat e larta dhe në universitete.

MASHT do t'u jap bursa studentëve për t'i motivuar ata për ta mbaruar shkollimin.

Hartimi i programeve mësimore të përshtatshme dhe trajnimi i mësuesve

Trajnimi dhe kualifikimi plotësues i mësuesve nga komunitetet romë, ashkali, egjiptas në shkollimin e detyrueshëm

Organizimi i shkollave verore për mësuesit që mbajnë mësimin në gjuhën rome.

Futja e gjuhës rome si lëndë (fakultative) në nivele të ndryshme të sistemit arsimor.

Zhvillimi i programeve për mësimin e gjuhës dhe programeve të trajnimit në gjuhën rome për mësuesit që mbajnë mësimet në gjuhën rome.

Hartimi i programeve për lëndë plotësuese shkollore që mund të mësohen në gjuhën rome.

Përfshirja e moduleve themelore të traditës, kulturës dhe historisë rome, ashklike dhe egjiptase në programin e përgjithshëm të gjuhëve të tjera mësimore.

Hartimi i moduleve të avancuara të traditës, kulturës dhe historisë rome, ashklike dhe egjiptase në programin e përgjithshëm të gjuhëve të tjera mësimore (si lëndë fakultative).

MASHT do të themelojë një komision të ekspertëve të programit dhe përfaqësuesve të tri komuniteteve që do të hetojnë të gjitha tekstet ekzistuese dhe të planifikuara shkollore për të parë nëse këto përfshijnë terma dhe shprehje diskriminuese.

Hartimi i moduleve të programit që promovojnë anti-diskriminimin dhe luftimin e paragjytimeve si dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Zhvillimi i aktiviteteve jashtëshkollore, promovimi i vlerave, trashëgimisë dhe identitetit të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase në shkolla që kanë numër të konsiderueshëm të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptas.

Qasja Pjesëmarrëse dhe Informatat dhe Kontakti

Institucionet qeverisëse lokale arsimore, shkollat, dhe OJQ-të do të angazhohen në aktivitete të përbashkëta që synojnë përmirësimin e vijimit të orëve mësimore (rritjen e regjistrimit të fëmijëve në arsimin parashkollor dhe në shkollë fillore, përmirësimin e vijimit ditor të orëve mësimore, zvogëlimin e shkallës së largimit nga shkolla)

Zbatimi i stimulimeve dhe përdorimi i personaliteteve të suksesshme nga komunitetet për t'i motivuar fëmijët dhe prindërit që të vijnë rregullisht orët mësimore

MASHT dhe Institucionet qeverisëse lokale arsimore do të ftojnë përfaqësuesit e prindërve, përfaqësuesit e komunitetit dhe shoqërinë civile rome, ashklike dhe egjiptase për të marrë pjesë në hartimin dhe procesin vendimmarrës të politikave arsimore që janë relevante për komunitetet.

Institucionet qeverisëse lokale arsimore në bashkëpunim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, do të hartojnë planin arsimor komunal të veprimit, duke i identifikuar prioritetet për tri vitet në vijim.

Edukatorët dhe mësime të ndërtuar besim dhe për të diskutuar me prindërit punën e fëmijëve të tyre në shkollë. Këto vizita shërbejnë edhe për të ndërtuar besim dhe gatishmëri për bashkëpunim në mes komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase dhe institucioneve arsimore.

Prindërit do të ftohen rregullisht të marrin pjesë në aktivitetet shkollore dhe në takime me mësime të ndërtuar besim dhe udhëheqësit e shkollave.

Shoqatat e Prindërve dhe Mësime të ndërtuar besim do të angazhohen në monitorimin e shkollave për të siguruar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në të gjitha ngjarjet relevante.

Personat e kthyer dhe rastet e tjera të veçanta

Do të organizohen kurse gjashtëmujore për fëmijët që janë kthyer nga vendet e tjera. Kurset do të mbahen në të gjitha gjuhët e mundshme të zgjedhura për edukim të mëtutjeshëm dhe do të adresojnë kulturat dhe traditat e ndryshme të të gjitha komuniteteve në Kosovë. Kurse plotësuese mund të organizohen sipas kërkesës dhe nevojës së personave të kthyer.

Institucionet qeverisëse lokale arsimore, shkollat dhe OJQ-të do të ofrojnë udhëzime plotësuese për fëmijët me vështirësi në procesin e mësimit nëpër shkolla apo nëpër qendrat e komuniteteve.

Institucionet qeverisëse lokale arsimore, shkollat dhe OJQ-të do të ofrojnë përkrahje për fëmijët për detyra të shtëpisë dhe studime plotësuese të cilët nuk mund të mësojnë në shtëpi.

Zhvillimi i programeve të vetëdijesimit që adresojnë përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt të edukimit.

Ofrimi i këshillimit për dhe aktivitetet e trajnimit për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Zhvillimi i fushatave informative për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptase për programet ekzistuese të shkollimit në zonat e banuara nga këto komunitete.

MASHT dhe autoritetet lokale arsimore në bashkëpunim me OJQ-të do të ofrojnë përkrahje financiare për përfshirjen e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase në programet ekzistuese dhe do të përkrahin iniciativat e reja për zvogëlimin e shkallës së analfabetizmit.

Aktivitetet jashtëshkollore

MASHT, në bashkëpunim me autoritetet relevante komunale do të themelojë *Qendrat Burimore (Didaktike)* në pesë komuna ku pjesëtarët e këtyre komuniteteve janë të shumtë në numër, duke ofruar mësim plotësues për nxënësit e shkollave fillore, kurse të ndryshme për pjesëtarët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas, do të iniciojë aktivitete kulturore dhe sportive me komunitetin, do të ofrojë programe për luftimin e analfabetizmit dhe do të përshij prindërit në këto aktivitete.

Autoritetet shkollore, në bashkëpunimin me shoqërinë civile, do të organizojnë aktivitete jashtëshkollore për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e edukimit, diversitetit dhe respektimit të drejtave të njeriut.

MASHT, në bashkëpunim me shoqërinë civile, do të zbatojë programe për fëmijët e komunitetit Romë që vijojnë edukimin parashkollor duke u përgatitur për vijimin e mësimi shkollor; mes të tjerave duke i përgatitur ata ta ndjekin gjuhën e shkollës të cilën do ta vijojnë në shkollë fillore. Këto programe do t'iu ofrohen shkollave dhe qendrave për komunitete.

MASHT do të ndihmoj trajnimin e pjesëtarëve të komunitetit Romë apo të folësve të gjuhës Rome për zbatimin e këtyre programeve.

MASHT do të ndërmerren masa për themelimin e bashkëpunimit të ngushtë në mes autoriteteve arsimore, shkollave, qendrave për punë sociale dhe organizatave të shoqërisë civile me synim të parandalimit dhe zvogëlimin të rasteve të mos-vijimit dhe largimit nga shkolla.

2.3. Punësimi dhe Fuqizimi Ekonomik

Përshkrimi i Gjendjes/Situatës

Kosova ballafaqohet me sfida të jashtëzakonshme, sociale, ekonomike dhe sipas disa vlerësimeve ka shkallën më të lartë të papunësisë në Ballkanin Perëndimor. Në veçanti, shkalla e papunësisë në mesin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas është më e lartë se tek të gjitha komunitetet tjera.

Të ardhurat për kokë banori në mesin e këtyre komuniteteve janë shumë të vogla dhe një pjesë e madhe e tyre jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme me më pak se një dollar në ditë.

Të dhënat nga Studimi i Pagave dhe Aftësive i kryer nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (mars 2006) konfirmojnë pozitën e pafavorshme dhe diskriminuese të këtyre tri komuniteteve. Mostra e këtij studimi përfshiu 12.126 punëtorë nga 1547 ndërmarrje, kryesisht nga kompani private; megjithatë, vetëm 0.1% e personave që punonin në këto ndërmarrje ishin romë, ashkali

dhe egjiptas, që do të thotë rreth 12 persona. Studimi gjithashtu tregon se të hyrat mesatare mujore janë të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve, janë më të ulta krahasuar me të ardhurat e serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës.

Shumica e të punësuarve nga këto komunitete duket se janë të punësuar kryesisht në sektorët e pagave të ulëta dhe në pozita që nuk kërkojnë trajnim profesional.

Në përgjithësi, romët, ashkalijtë dhe egjiptasit nuk janë të përfaqësuar mjaftueshëm në forcën punëtore; qoftë kjo në sektorin privat, në sektorin publik (strukturat e shtetërore dhe zyrat e komunave), në ish-ndërmarrjet publike apo në organizatat ndërkombëtare.

Të dhënat për kompanitë publike siç janë KEK-u, PTK-ja, Hekurudhat e Kosovës, dhe Aeroporti i Prishtinës mund ta ilustrojnë situatën aktuale.

Femrat e komuniteteve romë, ashkalijë dhe egjiptas janë në veçanti në pozitë diskriminuese dhe të pafavorshme dhe vuajnë nga shkalla e lartë e braktisjes së institucioneve arsimore.

Perspektiva ekonomike e këtyre tri komuniteteve varet në masë të konsiderueshme jo vetëm nga eliminimi i diskriminimit në tregun e punës por edhe nga pjesëmarrja e tyre e barabartë në sistemin e arsimit. Niveli i rritur i punësimit të pjesëtarëve të këtyre tri komuniteteve varët edhe nga qasja e shtuar e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në arsimin formal (posaçërisht në arsimin sekondar dhe të lartë) dhe në arsimin joformal. Në këtë drejtim, nevojitet bashkëpunimi dhe bashkërendimi i ngushtë i politikave relevante të autoriteteve relevante, posaçërisht të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Arsimit (Shih Kapitullin e Arsimit).

Situata e rëndë ekonomike ndikon në zhvillimin demokratik të shoqërisë, meqë kontribuon në thellimin e mungesës së bashkëpunimit ndërmjet etnive. Shkalla e lartë e papunësisë mund të çojë në izolim të shtuar rezidencial, në pjesëmarrje të ulët në procesin arsimor dhe madje mund të rrisë edhe distancën etnike.

Kjo situatë mund të përkeqësohet edhe më tepër në të ardhmen kur pjesëtarët e këtyre tri komuniteteve do të riatdheshohen me forcë nga vendet e Evropës Perëndimore dhe nga Maqedonia, Mali i Zi apo Bosnja dhe Hercegovina (shih edhe Kapitullin për Kthimin dhe Riintegrimin)

Prandaj, është tejet e rëndësishme që të krijohen mundësi të suksesshme dhe të qëndrueshme të të ardhurave për këto komunitete, meqë kjo paraqet një parakusht thelbësor për integrimin e tyre efektiv në shoqëri dhe për ndërveprimin e tyre me komunitetët e tjera. Prandaj, autoritetet relevante duhet t'i shfrytëzojnë praktikatat më të mira nga vendet e tjera të regjionit..

Në këtë linjë është shumë me rëndësi që Qeveria e Republikës së Kosovës të marrë masa për të eliminuar diskriminimin në tregun e punës dhe për të siguruar qasje të barabartë të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në këtë treg.

Sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, shërbimi civil do të përfaqësojë në mënyrë proporcionale të gjitha komunitetet. Nuk ka të dhëna konkrete për përqindjen e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve dhe pozitave të tyre në shërbimin civil. Për këtë arsye Qeveria e Republikës së Kosovës do të ndërmarrë masa për ta zbatuar legjislacionin ekzistues, dhe do të krijojë një mekanizëm të raportimit të rregullt për të siguruar zbatimin e ligjeve relevante.

Korniza Ligjore dhe Institucionale

E drejta për punë është esenciale për sigurinë sociale dhe ekonomike të çdo individi. Mundësitë e punësimit dhe ato ekonomike i mundësojnë individit ta ruajë mirëqenien e vet dhe nevojat e veta themelore. Për më tepër, puna i sjell individit burimet e nevojshme për jetë dhe iu mundëson

qenieve njerëzore të marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës flet për mundësinë e zbatimit të masave afirmative Neni 58 pika 4 [Përgjegjësitë e Shtetit] i Kushtetutës thotë: “(...) 4. Republika e Kosovës do të miratojë masa adekuate për të promovuar në gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale politike dhe kulturore, barazinë e plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve. Këto masa nuk do të konsiderohen si akt diskriminues. (...)”

Për më tepër, Neni 61 [Përfaqësimi në Institucionet Publike – Punësimi] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i referohet punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve: “(...) Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë të përfaqësimit të barabartë në punësim në strukturat publike dhe ndërmarrjet publike të të gjitha niveleve, përfshirë në veçanti në shërbimin policor në zonat e banuara nga komunitetet përkatëse, duke i respektuar rregullat e kompetencave dhe integritetit që udhëheqin administratën publike (...)”.

Për të ndërtuar një shërbim civil efektiv dhe të paanshëm multietnik në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut No 2001/36 për Shërbimin Civil në Kosovë ende në fuqi, Seksioni 2.1, cek përfaqësimin (përfshirjen) jodiskriminues, të barabartë dhe multietnik, si dhe trajtimin korrekt dhe të barabartë të shërbyesve civil (barazinë) si dhe principet qeverisëse. Për më tepër, rregullorja flet për rekrutimin e shërbyesve civil nën Seksionin 2 (h) Përfshirja: rekrutimi në të gjitha nivelet e Shërbimit Civil do të pasqyroj karakterin multietnik në Kosovë dhe nevojën për përfaqësim të barabartë të të gjitha komuniteteve. Shtojca e Rregullores përcakton Kodin e Sjelljes së Shërbimit Civil që përfshin respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve si kryerjen e paanshme të punëve.

Urdhëresa Administrative (UA) nr. 2003/2 që e zbaton Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, seksioni 10.1 për Përfaqësimin Korrekt në Shërbimin Civil njihet që: “Të gjitha autoritetet punëdhënëse do të monitorojnë dhe zbatojnë procedurat për të siguruar përfaqësimin multietnik dhe barazinë gjinore në ministritë, komunat apo agjencitë ekzekutive të tyre, në pajtim me seksionin 3.3. dhe mund të zbatojnë masat vijuese afirmative: (a) rekrutimin aktiv: ndërmarrja e përpjekjeve të veçanta për identifikimin dhe sollicit aplikacioneve të punës nga komunitetet e nën-përfaqësuar, në veçanti nga personat e zhvendosur dhe refugjatët, (b) adresimin e rezultateve të diskriminimit afatgjatë: zhvillimin e programeve trajnuese në vende të punës për komunitetet e nën-përfaqësuar për zhvillimin e aftësive të tyre për të aplikuar dhe për pozita më të lartë të punës; dhe (c) adresimin e diskriminimit duke siguruar që stafi i kupton politikat anti-diskriminuese dhe që ata kanë qasje në procedurat adekuate të ankesës.

Masat e tjera afirmative në pajtim me standardet evropiane dhe ndërkombëtare mund të ofrohen siç cekët në Nenin 10.2 të Urdhëresës Administrative.

Urdhëresa Administrative nr 2003/2 e obligon Ministrinë e Shërbimeve Publike të hartojë një Instruksion Administrativ (IA) që përmban kritere dhe procedura për zbatimin dhe monitorimin e përfaqësimit korrekt në të gjitha nivelet e shërbimit civil. Tërësia e Udhëzimeve Administrative 2003/01 – 12 që e zbatojnë Urdhëresën Administrative 2003/2 dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2002/36 përfshin në mes tjerash UA 2003/12 mbi Procedurat e Mundësive të Barabarta.

Për më tepër, Ligji Kundër Diskriminimit në Kosovë, Neni 4 i referohet sektorit privat dhe atij publik, përfshirë këtu strukturat publike dhe mbron çdo person natyral apo ligjor nga çdo veprim apo mosveprim që e shkel të drejtën për: (a) kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe okupimit, përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, në çdo degë të aktivitetit, dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë edhe ngritjen në pozitë; (b) qasjen në të gjitha llojet dhe të gjitha nivelet e udhëheqjes vokacionale, trajnimit vokacional, trajnimit e avancuar vokacional dhe ritrajnimit, përfshirë përvojën praktike të punës; dhe (c) punësimin dhe kushtet e punës, përfshirë largimin nga puna dhe pagat.”

Ligji i Punës në Kosovë ndalon të gjitha llojet e diskriminimit në punësim dhe okupim, përfshirë këtu qasjen në trajnimin vokacional, qasjen në punësim dhe në okupimet e veçanta, dhe rregullat dhe kushtet e punësimit.

Rregullorja e UNMIK-ut No. 2003/33 përcakton sigurinë dhe shëndetin dhe mjedisin e punës.

Sa i përket kornizës së politikave, Agjencia për Barazi Gjinore- ABGJ në Zyrën e Kryeministrit ka hartuar Strategjinë për Rritjen e Numrit dhe Përmirësimin e pozitës së Femrës në IPVQ 2006 - 2015 për sigurimin e balancës gjinore në mesin e shërbyesve civil.

Aktualisht, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale po e harton Strategjinë e Punësimit në Kosovë. Departamentet përkatëse në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të caktoj aktivitetet relevante të parapara në të dyja dokumentet për komunitetet vulnerabile dhe duke pasur parasysh situatën vulnerabile të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve.

Politika për Rininë Kosovare dhe Plani i Veprimit 2007-2010 (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhjetor 2006) që promovon integrimin e plotë dhe aktiv të rinisë në shoqëri, nuk bën dallim në mes të komuniteteve të ndryshme. Qeveria megjithatë do të sigurojë që zbatimi i këtij Plani të Veprimit të jetë përfshirës në raport me këto tri komunitete (p.sh. aktivitetet të veçanta për romët, ashkalijë dhe egjiptasit specifik).

Kosova ende nuk ka zhvilluar strategji për uljen e varfërisë. Megjithatë, Qeveria në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare do të sigurojë që strategjia e ardhshme do të adresoj pozitën e pafavorshme të komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptas.

Plani Strategjik Zhvillimor i Kosovës (PSZHK) dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) përbëjnë dokumentet kryesore planifikuese financiare për Kosovën për vitet e ardhshme. Prandaj, është shumë e rëndësishme që PSZHK-ja dhe KASH-i të referohen zbatimit të strategjisë dhe të parashohin burimet e caktuara financiare.

Masat

Të Dhënat mbi Tregun e Punës

Institucionet qeveritare relevante do të përfshijnë të dhëna specifike për të gjitha komunitetet, përfshirë romët, ashkalijë dhe egjiptasit për gjendjen e tregut të punës në mënyrë që të monitorohet sa më lehtë niveli i integritetit si dhe gjendja social ekonomike e këtyre komuniteteve

Institucionet qeveritare relevante do të bëjnë një analizë të gjendjes për të marrë të dhëna më të besueshme dhe më përmbajtjesore për gjendjen e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në tregun e punës.

Bashkërendimi

Qeveria e Republikës së Kosovës do të vendos një bashkërendim në mes të ministrive relevante të linjës për të krijuar lidhje të forta në mes edukimit shkollor dhe mundësive të punësimit për tri komunitetet, përfshirë këtu edhe masat për lehtësimin e transferimit nga shkolla në punë.

Qeveria do të ndërtoj një mekanizëm bashkërendues, përfshirë përfaqësuesit e ministrive relevante të linjës dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve, për hartimin dhe politikës përmbajtjesore për punësimin përfshirës.

Hartimi i Politikave

Qeveria e Republikës së Kosovës, në politikat e saj si dhe shërbimi publik në përgjithësi do ta respektoj në tërësi politikën anti-diskriminuese dhe do të ndërtoj mekanizma për luftimin e praktikave diskriminuese në ekonomi.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të përdor të gjitha dokumentet relevante të Bashkimit

Evropian për përfshirjen sociale si udhërrëfyes për aktivitetet e tyre për punësimin e rritur dhe vetëpunësimin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve.

Në dritë të rëndësisë së ardhshme të sektorit privat, Qeveria do të hartojë kornizën relevante që do të lejojë zbatimin e politikës përmbajtjesore të përfshirjes, me synim specifik të komunitetet vulnerabile si romët, ashkalijtë dhe egjiptasit.

Institucionet qendrore do t'i përqendrojnë masat e tyre në rritjen e punësimit, duke krijuar një numër më të madh të ndërmarrësve nga tri komunitetët dhe duke shtuar numrin e personave të punësuar formal, në mes tjerash nëpërmjet masave aktive të tregut të punës në sektorin publik dhe atë privat.

Qeveria është e vetëdijshme që kapacitetet e ministrive relevante, në veçanti Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për menaxhimin e këtyre masave, duhet të rriten.

Rishikimi i Legjislacionit

Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare të pranishme në Kosovë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të këtyre komunitetëve, do të analizojë legjislacionin relevant (ligjet dhe rregulloret mbi punësimin) për masa për mundësitë e barabarta dhe për ndalimin e diskriminimit etnik apo racor në punësim dhe ti ndryshoj këto nëse është e nevojshme.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të :

zbatojë masa afirmative për romët, ashkalijtë dhe egjiptasit në ekonomi siç është paraparë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

sigurojë që romët, ashkalijtë dhe egjiptasit që nuk i posedojnë të gjitha dokumentet e nevojshme, nuk do të përjashtohen nga pjesëmarrja në të gjitha masat që kanë të bëjnë me përmirësimin e pozitës së romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në ekonomi.

marrë masa për të njohur diplomat apo kualifikimet e fituara jashtë vendit si dhe do të marrë në konsideratë përvojën e përfituar gjatë qëndrimit jashtë vendit.

zbatojë legjislacionin për qasje të fuqishme dhe të rregulluar për arritjen e barazisë së romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në punësim.

Masat Aktive të Tregut të Punës – Punësimi

Në dritë të nën-përfaqësimit të tri komuniteteve në forcën e punës dhe përkundër kufizimeve financiare dhe nevojën për ta ulur numrin e punëtorëve në sektorin publik, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe sektori publik në përgjithësi do të zbatojnë masa afirmative për ta rritur numrin e pjesëtarëve të tri komuniteteve të punësuar në sektorin publik.

Qeveria e Republikës së Kosovës:

do t'i inkurajojë komunat të hartojnë strategjitë e tyre apo planet e veprimit për fuqizim ekonomik për romët, ashkalijtë dhe egjiptasit apo ti përfshijnë brengat dhe nevojat e tyre në strategjitë e përgjithshme të zhvillimit lokal.

Masat afirmative në sektorin privat mund të zbatohen qoftë nëpërmjet përfshirjes së romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në programet e përgjithshme që përkrahin punësimin e grupeve vulnerabile apo nëpërmjet programeve që synojnë në mënyrë specifike romët, ashkalijtë dhe egjiptasit.

do të zbatojë masa efektive për tregun e punës siç janë stimulimet për pagimin e tatimeve, subvencionet e rrogave në veçanti për punësimin e pjesëtarëve të tri komuniteteve dhe/apo të vendos garanci që programet ekzistuese që zbatojnë masat efektive të tregut të punës do të

përfshijnë një numër të konsiderueshëm të pjesëmarrësve romë, ashkalijë dhe egjiptas.

do t'i kushtoj vëmendje të veçantë zbatimit të masave për femrat romë, ashkali dhe egjiptase apo përfshirjes së tyre në programet specifike për femra.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë që pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas do të punësohen nga autoritetet në nivelin qendror dhe komunal për të arritur një përqindje korrekte të këtyre komuniteteve.

Institucionet qeverisëse qendrore dhe komunale do të bashkërendojnë me qendrat komunale për punësim të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për t'i inkurajuar pjesëtarët e tri komuniteteve për të aplikuar për pozita më të lartë në punë.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të punësojë ndërmjetësues/asistentë nga tri komunitetet që punojnë në sektorin e arsimit dhe në sektorin e shëndetësisë, duke ofruar burime buxhetore për punësimin e tyre.

Me rastin e zbatimit të programeve publike të punës, Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar do të sigurojë që romët, ashkalijët dhe egjiptasit do të përfshihen në programet publike të punës. Programet publike të punës do të përfshijnë edhe komponentin e trajnimit profesional.

Organizatat ndërkombëtare në Kosovë duhet të ofrojnë praktikantë më të mira dhe të punësojnë romë, ashkalijë dhe egjiptas, dhe të caktojnë synime për punësimin e romëve, ashkalijë dhe egjiptas në mesin e stafit të tyre.

Masat Aktive të Tregut të Punës – Punësimi/Trajnimi Profesional

Pas studimeve përkatëse, Qeveria do t'i përqendrojë programet për trajnim profesional për romët, ashkalijët dhe egjiptasit në nevojat e tregut, duke marrë parasysh sektorët më të mëdhenj të punësimit siç është për shembull sektori i energjitikës apo të tjerë sektorë publik.

Qeveria dhe komunat do të hartojnë programe të trajnimit apo promovimit për sektorin publik, duke i synuar në mënyrë specifike romët, ashkalijët dhe egjiptasit apo t'i përfshijë ata në programet e përgjithshme.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të zbatojë masa për lehtësimin e transferit më të mirë nga shkolla në tregun e punës.

Institucionet relevante do të mbajnë trajnime për zhvillim të kapaciteteve dhe aftësim profesional për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas për ta rritur konkurrencën e tyre në tregun e punës.

Vetëpunësimi/Sipërmarrja

Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës do të:

organizojnë programe trajnimi për ndërmarrësit dhe ndërmarrësit potencial nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas dhe do t'i përfshijnë ata në programet e përgjithshme, duke i shfrytëzuar aftësitë, aktivitetet dhe ekspertizën ekzistuese në mesin e këtyre komuniteteve.

inkurajojnë zhvillimin e inkubatorëve të biznesit, shërbimet këshilluese për biznese, klube të punës, etj., për pjesëtarët e tri komuniteteve apo të sigurojnë që ata janë të përfshirë në mënyrë adekuatë në këto institucione.

mbështesë/ inkurajojë Institucionet Mikro-financiare për të krijuar skema mikro-kreditore apo programe të grantit specifikisht për komunitetet, romë, ashkali dhe egjiptas dhe t'i përfshijnë ata në programet e përgjithshme, duke marrë parasysh gjendjen specifike të shumicës së këtyre pjesëtarëve të komuniteteve siç është mungesa e sigurisë që vjen si pasojë e pronës së

paregjistruar, joekzistuese apo pronës së shkatërruar, nevojën për periudha më të gjatë të mirësisë, apo nevojën e tyre për përkrahje për qasje në treg (Shih gjithashtu Kapitullin për Qasje në Strehim dhe Vendbanimet Joformale).

zbatojnë masa të përkohshme, veprime afirmative, duke iu mundësuar ndërmarrësve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas që të marrin pjesë në tenderë apo kur aplikojnë për kontrata.

zbatojnë masa të përkohshme që lehtësojnë transferimin e aktiviteteve joformale ekonomike në aktivitetet formale ekonomike. Këto masa do të përfshijnë heqjen apo lehtësimin e barrës fiskale apo subvencionim të pagave për ndërmarrjet rishtazi të regjistruara të vogla dhe të mesme në pronësi të pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas.

inkurajojë, përgatis dhe përkrah romët, ashkallijtë dhe egjiptasit që të angazhohen në aktivitete të pavarura bujqësore.

Konceptet Inovative të Politikës së Përfshirjes

Qeveria e Republikës së Kosovës gjithashtu, është e përkushtuar ti përdor konceptet inovative siç është respektimi i kontratës, p.sh. në programe të caktuara të investimeve publike, apo rregullat e punësimit korrekt.

Qeveria dhe komunat do të konsiderojnë zbatimin, kurdo që është e zbatueshme, e konceptit të respektimit të kontratës gjatë dhënies së kontratave për kompani. Autoritetet qendrore dhe komunat do të sigurojnë që kompanitë që punojnë në programet e parapara të investimeve publike, në veçanti në programet për zhvillimin e infrastrukturës, do të punësojnë një përqindje të konsiderueshme të romëve, ashkallijve dhe egjiptasve.

Në procesin e privatizimit të ardhshëm të mundshëm, autoritetet relevante do të konsiderojnë zbatimin e konceptit të respektimit të kontratës gjatë dhënies së kontratave për ndërmarrjet shoqërore duke i obliguar kompanitë e shpërblyera që përqindja-x e fuqisë së ardhshme punëtore rekrutohet nga mesi i komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptas.

Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i inkurajojë kompanitë private që të paraqiten vullnetarisht për konceptet e politikave përfshirëse siç është Përgjegjësia Sociale e Korporatave apo Ndikimi Global i Kombeve të Bashkuara.

Organizatata ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë duhet ti respektojnë plotësisht qasjet e politikës përfshirëse siç është respektimi i kontratës, rregullat e punësimit korrekt apo Ndikimin Global të Kombeve të Bashkuara.

Organizatata ndërkombëtare inkurajohen të aplikojnë praktikat më të mira përfshirëse duke dhënë kontrata vetëm kur kompanitë mund të dëshmojnë që përqindja-x e fuqisë së tyre punëtore është rekrutuar nga komunitetet roma, ashkali dhe egjiptas.

2.4. Çështjet Shëndetësore dhe Sociale

Përshkrimi i Gjendjes

Gjatë analizimit të statusit shëndetësor të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në Evropën Qendrore dhe Juglindore, ekspertët pajtohen për tri pika: a) ka shumë pak të dhëna për statusin shëndetësor të romëve, ashkallijve dhe egjiptasve (kjo situatë është edhe më e keqe në Kosovë si pasojë e sistemit tejet të dobët të informimit për shëndetësi në përgjithësi), b) të dhënat ekzistuese tregojnë që ka dallime tejet të mëdha në mes popullatës rome dhe shumicës dhe c) shëndeti i dobët në mesin e popullsisë rome është ngushtë i

lidhur me faktin që ata janë jashtëzakonisht të mbi-përfaqësuar në mesin e popullatave të varfra.²¹

Një studim i kryer nga Instituti për Shoqëri të Hapur në vitin 2007 në Evropën Juglindore (Kosova nuk është përfshirë) tregon një shkallë të lartë të sëmundjeve kronike siç është diabeti, sëmundjet e zemrës, mungesa e vitaminave, dhe distrofia në mesin e fëmijëve të komuniteteve romë, ashkali, egjiptas.²²

Ekzistojnë vetëm të dhëna të kufizuara për statusin shëndetësor të romëve, ashkalljve dhe egjiptasve në Kosovë. Nëse supozojmë që statusi i përgjithshëm shëndetësor i komuniteteve është i ngjashëm me statusin shëndetësor të komuniteteve rome në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe që në Kosovë ekziston një zbrazëti e ngjashme në mes të statusit shëndetësor të popullatës shumicë dhe popullatës rome si në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, mund të konkludojmë që statusi shëndetësor i tri komuniteteve duhet të jetë lë shumë për të dëshiruar, duke marrë parasysh statusin përgjithësisht e dobët shëndetësor të popullsisë në Kosovë në krahasim me vendet e rajonit..

Këtë pohim e përkrahin disa të dhëna të pakta:

Sipas studimeve mbi shëndetësinë riprodhuese në komunitete, të zhvilluar nga Mjekët e Botës (DOW) në vitin 2001, 56 % e nënave të përfshira në këtë studim nga kampi për persona të zhvendosur të komuniteteve romë, ashkali, egjiptas në Plemetin kanë lindur në shtëpi; 12% raportuan që kanë humbur foshnjën në muajin e parë pas lindjes. Fëmijët e lindur nëpër shtëpi shpesh nuk regjistrohen në regjistrat civil.

Studimi gjithashtu zbuloi që 40% e nënave ashkali në komunën e Fushë Kosovës nuk janë takuar me ndonjë mjek gjatë shtatzënisë së tyre; të gjitha përveç nëntë përqind prej tyre kanë thënë se nuk menduan se kjo do të ishte e rëndësishme. 75 përqind të femrave seksualisht aktive të përfshira në këtë studim nuk kanë përdorur asnjë mjet kontrceptiv; 79 përqind prej tyre nuk kishin asnjë informatë për mjetet kontrceptive. .

Sipas Raportit të Zhvillimit Njerëzor të UNDP-së për Kosovë (2004) 74.77% e romëve, ashkalljve dhe egjiptasve kanë "burim të sigurtë të ujit të pijshëm" dhe 61.12% kanalizim për ujin e hedhur nga mbeturinat dhe 25.24% nuk kanë qasje në ujë të pijshëm. Publikimi i UNDP-së "Fytyrat e Varfërisë, Fytyrat e Shpresës" (2005) jep edhe më tepër indikacione për kushtet e jetesës që ndikojnë në gjendjen shëndetësore të komuniteteve në Kosovë. 72% nuk kanë tualet apo banjo në shtëpi ndërsa e njëjta vlen edhe për 45% të popullatës shumicë. Për më tepër, raporti thotë që 86% e të anketuarve romë, ashkali dhe egjiptas deklaruan që në 12 muajt e fundit ka pasur periudha kur ata nuk kishin qasje në medikamente themelore të Listës Esenciale e Barërave e cila është përgatitur dhe aprovuar nga MSH-së si dokument zyrtar.. Në bazë të këtij dokumenti mund të sigurohen barërat esenciale, ndërsa 47% e popullatës shumicë e pohuan të njëjtën gjë.

Në këtë kontekst duhet cekur që sistemi shëndetësor në Kosovë është akoma në fazë të tranzicionit dhe jo të gjitha sëmundjet mund të trajtohen në Kosovë. Për më tepër, meqë nuk ekziston sigurimi (i detyrueshëm) shëndetësor, njerëzit duhet të paguajnë për disa shërbime,

²¹ Shih Instituti për Shoqëri të Hapur, Projekti për Shëndetin e Romëve, Ballafaqimi me Sëmundjen e Fshehtë. TB në Komunitetet Rome. Nju Jork, Budapest 2007. Për të dhëna komparative mbi shëndetin e.g., UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor Kosovë 2004. Prishtinë 2004; UNDP, Fytyrat e Varfërisë. Bratislavë 2005.

²² Shih Instituti për Shoqëri të Hapur, Programi për Shëndetin Publik, Lista e Fakteve për Shëndetin Publik: Të Lënë Pas Dore: Romët dhe Qasje në Kujdesin Shëndetësor në Evropën Lindore dhe Juglindore (prill 2007)

trajtime apo medikamente.²³ Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka botuar një listë të “medikamenteve themelore“ që në përgjithësi duhet të jenë në dispozicion pa pagesë/falas. Megjithatë, në Kosovë, shumica prej këtyre “medikamenteve themelore“ nuk mund të gjinden më në farmacitë publike, por vetëm në farmacitë private apo tek shitësit farmaceutik të cilët i shesin këto medikamente. Prandaj, shumica prej këtyre “medikamenteve themelore“ nuk mund të blihen nga njerëzit me të ardhura mesatare apo më të ulëta se mesatare siç është rasti i shumicës dërrmuese të romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve. Gjatë vitit 2008 Ministria e Shëndetësisë ka arritur që ta rris buxhetin për barëra dhe deri në fund të vitit 2008, 70 përqind e barërave dhe materialit shpenzues esencial të jenë në dispozicion në institucionet publike.

Meqë komunitetet, romë, ashkali dhe egjiptas në Kosovë janë ndër komunitetet më të varfëra në krahasim me komunitetet tjera minoritare dhe me popullatën shumicë, pagesa me para të xhepit për “medikamente themelore“ kanë ndikim joproportional dhe shumë më të rëndë në këtë segment të shoqërisë.

Sigurimi i kushteve themelore të jetesës është parakusht për gjendjen e mirë shëndetësore të individëve dhe të komunitetit, dhe kjo shpeshherë i tejkalon kompetencat e sektorit të shëndetësisë. Prandaj, bashkëpunimi ndërsektorial është komponent kyç për reduktimin e faktorëve të rrezikut që kontribuojnë në gjendjen e dobët shëndetësore.

Një problem specifik është statusi shëndetësor i komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas që kanë jetuar në kampe të kontaminuar me plumb.

Gjendja shëndetësore e tri komuniteteve duhet të adresohet me një qasje përmbajtëse, duke i adresuar në të njëjtën kohë çështjet shëndetësore (qasjen në kujdes shëndetësor, kuptimin më të mirë të kujdesit preventiv shëndetësor, jetesën e shëndoshë, etj.), çështjet e strehimit dhe ato mjedisore (kushtet e jetesës, qasja në ujë të pastër të pijës, sistemi i kanalizimit, largimi i mbeturinave, etj), punësimin dhe arsimin.

Gjatë një punëtorie me përfaqësuesit e komuniteteve para hartimit të strategjisë u identifikuan problemet vijuese: numri i vogël i stafit mjekësor nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas, informata të pamjaftueshme për kujdesin preventiv shëndetësor dhe edukimin shëndetësor, fushata të pakta për vaksinimin e fëmijëve. Ministria e Shëndetësisë e mbështetur nga UNICEF dhe IKSHP ka zhvilluar fushata shtesë për grupet e marginalizuara e në veçanti për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas (Shih raportet që vijnë nga UNICEF-i për vizitat e pamjaftueshme mjekësore në vendbanimet e komuniteteve romë, ashkali, egjiptas, pjesëmarrja e ulët në institucionet shëndetësore, dhe brenga e përgjithshme rreth shërbimit joadekuat mjekësor dhe mungesa e vetëdijës së vet këtyre komuniteteve (edukimi shëndetësor edhe mëtutje paraqet problem, dhe qasje e vështirë në shërbimet e shëndetësore për pjesëtarët e këtyre tri komuniteteve).

Mungesa e analizave dhe të dhënave mbi gjendjen e tri komuniteteve në sistemin shëndetësor edhe më tutje është një ndër problemet që pengon për tu identifikuar në mënyrë të saktë problemet dhe të ofrohen zgjidhjet. Mosfunksionimi i SISH- vazhdon të jete problem madhor për të dhënat në MSh!

Korniza Ligjore dhe Politike

²³ Shih Schëizerische Flüchtlingshilfe (SFH), Kosovo - Zur Lage der medizinischen Versorgung – Update. Bern, Juni 2007. Internet: www.ecoi.net; United Nations Kosovo Team, Erste Beobachtungen zu Defiziten im Gesundheitsversorgungssystem im Kosovo. 2007. Internet: www.ecoi.net

Përbrenda kornizës së burimeve që janë në dispozicion, sistemi shëndetësor në Kosovë është akoma në fazën e transformimit nga sistemi paraprak shëndetësor në një sistem bashkëkohor që duhet t'u përshtatet kërkesave të sistemit modern, fleksibël dhe të orientuar kah pacienti.

Në përgjithësi, legjislacioni dhe politikat që kanë të bëjnë me shëndetësinë i referohen dokumenteve dhe obligimeve më relevante ndërkombëtare. Në vitet e fundit, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar disa ligje për shëndetësinë për ta zhvilluar dhe modernizuar sistemin shëndetësor në Kosovë.

Ky kapitull ka marrë parasysh kornizën ekzistuese të ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë. Megjithatë, kjo do të sjell përpara masat për përmirësimin e gjendjes së romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në sistemin shëndetësor bazuar në praktikat më të mira nga vendet e tjera.

Ligjet dhe Strategjitë Kombëtare për Shëndetin

Ligjet vijuese e rregullojnë sistemin shëndetësor në Kosovë ose janë relevant për çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin: Ligji për Shëndetin në Kosovë (2004/4); Ligji mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Shëndetësi (2004/38); Ligji mbi Praktikën Private në Shëndetësi (2004/50); Ligji mbi Shëndetin Publik (2007/02-L78); Ligji për Sëmundjet Ngjitëse; Ligji mbi Shërbimet Emergjente Mjekësore (2006/02-L50); Ligji për Inspektoratin Shëndetësor (2006/02-L38); Ligji mbi Produktet Mjekësore dhe Mjetet Mjekësore (2003/26); Ligji mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Mjedisin për Punë (2003/19); Ligji mbi Shëndetin Riprodhues (2006/02-L76); Ligji për Inspektoratin Sanitar të Kosovës (2003/22); Ligji mbi Planifikimin Hapësinor (2003/14); Ligji për Ujin (2004/24).

Dokumentet dhe strategjitë vijuese adresojnë politikat shëndetësore në Kosovë: Strategjia e Shëndetit e Kosovës 2005-2015; Synimet strategjike dhe zhvillimet në Ministrinë e Shëndetësisë bazuar në deklaratën e prioritetëve zhvillimore të Qeverisë dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve 2009 - 2011. Strategjia për Shëndetin Riprodhues; 2005-2015 Strategjia Kosovare për Mbrojtjen e Ambientin; Draft Strategjia për Sistemin Informativ Shëndetësor; Draft Strategjia për Planifikimin e Burimeve Njerëzore; Draft Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit.

Masat

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me institucionet tjera relevante është përgjegjëse për zbatimin apo bashkërendimin e masave të përmendura më poshtë.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve dhe organizatave të tri komuniteteve në hartimin dhe zbatimin e masave është i domosdoshëm, në veçanti në fushatat e kontaktit dhe informimit.

Masat e Përgjithshme²⁴

Njësia për të drejtat e njeriut në MSH në bashkëpunim edhe me Insitucionin e Ombudspersonit, dhe mekanizma të tjerë monitorues në sistemin e shëndetësisë, do të ndjekin raportet e abuzimit apo diskriminimit në mjediset e sistemit të shëndetësisë.

Përmes Njësies për të drejtat e njeriut në MSH do të bëhet përfshirja e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve dhe politikave shëndetësore që ndikojnë në jetën e tyre.

²⁴ Shih Institutin për Shoqëri të Hapur, Programi për Shëndetin Publik, Lista e Fakteve për Shëndetin Publik: Të Lënë Pas Dore: Romët dhe Qasja në Kujdesin Shëndetësor në Evropën Lindore dhe Juglindore (prill 2007)

Njesia për të drejtat e njeriut në MSH në bashkëpunim me faktorët relevantë institucionalë, do të sigurojë që shërbimet, politikat dhe legjislacioni shëndetësor dhe social vazhdimisht të adresojnë faktorët social që ndikojnë në shëndetin e këtyre tri komuniteteve dhe. intervenimet tjera që synojnë përmirësimin e strehimit për shembull janë kritike për zvogëlimin e rasteve të infektimit me TB.

Masat për Sigurimin e Kushteve Themelore të Shëndetit

Ministria e Shëndetësisë dhe QKMF në bashkëpunim me zyrtarin për të drejtat e njeriut, zyrtarit për KPSH i cili do të ndërmarrë masa për bashkëpunimin më të gjitha QKMF lidhur me sigurimin e masave dhe kushteve themelore për mbrojtjen shëndetsore të këtyre komuniteteve dhe do t'i trajnojnë përfaqësuesit e komunitetit në nivelin e fshatrave apo vendbanimeve për sigurimin e kushteve themelore të shëndetit.

MSH (Divizioni i Shëndetit publik) së bashku me autoritetet relevante shëndetsore do të avokojnë/sigurojnë brenda kompetencave të veta që vendbanimet e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas të kanë qasje në ujin kualitativ të pijshëm, në rrjetin e kanalizimit dhe që janë të përfshirë në organizimin e largimit të mbeturinave.

Ministria e Shëndetësisë dhe IKSHP do të zhvillojnë aktivitete të rregullta të kontrollimit të ujit, si dhe aktivitete sanitare dhe epidemiologjike.

MSH në kuadër të përgjegjësisë të saj do të sigurojë, kudo që është e nevojshme, që toka e vendbanimeve të komuniteteve nuk është e ndotur apo e rrezikshme.

MSH në kuadër të përgjegjësisë të saj do të sigurojë, në konsultim me komunitetet e përfshira, të ofrojnë strehim alternativ për personat që jetojnë në zona të rrezikuara.

Në veçanti, në fshatrat (vendbanimet) që nuk janë të lidhura me sistemin e përgjithshëm të ujësjellësit, përfaqësuesit e komuniteteve do të mundësohet kontrolli i rregullt i kualitetit të ujit dhe do të bëhet pastrimi i ujit.

Përfaqësuesit e komunitetit do të informojnë dhe këshillojnë rregullisht pjesëtarët e komuniteteve të tyre për kualitetin dhe sigurinë e ushqimit (kushtet e ruajtjes, përgatitja dhe procesimi i ushqimit, kontrollimi i shpërndarjes së produkteve ushqimore).

MSH do të zhvillojë fushata të imunizimit dhe do të krijoj një bazë të dhënash të imunizimit. Regjistri (banka) e të dhënave që ekziston është e përbashkët për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve.

Institucionet shëndetsore relevante do të lehtësojnë regjistrimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve, në veçanti të fëmijëve, për t'i përfshirë ata në masat e kujdesit preventiv shëndetësor siç janë fushatat e imunizimit dhe të ofrojnë qasje në sistemin e shëndetësisë

Fuqizimi i bashkëpunimit në mes autoriteteve relevante në sektorin e shëndetësisë, arsimit, planifikimit mjedisor dhe hapësinor për të zhvilluar dhe zbatuar një qasje përmbytjesore

Institucionet relevante shëndetsore do të zhvillojnë një qasje përmbytjesore me theks të veçantë të femrat dhe fëmijët në kuadër të këtyre komuniteteve

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me agjensionet e specializuara ndërkombëtare do të kontrollojnë rregullisht statusin shëndetësor të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas që kanë jetuar në kampe të helmuara me plumb dhe do të lehtësojnë qasjen në trajtime të vazhdueshme dhe adekuate mjekësore.

Analiza dhe Mbledhja e të Dhënave

Zhvillimi i studimit mbi qasjen e komuniteteve në shërbimet e kujdesit preventiv dhe shërues mjekësor për t'i identifikuar pengesat e mundshme

Të përkrahët mbledhja e të dhënave të ndara etnike dhe bazuar në këto të dhëna të alokohen fonde për popullsinë që ka më së shumti nevojë për shërbimet themelore mjekësore. Komunitetet duhet të përfshihen në procesin e mbledhjes së dhënave dhe analizave.

Ministria e Shëndetësisë do të ndërmerr masa shtesë për t'a përforcuar, krijuar databazën për të gjithë popullatën që përfshihen në imunizim e në veçanti përfaqësuesit e këtyre tri komuniteteve.

Fushatat e Kontaktit dhe Informimit

Masat vijuese janë kryesisht në përgjegjësinë e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP)

Edukimi shëndetësor për ujin dhe rëndësinë e ujit – ruajtja, pastrimi dhe përdorimi i ujit

Të zhvillohen Fushatat e Informimit dhe Edukimit (FIK) për zbatimin e masave synuese apo mobilizimi social për çështjet shëndetësore me anë të përdorimit të masave adekuate dhe inovative

Të organizohen Fushata të Informimit dhe Edukimit (FIK) për çështje që janë në interes të komuniteteve roma, ashkali, egjiptas

Të zhvillohen aktivitete për promovimin dhe edukimin shëndetësor në mesin e komuniteteve roma, ashkali, egjiptas duke përkrahur publikimin e materialeve IEK (informimi, edukimi dhe komunikimi)

Të transmetohen programe edukative në gjuhën e komuniteteve në lidhje me karakteristikat kulturore, fetare dhe tradicionale të komuniteteve,

Të zhvillohen fushata vetëdijësi për pasojat e mjekimit tradicional dhe për paragjykimet rreth mjekimit të sëmundjeve

Të zhvillohen fushata vetëdijësi për nevojën e trajtimit me kohë mjekësor

Të transmetohen programe edukative në gjuhën e komuniteteve në lidhje me karakteristikat kulturore, fetare dhe tradicionale të komuniteteve

Të përkrahët publikimi i materialeve IEK në gjuhën e komuniteteve roma, ashkali, egjiptas

Informata për rrezikun shëndetësor nga punët siç është mbledhja dhe riciklimi i mbeturinave sekondare

Vetëdijësi i organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve potencial për nevojën e adresimit të statusit shëndetësor të komuniteteve në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat shëndetësore apo me përfaqësuesit e komuniteteve.

Qasja në Kujdes Kualitativ Shëndetësor, në veçanti për femrat dhe fëmijët

Ministria e Shëndetësisë do të ndërmerr masa shtesë për t'a përmirësuar disponueshmërinë e institucioneve dhe informatave për kujdesin preventiv shëndetësor pa e cenuar Master Planin ose duke e reviduar atë në pajtim me komunat dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë do të ofroj stimulime financiare për punëtorët e shëndetësisë që të punojnë në qendra të largëta të kujdesit shëndetësor apo në institucione mobile të kujdesit shëndetësor dhe t'i vizitojnë komunitetet e marginalizuara e në veçanti komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas.

Do të përmirësohen pajisjet dhe të ofrohen medikamentet themelore për “stacionet lokale të shëndetësisë/ambulancat“ dhe/ose farmacitë në apo afër vendbanimeve rome, ashkali, egjiptas

Do të rritet numri i vizitave mjekësore në lagjet e vendbanimeve, ku jetojnë komunitetet , rome, ashkali dhe egjiptas

Duhet të mbahen trajnime specifike për stafin shëndetësor, ndihmësit dhe komunitetet për eliminimin e diskriminimit në sferën e shëndetësisë për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas

Të zbatohet dhe mbikëqyret Kodi Etik dhe Profesional në mesin e ofruesve të shërbimit shëndetësor për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptas në bashkëpunim me Asociacionet e profesionistëve shëndetësorë.

Të përmirësohet kujdesi antenatal dhe postnatal dhe të rritet numri i vizitave të mamive, motrave medicinale dhe mjekëve

Të ofrohen shërbime kualitative për shëndetin riprodhues, këshillim për planifikimin familjar dhe për parandalimin e sëmundjeve që transmetohen nëpërmjet seksit.

Të sigurohet qasja në shërbimet më të rëndësishme preventive (p.sh. ekzaminimet për kancerin gjinekologjik) për femrat rome, ashkallike dhe egjiptase.

Të rritet numri i shërbimeve shëndetësore në afërsi të lagjeve të tri komunitet

Edukimi shëndetësor për ujin dhe rëndësinë e ujit – ruajtja, pastrimi dhe përdorimi i ujit

Të zhvillohen Fushatat e Informimit dhe Edukimit (FIK) për zbatimin e masave synuese apo mobilizimi social për çështjet shëndetësore me anë të përdorimit të masave adekuate dhe inovative

Të organizohen Fushata të Informimit dhe Edukimit (FIK) për çështje që janë në interes të komuniteteve roma, ashkali, egjiptas

Çështjet Sociale

Të rishqyrtohet përcaktimi i kategorive që kanë të drejtë marrin asistencë sociale dhe të merret parasysh pozita e pafavorshme e pjesëtarëve të komuniteteve

Të vlerësohet alokimi i asistencës sociale (monitorimi dhe vlerësimi i skemave sociale)

Të ofrohen shërbime kualitative në parandalimin e dhunës seksuale dhe familjare dhe në rehabilitimin adekuat

Të ofrohet qasje për femrat dhe fëmijët e komuniteteve në “shtëpi të sigurta“ dhe strehimore

2.5 Strehimi dhe Vendbanimet Joformale

Përshkrimi i Gjendjes

Romët, ashkallijtë dhe egjiptasit e Kosovës shpesh jetojnë të shkëputur nga komunitetet e tjera etnike në lagje që nuk kanë infrastrukturë adekuatë siç janë rrugët, rryma elektrike, kanalizimi, uji i pastër, largimi i mbeturinave dhe qasja në transport publik. Shpesh herë, banorët e këtyre lagjeve nuk kanë certifikata pronësie të regjistruara (pronësi apo të drejta për shfrytëzim) për pronën e tyre, qoftë për shkak të mungesës së dokumenteve, transaksione të paregjistruara

dhe/apo zënies së tokës. Zakonisht, ndërtimet janë bërë pa leje urbane apo leje të ndërtimit. Qasja në shërbimet e infrastrukturës, siç janë rrugët, rryma elektrike dhe kanalizimi, është joadekuate. Skemat për strehim social dhe financim të strehimit nuk i mbulojnë nevojat aktuale.

Vendbanimet strehimore konsiderohen të jenë 'joformale' kur kjo nuk përputhet me ligjet dhe kornizat rregullative të zonave në të cilat zhvillohen. Prandaj, këto zona konsiderohen të jenë 'vendbanime joformale'.²⁵ Këto vendbanime joformale të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të Kosovës nuk janë të pasqyruara gjithmonë në planet hapësinore dhe zhvillimore komunale. Qasja në asistencë për strehim, qoftë për njësitë e strehimit social dhe/apo skemat e financimit të strehimit, është tejet e kufizuar. Çështjet si riatdhësimet e detyrueshme, mungesa e asistencës për rindërtimin e strehimit për personat e kthyer dhe/apo për integrim lokal, i përkeqësojnë këto probleme.

Me këtë strategji, Qeveria e Republikës së Kosovës synon të ndërmarr hapa afirmativ për a) t'iu ofruar këtyre personave siguri ligjore të qëndrimit, b) për t'i integruar vendbanimet e tyre në planet komunale hapësinore dhe zhvillimore dhe c) për ta përmirësuar qasjen e tyre në asistencë për strehim dhe në shërbimet e tjera publike.

Në këtë drejtim, Qeveria do t'i ndjek qëllimet e cekura në Planin për Zbatimin e Standardeve për Kosovën (Qëllimet 6.8 dhe 6.9) dhe Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian për vendbanimet joformale (Prioriteti 31).²⁶ Këto qëllime janë në përputhje me përkushtimet e *Deklaratës së Vjenës për Vendbanimet Joformale në Evropën Juglindore* të Paktit të Stabilitetit të cilin Kosova e ka nënshkruar në vitin 2004.

Këshilli i Bashkimit Evropian ka ripërsëritur në Vendimin e Këshillit më 18 shkurt 2008 (2008/213/EC) rëndësinë e rregullimit të vendbanimeve joformale dhe gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për strehimin dhe integrimin e komuniteteve romë që jetojnë në kushte të rrezikshme në kampe dhe për shumë grupe të personave të zhvendosur që jetojnë në qendra joformale.²⁷

Për të siguruar mbrojtjen e strehimit, të tokës dhe të drejtave pronësore të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të zhvendosur të Kosovës (shih Kapitullin për Kthimin dhe Riintegrimin), duhet të bëhet shënimi i vendbanimeve joformale të periudhës para konfliktit dhe vlerësimi i masave për të siguruar që shkatërrimi gjatë periudhës së konfliktit nuk do të çojë në segregim të mëtejshëm dhe shkelje të drejtave për strehim.

Strehimi

Të dhënat për strehimin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në Kosovë janë të kufizuara, dhe Qeveria do të sigurojë mbledhjen dhe mirëmbajtjen më të rregullt të dhënave më adekuate me synim të zhvillimit të programeve për strehim.²⁸ Në përgjithësi, familjet romë, ashkalike dhe egjiptase për momentin kanë qasje shumë të kufizuar në asistencën për strehim. Familjet jetojnë

²⁵Vendbanimet joformale janë vendbanimet njerëzore të cilat për një numër arsyesh nuk i përmbushin kriteret për njohje ligjore. Shih edhe "Deklarata e Vjenës për Vendbanimet Joformale në Evropën Juglindore" e Paktit të Stabilitetit 2004. Internet: www.stabilitypact.org/housing/f%20-%20050415_Vienna%20Declaration.pdf

²⁶Pas Vendimit të Këshillit Evropian 2006/56/EC të datës 30 janar 2006 mbi principet, prioritetet dhe kushtet e Partneritetit Evropian me Serbinë dhe Malin e Zi përfshirë këtu edhe Kosovën, dhe për t'i adresuar këto çështje, është miratuar Plani Aksional i Kosovës për Zbatimin e Partneritetit Evropian 2006 (Kosovo EPAP, 2006).

²⁷Shih Vendimin e Këshillit të datës 18 February 2008 mbi principet, prioritetet dhe kushtet e Partneritetit Evropian me Serbinë dhe Malin e Zi përfshirë këtu edhe Kosovën siç definohet nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999 dhe Vendimin 2006/56/EC (2008/213/EC)

²⁸Studimi i UNDP-së "Fytyrat e Varfërisë" (Bratislavë, 2005) tregon dallimet vijuese sa i përket kushteve të strehimit për romët, ashkalijtë dhe egjiptasit e Kosovës: dhomat për pjesëtarë të ekonomive familjare: Roma: 0.49/Non-Roma: 0.72; metra katrorë për pjesëtarë të ekonomisë familjare: Roma 14/ Non-Roma:21; përqindja e popullsisë që nuk ka qasje në banjo apo toalet brenda shtëpisë: Roma: 72%/Non-Roma: 45%

në kushte joadekuade të strehimit në strehimore kolektive (siç janë ato në Leposaviq apo Mitrovicë) dhe në kampe. Për shkak të prospekteve të ardhshme për riatdhesim të detyrueshëm, qeveria duhet të planifikojë ofrimin e njëjësive shtesë për strehim.

Personat që jetojnë në kampe, baraka dhe lloje të tjera të strehimoreve kolektive ballafaqohen me gjendjen më të keqe të strehimit. Për shkak të obligimit për mbylljen e këtyre strehimoreve kolektive, Qeveria e Republikës së Kosovës në raste të caktuara ka filluar vendosjen e banorëve në njësi sociale të strehimit.²⁹ Në komunat veriore, autoritetet lokale ende nuk kanë ofruar zgjidhje adekuade për familjet e romëve, ashkaliëve dhe egjiptasve të Kosovës që jetojnë në strehimore. Për më tepër, ato janë ballafaquar me presionin që të largohen në vende tjera pa iu ofruar alternativa të arsyeshme, gjë që mund të çojë në dëbime të jashtëligjshme dhe shkeljen e të drejtave të tjera njerëzore.³⁰ Asistenca për programet për integrim lokal paralel me procesin e kthimit, duhet të zhvillohet dhe zbatohet urgjentisht.

Strehimi në raport me riatdhesimin e detyrueshëm

Në të ardhmen e afërt, Kosova mund të ballafaqohet me kthimin e shtuar të romëve, ashkaliëve dhe egjiptasve nga Evropa Perëndimore, nga vendet fqinje dhe me gjasë edhe nga Serbia. Përderisa kthimi i organizuar i personave të zhvendosur nga Serbia shpeshherë lehtësohet dhe përkrahet nga programet për rindërtim, personat e kthyer nga Evropa Perëndimore në përgjithësi nuk mund të përfitojnë nga këto programe.³¹ Vetëm në Gjermani janë 35,000 romë, ashkali dhe egjiptas nën statusin e tolerancës (Duldung). Në vendet e tjera evropiane, disa mijëra romë, ashkali dhe egjiptas kanë gjetur strehim të përkohshëm. Mund të supozohet që shumica prej tyre do të kthehen në Kosovë. Pritet që Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina së shpejti do të fillojnë të kthejnë rreth 10,000 refugjatë romë, ashkali dhe egjiptas në Kosovë.³²

Aktivitetet më të reja për Adresimin e Çështjes së Vendbanimeve Joformale dhe Qasjen në Strehim

Gjatë viteve 2006 dhe 2007, Ministria, në bashkëpunim me UN HABITAT dhe me misionin e OSBE-së në Kosovë ka nisur një numër të pilot iniciativave në nivelin komunal për të adresuar rregullimin e vendbanimeve joformale në Kosovë. Këto iniciativa kanë përfshirë organizimin e një konference për vendbanimet joformale, një fushatë për vetëdijësim publik, krijimin e Grupit të Përbashkët Punues për Vendbanimet Joformale (në përputhje me kërkesat e Standardeve për Kosovën për 'Grupin e Interesit për Vendbanimet Joformale') me pjesëmarrjen e UN-HABITAT, OSBE-së dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës.

Deri më tani janë ndërmarrë aksione për rregullimin e vendbanimeve joformale në mënyrë ad hoc në komuna të ndryshme të Kosovës. Shembuj të njohjes *de facto* të zotërimit të tokës mund të gjenden në Dy Korriku³³ (Mitrovicë) dhe Prelluzhë³⁴ (Vushtrri).

²⁹ Në Plemetinë, ndërtesa e parë për strehim social për personat e zhvendosur është inauguruar në qershor të vitit 2006, duke ofruar strehim për 36 familje, ndërsa ndërtesa e dytë (me 23 apartamente) është finalizuar në fund të qershorit 2007. Në këtë projekt nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të siguruar furnizimin me ujë dhe rrymë elektrike për të gjitha apartamentet dhe një sistem adekuat të ngrohjes dhe qasjen në shërbime.

³⁰ Kuvendi Komunal i Leposaviqit vazhdimisht është përpjekur ta mbyll strehimoren kolektive në Leposaviq, përkundër mungesës së akomodimit alternativ.

³¹ Megjithatë, vlerësohet se në mes 35% dhe 50% të romëve, ashkaliëve dhe egjiptasve me origjinë nga Kosova dhe që tash jetojnë në Serbi nuk janë të regjistruar si persona të zhvendosur. Kjo mund të thotë që deri 20,000 nuk janë të regjistruar dhe nuk do të mund të përfitojnë nga programet e rindërtimit. Për më tepër hollësi rreth kësaj çështjeje, shih Kapitullin për Kthimin dhe Riintegrimin.

³² Drafti i Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar parasheh kthimin e 5,000 personave në vit gjatë pesë viteve të ardhshme. Strehimi social aktualisht në Kosovë është shumë i kufizuar përkundër zbatimit të programit për strehim social në nëntë komuna për të cilin janë alokuar 6,340,000 Euro.

³³ Kuvendi Komunal i Mitrovicës, Propozim Deklaratë Pr. No 399/01. 28 shkurt 2003.

³⁴ Kuvendi Komunal i Mitrovicës, Vushtrri, 01.Nr.700/03, më 3.10.2003.

Në ish-Mahallën e Romëve në Mitrovicë është zbatuar një program i kthimit, që përfshinte rindërtimin e shtëpive – në raste kur pronarët mund të dëshmonin titujt e tyre të pronës me regjistrimin në librat e kadastrës – dhe ndërtimin e banesave në ish-pronë shoqërore të alokuar nga Komuna për persona që nuk mund të dëshmojnë pronësinë e ish-shtëpive të tyre.

Këto raste, megjithatë, janë aksione të jashtëzakonshme të ndërmarra kryesisht për të lehtësuar programet e kthimit dhe rindërtimit të strehimeve. Akoma duhet të zhvillohet një politikë konsistente për autoritetet komunale dhe qendrore për strehim dhe vendbanime joformale.

Në vitin 2006, këta akterë kanë zhvilluar një set të objektivave ligjore dhe politike bazuar në 'Standardet për Kosovën' dhe 'Planin Aksional të Partneritetit Evropian' nën iniciativën për 'Jetë më të mirë në komunën tonë' (shih dokumentin final të konferencës, 16 nëntor 2006). Këto objektiva aktualisht janë në progres e sipër. Për më tepër, Raporti i Konferencës 'Ti je i zhvendosur, të drejtat tuaja nuk janë' (MMPH, OSBE-ja dhe Lëvizja për Paqe, 26-27 nëntor 2007) ka ofruar rekomandime të politikave në fushën e rregullimit të vendbanimeve joformale.

Korniza ligjore dhe institucionale

Standardet ndërkombëtare janë aplikuar në mënyrë të drejtpërdrejt në Kosovë fillimisht nëpërmjet Rregulloreve të UNMIK-ut derisa Kosova u shpall shtet i pavarur dhe më pas më anën e Kushtetutës së saj. Legjislacioni kosovar ka integruar të drejta si të drejtën për gëzimin paqësor të posedimeve (Neni 1, Protokoli 1, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut), të drejtën për respektimin e familjes dhe jetës private (Neni 8, KEDN) dhe të drejtën për strehim adekuat (Neni 11.1, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore).³⁵

Këto standarde krijojnë obligime pozitive për të gjitha autoritetet publike për të drejtat për strehim, tokë dhe pronë të personave që jetojnë në kushte joadekuate dhe/apo me siguri ligjore të qëndrimit.³⁶ Autoritetet publike në këtë drejtim janë të obliguara të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për ofrimin e sigurisë të qëndrimit për persona që jetojnë në vendbanime joformale, në konsultim me komunitetet e ndikuara.³⁷

Për më tepër, standardet ndërkombëtare krijojnë obligime për autoritetet publike që të përmbahen nga praktikat që mund të çojnë në shkelje të drejtave të njeriut, siç janë dëbimet e 'detyrueshme' dhe 'të paligjshme'.³⁸

Kompetencat e komunave në fushën e strehimit, përdorimit të tokës dhe lejes për ndërtim janë të definuara me, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (2008/03-L040). Ligji për Planifikim Hapësinor rregullon procedurat me anë të cilave autoritetet qendrore dhe komunale hartojnë dhe zbatojnë plane hapësinore dhe urbanistike.³⁹ Kushtet dhe procedurat për dhënien e lejeve të

³⁵ Këto standarde ndërkombëtare janë të aplikueshme në Kosovë nëpërmjet Seksionit 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë

³⁶ Shih në mes tjerash Komentin e Përgjithshëm Nr. 4 për ICESCR që thotë se e drejta për strehim adekuat garanton që të gjithë personat duhet të kenë të garantuar një shkallë të sigurisë së zotërimit që ofron mbrojtje nga dëbimi i detyrueshëm, ngacmimet dhe kërcënimet e tjera. Kjo mbrojtje i përfshin edhe individët që banojnë në vendbanime joformale; Dokumenti Përfundimtar i Konferencës së OSBE-së, Tryeza Rajonale e vitit 2003 mbi Vendbanimet Joformale në Kosovë. (shih). Në këtë drejtim,

³⁷ Shih Komentin e Përgjithshëm Nr. 4 për ICESCR mbi të drejtën për strehim adekuat. Paragrafi 8 (a). Siguria ligjore e zotërimit.

³⁸ Dëbimet e detyrueshme janë largimet e përhershme apo të përkohshme të detyrueshme të individëve, familjeve dhe/apo familjeve nga shtëpitë dhe/apo pronat ku banojnë ata, pa ofrimin e, dhe qasjen në, format adekuate të mbrojtjes ligjore apo mbrojtjes së natyrës tjetër. Moslejmi i dëbimeve të detyrueshme megjithatë nuk vlen për dëbimet që kryhen në pajtim me ligjin dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut. (Komenti i Përgjithshëm 4, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore).

³⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/30 për Miratimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës për Planifikim Hapësinor.

ndërtimit janë të definuara me Ligjin për Ndërtim.⁴⁰ Regjistrimi i titullit mbi pronën e patundshme është e rregulluar me Ligjin për Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Patundshme.⁴¹

Sa i përket përkushtimeve politike, Planin Zbatues i Standardeve për Kosovën dhe Plani I Veprimit i Partneritetit Evropian përcaktojnë udhëzime të qarta politike për rregullimin e vendbanimeve joformale. Pas procesit të nisur me ‘Tryezën Rajonale të Punës së OSBE-së për Formalizimin e Vendbanimeve Joformale të Romëve dhe grupeve të tjera vulnerable’, autoritetet kosovare në vitin 2004 nënshkruan ‘Deklaratën e Vjenës për Vendbanimet Joformale’ të Paktit të Stabilitetit.⁴²

Deklarata përmban një program të veprimit i cili rishikohet rregullisht në takimet rajonale për zhvillimin e kapaciteteve.

Që nga viti 2004, Qeveria ka ndërmarrë hapa për përmbyshjen e qëllimeve dhe veprimeve për rregullimin e vendbanimeve joformale të cekura në ‘Planin Zbatues të Standardeve për Kosovën’ (Kapitulli VI, Të Drejtat Pronësore). Në këtë drejtim, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka hartuar udhëzime për planifikim hapësinor dhe vendbanime joformale për komunat, ka ofruar trajnime për Drejtoritë Komunale për Urbanizëm dhe ka shqyrtuar plane për zhvillimin e studimit përmbajtësor për vendbanimet joformale të të gjitha komuniteteve.

Njëllonj i rëndësishëm është ‘Plani i Veprimit i Partneritetit Evropian’ (PVPE). Qëllimi 31 i EPAP, në mes tjerash, në mënyrë eksplicite i referohet rregullimit të vendbanimeve joformale, gjetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme për integrimin e komuniteteve romë që jetojnë në kushte të rrezikshme në kampe dhe për grupet e personave të zhvendosur që jetojnë në qendra joformale.

Masat

Të Përgjithshme

Autoritetet relevante do të rregullojnë vendbanimet joformale të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të Kosovës.

Procesi i rregullimit do të zhvillohet në konsultim me komunitetet.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë përputhjen me dhe përmbyshjen e vazhdueshme të kërkesave të dokumenteve relevante kombëtare dhe ndërkombëtare për zgjidhjen e problemit të vendbanimeve joformale dhe shmangien nga krijimi i vendbanimeve të reja joformale.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim do të kryejë një studim për gjendjen aktuale të strehimit dhe të vendbanimeve joformale të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve, përfshirë informatat për gjendjen para konfliktit, për të krijuar një bankë të dhënash të besueshme që do të përdoret për qëllime të asistencës (Shih Shtojcën A për Vendbanimet Joformal edhe Qasje në Strehim për informata më të hollësishme).

Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë funksionimin e vazhdueshëm të ‘Grupit të Palëve të Interesit për Vendbanimet Joformale’, që ka për detyrë hartimin dhe zbatimin e strategjisë dhe planeve të veprimit gjithëpërfshirëse afatmesme dhe afatgjatë (përfshirë legjislacionin zbatues) për rregullimin e vendbanimeve joformale dhe parandalimin e krijimit të vendbanimeve të reja joformale.

⁴⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 2004/37 për Miratimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës mbi Ndërtimet.

⁴¹ Rregullorja e UNMIK-ut 2002/22 mbi Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Patundshme.

⁴² Shih http://www.stabilitypact.org/housing/P%20-%20050415_Vienna%20Declaration.pdf

Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë nëpërmjet Grupit të Palëve të Interesit, mbikëqyrjen adekuate të respektimit nga ana e komunave të kërkesave të dokumenteve relevante për vendbanimet joformale.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të krijojë një Nëngrup për vendbanimet joformale dhe qasjen në strehim për romët, ashkalijtë dhe egjiptasit. Grupi do të kryesohet nga Zyra e Qeverisjes së Mirë në Zyrën e Kryeministrit dhe do të mbikëqyr zbatimin e komponentit për strehim dhe vendbanime joformale të kësaj strategjie dhe të vlerësojë progresin dhe të propozojë çdo gjashtë muaj masa konkrete për autoritetet qendrore dhe lokale.

Rregullimi i vendbanimeve joformale do të përfshijë përmirësimin e kushteve të këtyre vendbanimeve nëpërmjet masave afirmative siç është alokimi i shfrytëzimit të tokës, ndërrimi i tokave, njohjet de fakto, inkorporimi në planet hapësinore dhe urbanistike dhe ofrimi i infrastrukturës.

Personat e Zhvendosur dhe refugjatët që kanë jetuar në vendbanime joformale që tash janë shkatërruar, do të kenë të drejtë t'i gëzojnë masat e njejta afirmative për t'i mbrojtur të drejtat e tyre. Në këtë drejtim, shkatërrimi i vendbanimeve joformale gjatë periudhës së konfliktit assesi nuk duhet të çojë në izolimin e mëtutjeshëm të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të Kosovës (shih Kapitullin për Kthimin dhe Re-integrimin).⁴³

Vendbanimet Joformale

Institucionet relevante të Qeverisë së Republikës së Kosovës do të sigurojnë që vendbanimet joformale do të përfshihen në Planet Zhvillimore të Komunave, në Planet Zhvillimore Urbanistike dhe në Planet Hapësinore.

Komunat do të përmbahen nga përdorimi i kësaj toke për qëllime të tjera. Shkatërrimi i vendbanimeve joformale gjatë periudhës së konfliktit nuk duhet të pengojë kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur romë, ashkali dhe egjiptas në vendet e tyre të origjinës.

Komunat do të sigurojnë rregullimin e pronësisë mbi tokën në rastet kur vendbanimet joformale kanë zaptuar tokën publike, shtetërore apo shoqërore.

Në veçanti kur vendbanimet joformale janë në tokë publike, shtetërore apo shoqërore, kur nuk janë të rrezikshme për shëndetin dhe kur mund të lidhen me infrastrukturën komunale, autoritetet relevante do të japin tokë për banorët për qëllime të banimit. Nëse është e nevojshme, autoritetet relevante do të lehtësojnë riparcelizimin, shfrytëzimin e tokës, ndërrimin e pronave me Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit, integrimin në planet hapësinore dhe urbanistike dhe njohjet de fakto të okupimeve të gjatë të tokës shoqërore.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të rishikojë ligjet relevante për përdorimin e tokës, planifikimin hapësinor, strehimin dhe ndërtimin për të mundësuar rregullimin e vendbanimeve joformale. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar kushteve për posedimin e pafavorshëm, nëndarjen e tokës dhe procedurat e legalizimit për ndërtimet që nuk kanë leje urbanistike dhe/apo leje të ndërtimit.

Në rastin e vendbanimeve joformale në pronë private (individët apo kompanitë) komunat dhe autoritetet relevante do të lehtësojnë regjistrimin e transfereve dhe/apo trashëgimive. Në këtë drejtim, komunat dhe autoritetet e tjera do t'i referojnë individët tek ofruesit e ndihmës ligjore falas sa herë që kjo është e nevojshme.

Personat e Zhvendosur dhe Personat e Kthyer

⁴³ Për ta kuptuar më mirë konceptin e aplikuar të masave afirmative shih Komentin e Përgjithshëm 25 të Komisionit për të Drejtat Civile dhe Politike, për të Drejtat e Pakicave.

Shkatërrimi i vendbanimeve joformale gjatë periudhës së konfliktit në asnjë mënyrë nuk do të çojë në izolimin e mëtutjeshëm të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të Kosovës. Kur vendbanimet janë shkatërruar gjatë konfliktit, autoritetet relevante gjithmonë do të respektojnë të drejtën e banorëve të dikurshëm për t'u kthyer në shtëpi si prioritet.

Rizhvillimi i tokave publike, që kanë pasur për një kohë të gjatë vendbanime joformale të komuniteteve pakicë apo të grupeve tjera vulnerable, do të jetë ekskluzivisht i kufizuar në lejimin e përdorimit rezidencial të banorëve të dikurshëm. Bazuar në kriteret objektive dhe jodiskriminuese (për shembull rreziqeve ndaj shëndetit) kur kthimi nuk është i mundur, kompensimi apo prona dhe strehimi alternativ në çdo rast do t'iu ofrohet personave të zhvendosur dhe refugjatëve.

Qasja në Strehim

Qeveria e Republikës së Kosovës do të ndërmarr masa specifike për përmirësimin e kushteve joadekuate të strehimit dhe për të ofruar qasje në strehim për romët, ashkalijtë dhe egjiptasit e Kosovës që kanë nevojë. Përveç kësaj, Qeveria do të sigurojë që asnjë autoritet ekzekutiv në Kosovë nuk do të rrezikojë të drejtat për strehim duke i përjashtuar në mënyrë të paligjshme individët dhe/apo duke mbyllur strehimoret kolektive pa ofruar akomodim alternativ.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të hartojë programe specifike për strehim që synojnë romët, ashkalijtë dhe egjiptasit e Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë do të ofrojë burime financiare për të përmirësuar kushtet e strehimit për romët, ashkalijtë dhe egjiptasit. Në këtë drejtim, Qeveria do të ofrojë kornizën për zbatimin e mikro kredive apo granteve për ndërtimin e strehimeve për romët, ashkalijtë dhe egjiptasit. Qeveria do të marrë parasysh praktikat më të mira të vendeve tjera.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë që komunat të hartojnë strategji komunale për strehim duke i marr parasysh nevojat e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të Kosovës, përfshirë edhe nevojat që mund të dalin në lidhje me riatdhesimin e detyruar të individëve nga Evropa Perëndimore.

Këto strategji do të integrohen në Strategjitë Komunale për Kthim dhe do t'i marrin parasysh nevojat buxhetore.

Qeveria e Republikës së Kosovës përkushtohet se do të veprojë në përputhje me standardet ndërkombëtare e të drejtave për strehim, siç janë definuar në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Në këtë drejtim, Qeveria do të sigurojë që asnjë autoritet ekzekutiv nuk do t'i dëbojë në mënyrë të paligjshme individët. Me rastin e mbylljes së strehimoreve kolektive, autoritetet qendrore dhe lokale do të sigurojnë ofrimin e akomodimit alternativ si dhe qasjen në ndihmën ligjore.

Shtojca A për Vendbanimet Joformale dhe Qasjen në Strehim

Të dhëna të zgjedhura por jo të përgjithshme, të nevojshme për zgjidhjen e gjendjes së strehimit dhe vendbanimeve joformale:

1. Numri i vendbanimeve joformale
2. Numri dhe/apo përqindja e pjesëtarëve të komuniteteve që jetojnë në vendbanime joformale
3. Kategorizimi i vendbanimeve joformale (përfshirë në veçanti statusin e pronës)

4. Gjendja e vendbanimeve joformale, përfshirë statusi i planifikimit; kushtet mjedisore dhe shëndeti publik; lokacioni i përgjithshëm (qasja/afërsia në transport, infrastrukturë, shkolla, etj.)
5. Numri dhe përqindja e pjesëtarëve të komunitetit që jetojnë në mjedise nën standardet adekuate (përcaktimi i mjediseve nën standardet adekuate)
6. Sasia mesatare e metrave katrorë në dispozicion për person në ekonominë familjare rome, ashkali dhe egjiptase
7. Numri dhe/përqindja e pjesëtarëve të komunitetit shtëpitë e të cilëve janë të lidhura me rrymë elektrike, ujë, kanalizim, mbledhje të mbeturinave dhe rrugë të asfaltuara.
8. Numri dhe përqindja e pronave të shkatërruara
9. Numri dhe/apo përqindja e pronës së okupuar në mënyrë ilegale
10. Numri dhe përqindja e pjesëtarëve të komunitetit që nuk jetojnë në pronën e tyre për shkak të gjendjes së pasigurisë që është vënë re në të kaluarën
11. Lokacioni i vendbanimeve (joformale) rome, ashkali dhe egjiptase për të adresuar apo për t'iu shmangur segregimit racor rezidencial.
12. Kreditë apo mundësitë e tjera në dispozicion për blerjen e shtëpive?
13. Numri dhe përqindja e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve që kanë marrë pjesë në programet e strehimit (rindërtimit)?
14. Shpenzimet për kokë në këto njësi të strehimit dhe në programet e rindërtimit?
15. A ekzistojnë të dhëna korresponduese krahasuese nga grupet e tjera etnike për të gjitha këto pyetje?
16. Të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe moshës do të ishin tejet të dobishme.

2.6. Kthimi dhe Ri-integrimi

Përshkrimi i Gjendjes

Sipas vlerësimeve, më shumë se 100.000 prej 150.000 romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të Kosovës janë ende të zhvendosur jashtë Kosovës. Një numër i madh prej tyre u larguan nga Kosova pas qershorit të vitit 1999 pasi i braktisën shtëpitë e tyre si rezultat i dhunës në mbarë Kosovën. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i romëve, ashkalijve dhe egjiptasve u larguan nga Kosova bashkë me shqiptarët gjatë konfliktit të viteve 1998/1999. Grupet e tjera ishin larguar nga Kosova gjatë regjimit represiv serb në vitet e 90-ta e madje edhe gjatë viteve të 80-ta. Një pjesë e personave që u larguan nga Kosova morën statusin e refugjatëve në shtetet e Evropës Perëndimore dhe në vendet fqinje, një numër i madh mbetet akoma i zhvendosur përbrenda dhe jashtë Kosovës.

Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve që jetojnë në Evropën Perëndimore apo në vendet e rajonit. Në Serbi, vetëm 23.000 romë, ashkali dhe egjiptas janë të regjistruar si persona të zhvendosur, ndërsa besohet se numri i përgjithshëm është prej 40,000 deri në 50,000, shumica prej të cilëve nuk i kanë dokumentet e nevojshme valide për të pasur qasje në shërbimet kyçe dhe të drejtat elementare⁴⁴ (shih edhe Kapitullin për Regjistrimin dhe Dokumentacionin). Numri i refugjatëve në Mal të Zi dhe në ish-Republikën Jugosllave të

⁴⁴Shih UNHCR/Praxis, Analizë e Gjendjes e Personave të Zhvendosur nga Kosova në Serbi, Beograd mars 2007, p.11.

Maqedonisë, apo i Personave me Status të Përkohshëm në Bosnje dhe Hercegovinë, arrin në rreth 10,000⁴⁵.

Bazuar në të dhënat që janë në dispozicion, vlerësohet se në shtetet e Evropës Perëndimore jetojnë më tepër se 40,000 romë, ashkali dhe egjiptas nën "statusin e tolerancës" (në gjuhën gjermane: Duldung).⁴⁶ Derisa Gjermania dhe vendet e tjera në përgjithësi nuk kanë pranuar t'iu japin azil refugjatëve romë, ashkali dhe egjiptas nga Kosova, vendet e tjera si Franca, Mbretëria e Madhe, Austria dhe Hungaria i kanë njohur disa prej tyre si refugjatë. Përveç atyre që nuk arritën të marrin statusin e refugjatëve, edhe një numër i panjohur i romëve, ashkalijve dhe egjiptasve jetojnë si emigrantë ilegal⁴⁷ në vendet e Evropës Perëndimore.

Kthimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve ka ndodhur në dy mënyra të ndryshme që ka përfshirë procedura dhe aktorë të ndryshëm. Një pjesë kthehen në mënyrë të detyruar prej vendeve pritëse të cilat nuk iu kanë njohur statusin e refugjatit dhe kanë vendosur ti dëbojnë duke i kthyer në vendin e origjinës. Një pjesë kthehen në mënyrë vullnetare.

Procesi i kthimit të pjesëtarëve të pakicave në Kosovë në përgjithësi ka qenë shumë i ngadalshëm. Sipas UNCHR-së, 2529 romë dhe 4883 ashkalijë dhe egjiptas janë kthyer vullnetarisht në Kosovë në mes janarit të vitit 2000 dhe nëntorit të vitit 2008. 600 pjesëtarë të komuniteteve roma, ashkali, egjiptas u kthyen vullnetarisht në Kosovë në mes të tetorit të vitit 2007 dhe nëntorit të vitit 2008 dhe morën ndihma nga UNHCR-ja nëpërmjet programeve të ndihmës me ushqim dhe materiale të tjerë si dhe programeve për riparimin e vendbanimeve të vogla. Lagja e Romëve në Mitrovicë, lagja Avdullah Presheva në Gjilan apo Lagja e Ashkalijve në Vushtrri janë shembuj të projekteve të kthimit që përfituan nga asistenca e madhe.

Në bazë të statusit të tyre ligjor, pjesëtarët e komuniteteve roma, ashkali, egjiptas janë ose pjesë e regjimit mbrojtës të refugjatëve ndërkombëtarë, më saktësisht refugjatë dhe azilkërkues, ose i nënshtrohen Principeve Udhëheqëse të Kombeve të Bashkuara për Zhvendosje të Brendshme, ose janë shtetas të vendeve të treta me qëndrim ilegal në Bashkimin Evropian që gëzojnë garanci dhe mbrojtje minimale nga kthimi i detyruar në bazë të principit të non-refoulement⁴⁸.

Personat potencial të kthyer romë, ashkalijë dhe egjiptas mund të dallohen me sa vijon:

- Persona të zhvendosur në Kosovë
- Persona të zhvendosur në Serbi
- Persona të zhvendosur në Mal të Zi
- Refugjatë apo Azilkërkues në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë
- Persona me Status të Përkohshëm Pranimi në Bosnje dhe Hercegovinë

⁴⁵ Rreth 4,500 romë, ashkalijë dhe egjiptas nga Kosova janë të regjistruar si Persona të Zhvendosur në Mal të Zi, derisa rreth 2000 romë, ashkalijë dhe egjiptas po kërkojnë statusin e refugjatëve në "ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë" (shih: Raportin e Komisionit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Emigrim, Refugjatë dhe Popullsi për Gjendjen e refugjatëve dhe personave të zhvendosur me qëndrim të gjatë në Evropën Juglindore, Doc. 11289, 24 maj 2007). Disa qindra romë, ashkalijë dhe egjiptas janë nën regjimin e mbrojtjes së përkohshme në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Bosnja dhe Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë vazhdimisht kërkojnë t'i kthejnë refugjatët në Kosovë.

⁴⁶ Vetëm në Gjermani janë rreth 35,000. Që nga 31 dhjetori 2004, numri i vijues i personave nga Kosova është dashur ta lëshojnë Gjermaninë (*ausreisepflichtige Personen*); romë (24.351), shqiptarë (16.151), ashkalijë (8.197), egjiptas (1.883), boshnjakë (1.305), serbë (670), goran/tërbesh (285), turq (41) dhe 1.628 të tjerë. Bundesamt für Migration und Flüchtlinge Deutschland, Informationszentrum Asyl und Migration, Serbien und Montenegro/Kosovo. Erkenntnisse des Bundesamtes Berichtsraum Dezember 2004 – März 2005. Stand März 2005.

⁴⁷ Emigrantët ilegal janë personat që nuk i përmbushin ose nuk i përmbushin më kushtet e rezidencës në vendet e tjera sepse (i) kanë hyrë ilegalisht (ii) kanë qëndruar më tepër se afati i vizës apo i lejëqëndrimit (iii) kërkesa e tyre për azil iu është refuzuar, apo (iv) lejëqëndrimi i tyre është anuluar.

⁴⁸ Shih Nenin 33 (1) të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Statusin e Refugjatëve.

- Azilkërkues në vendet e Evropës Perëndimore
- Persona në Vendet e Evropës Perëndimore me “status të tolerancës” (në Gjermani ky njihet si “Duldung”). Këta janë kryesisht personat të cilëve iu është refuzuar kërkesa për azil, por të cilët nuk lejohen të kthehen në Kosovë nga UNMIK-u dhe IPVQ-të (shih Dokumentin mbi Qëndrimin e UNHCR-së, qershor 2006).
- Emigrantë ilegal

Që nga viti 2006, UNHCR-ja mban qëndrimin që romët e Kosovës vazhdojnë të jenë të rrezikuar nga persekutimi dhe që kthimi i tyre duhet të bëhet në baza vullnetare, në bazë të vendimeve plotësisht të informuara individuale⁴⁹. Në anën tjetër, UNHCR-ja nuk e kundërshton kthimin e ashkalinjeve dhe egjiptasve pas procedurës së shqyrtimit individual. Në Dokumentin e saj të Qëndrimit, UNHCR-ja thotë që “(...) në rrethanat aktuale politike dhe socio-ekonomike, kthimi i personave nga këto dy grupe që nuk kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare duhet të bëhet gradualisht, për shkak të kapacitetit të kufizuar absorbues të Kosovës, për të mos nxitur faktorë destabilizues politik dhe social në kohën kur po zhvillohen negociatat mbi statusin e ardhshëm të Kosovës”.⁵⁰

Disa organizata / institucione ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave si Komisionari për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës apo Amnesty International kanë shprehur brengë rreth kthimit të detyrueshëm të romëve, ashkalinjeve apo egjiptasve apo për kthimin e tyre në shkallë të gjerë në Kosovë.⁵¹ Numri i personave që riatdhesohen në Kosovë sigurisht do të rritet në të ardhmen, pasi shumica e vendeve të Evropës Perëndimore ta kenë njohur pavarësinë e Kosovës. Në vitin 2007, Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u hartuan Strategjinë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar për t'u përgatitur për këtë proces. Strategjia përfshin projeksione buxhetore për rreth 5000 persona të riatdhesuar çdo vit.⁵²

Kthimi në shkallë të gjerë nga Evropa Perëndimore dhe nga vendet e tjera strehuese do ta ngarkonin për se tepërmi shoqërinë dhe politikën kosovare, si dhe shoqërinë e komuniteteve pritëse. Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit janë komunitetet më të varfra në Kosovë, dhe ata bazohen shumë në ndihmat financiare nga personat që jetojnë në Evropën Perëndimore. Kthimi i detyruar në shkallë të gjerë do të shkaktonte një krizë të rëndë socio-ekonomike dhe do të çonte në migrime të reja apo në zhvendosje sekondare.

Në bazë të procesit të paraparë të decentralizimit në Kosovë, autoritetet qendrore do të hartojnë kornizën për politikën e riintegrimit derisa komunat do të jenë aktorët përgjegjës kyç për riintegrimin e personave të kthyer. Në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë relevante përkatëse, ato do të duhet të gjejnë zgjidhje për strehim, punësim, qasje në shërbimet elementare, dokumentet dhe regjistrimin civil. Këto zgjidhje do të duhet të marrin parasysh dobësitë specifike të personave të zhvendosur nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas.

⁴⁹ Shih UNHCR: Pozita e UNHCR-së për Nevojat e Vazhdueshme për Mbrojtje Ndërkombëtare të Individëve nga Kosova, qershor 2006, p.7.

⁵⁰Ibd.

⁵¹ Shih: Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Komisioni për Emigrim, Refugjatë dhe Popullsi, Gjendja e Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur me qëndrim të gjatë në Evropën Juglindore, Doc. 11289 rev. 24 maj 2007; Amnesty International, Kosovë (Serbi), Nuk Ka Kthim të Detyrueshëm të Pakicave në Kosovë. AI Index: EUR 70/004/2007, 31 maj 2007; Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës i cili rishtazi ka inkurajuar Bosnjën dhe Hercegovinën që të mos i tërheq lejet e qëndrimit të përkohshëm për 3000 refugjatët kosovarë meqë gjendja e sigurisë është akoma e ndjeshme, në veçanti për refugjatët romë. Shih Komunikatën për Shtyp të Këshillit të Evropës, Zyra e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut, 28.06.2007; Këshilli i Evropës, Raporti i Kryesuesit të Report MG-S-Rom dhe Koordinatorit të Këshillit të Evropës për Aktivitetet e Romëve dhe Udhëtarëve Pas Misionit të Tyre në Kosovë, 26 shkurt - 1 mars 2006. 17 maj 2006 (MG-S-ROM (2006) 3)

⁵²Shih Qeveria e Kosovës, Prishtinë, korrik 2007: Strategjia për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, p.7

Para konfliktit në Kosovë, shumica e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve jetonin në lagje që konsiderohen si 'vendbanime joformale'.⁵³ Banorët e këtyre lagjeve nuk kishin të drejta pronësore mbi pronën e tyre, qoftë për shkak të mungesës së dokumenteve, transaksioneve të paregjistruara dhe/apo zaptimit të pronës. Shtëpitë zakonisht ndërtoheshin pa leje urbane apo leje të ndërtimit. Për të siguruar mbrojtjen e të drejtës së personave të zhvendosur dhe refugjatëve që të kthehen në shtëpitë e tyre, duhet të ndërmerren masa të veçanta për mbrojtjen e personave të zhvendosur nga këto zona duke marrë parasysh rrethanat speciale në të cilat u zhvilluan këto lagje (shih Kapitullin për Vendbanimet Joformale dhe Qasjen në Strehim).

Bashkërendimi i kthimit vullnetar të personave të zhvendosur nga Serbia dhe e personave të zhvendosur dhe refugjatëve nga vendet fqinje si Mali i Zi, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Bosnja e Hercegovina është kompetencë e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Aktualisht, udhëheqja e procesit të riatdhesimit të kthimeve të detyrueshme nga vendet e Evropës Perëndimore dhe vendet e tjera ka qenë kompetencë e rezervuar e Zyrës së UNMIK-ut për Komunitete, Kthim dhe Pakica. Kjo kompetencë prej 01 nëntorit 2008 i është transferuar Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës e mirëpret çdo kthim, megjithatë favorizon procesin gradual të kthimit duke mundësuar integrimin e qëndrueshëm të të gjitha personave të kthyer.

Korniza Ligjore dhe Institucionale

Sipas instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut⁵⁴, refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë të kthehen në shtëpitë e tyre, pa marrë parasysh etnicitetin e tyre, qoftë në mënyrë spontane apo të organizuar dhe me asistencë. Për më tepër, të drejtat e personave të zhvendosur dhe refugjatëve⁵⁵ për strehim dhe rikthim të pronës janë të njohura nga standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut⁵⁶. Në pajtim me principet themelore që udhëzojnë procesin e kthimit, kthimi duhet të bëhet në baza vullnetare, në mënyrë të sigurtë dhe të qëndrueshme⁵⁷. Procesi i kthimit duhet të bëhet me dinjitet dhe duhet të bazohet në zgjedhjen e lirë dhe të informuar të refugjatëve apo personave të zhvendosur.

Në këtë drejtim, mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave për strehim dhe rikthim të pronës duhet të jenë të hapur, efikas dhe të respektojnë standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut. Për më tepër, autoritetet shtetërore janë të obliguara të sigurojnë që personat e zhvendosur do të gëzojnë kushte adekuate për strehim dhe do të jenë të mbrojtur nga largimet e detyrueshme. Këto standarde pasqyrohen edhe në Principet Udhëheqëse të Kombeve të Bashkuara për Zhvendosje

⁵³Vendbanimet joformale janë ato vendbanime të cilat për një mori arsyesh nuk i përmbushin kriteret për njohje ligjore. Shih Deklaratën e Vjenës të Paktit të Stabilitetit të vitit 2004 për Vendbanimet Joformale në Evropën Juglindore në http://www.stabilitypact.org/housing/f%20-%20050415_Vienna%20Declaration.pdf

⁵⁴Shih Konventën e vitit 1951 për Statusin e Refugjatëve; Principet Udhëzuese për Zhvendosjen e Brendshme.

⁵⁵Termi 'refugjatë dhe persona të zhvendosur' i përfshin personat që janë zhvendosur përtej kufijve, për shembull për shkak të konfliktit apo shkatërrimit, të cilët mund të mos jenë pjesë e definicionit ligjor të refugjatëve sipas ligjit ndërkombëtar për refugjatë. Shih Shënimet Shpjeguese për Principet e Strehimit dhe Rikthimit të Pronës për Refugjatë dhe Persona të Zhvendosur. E/CN.4/Sub.2/2005/17/Add.1, 8 korrik 2005, para. 2 dhe 3.

⁵⁶Shih Nenin 8 (E Drejta Për Respektimin e Jetës Private dhe Familjare), Neni 14 (Ndalja e Diskriminimit), Neni 1, Protokoli 1 (E Drejta Për Pronë) dhe Neni 2, Protokoli 4 (Liria e Lëvizjes) e ECHR. Shih Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1287 (2000), 1036 (1996), 971 (1995) dhe 876 (1993); Rezoluta 820 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1993) dhe Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) për Kosovën. Për të drejtën e individit për t'u kthyer në vendin e tij, shih Nenin 13(2) e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR); Neni 12 (4) e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR); Nenet 45, 127, 132, 134 dhe 135 të Konventës së Gjenevës për Mbrojtjen e Personave Civil në Kohë të Luftës; dhe Neni (2) e Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit.

⁵⁷ Shih dokumentin e UNMIK-ut për "Të Drejtën për Kthim të Qëndrueshëm", 27 maj 2002,

të Brendshme⁵⁸ dhe rishtazi, në “Principet Pinheiro”, të miratuara në gusht të vitit 2005. ⁵⁹ “Principet Pinheiro” ofrojnë të drejtat për: (i) strehim dhe rikthim të pronës, (ii) mbrojtje nga zhvendosja, (iii) gëzim paqësor të posedimeve, (iv) strehim adekuat, (v) respektin për shtëpi dhe privaci, (vi) liri të lëvizjes dhe (vii) kthim vullnetar në siguri dhe dinjitet.

Zbatimi i së drejtës për kthim dhe strehim dhe rikthim të pronës varet nga a) strukturat efektive, transparente dhe të përgjegjshme për dhënien e asistencës për rindërtim, tokë dhe strehim dhe për zbatimin e projekteve përmbajtësore dhe të balancuara të kthimit; dhe b) hapësirat kompensuese kundër okupimit të paligjshëm të pronës për strehim, tokës dhe pronës tjetër; kundër ngacmimit, kërcënimeve dhe largimit me dhunë dhe nga shtrëngimi dhe/apo mashtrimi gjatë transferimit të pronës së patundshme.

Në pajtim me standardet ndërkombëtare për zbatimin e të drejtave të njeriut, në Kosovë, burimi primar i të drejtave të personave të zhvendosur dhe refugjatëve për t’u kthyer dhe për strehim dhe rikthim të pronës është Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.⁶⁰

Trupi përgjegjës për rivendosjen e të drejtave për strehim dhe pronë që janë rrezikuar nga konflikti është Agjencia Kosovare e Pronës⁶¹ (AKP, ish Drejtorati për Strehim dhe Pronë) që ka mandatin të zgjidh të gjitha konfliktet e mbetura të pronës rezidenciale, komerciale dhe bujqësore që janë të lidhura me konfliktin.⁶²

Sa i përket udhëzimeve politike për procesin e kthimit, Plani i Veprimit i Partneritetit Evropian (PVPE) Prioriteti 29 thekson nevojën për një kornizë të fuqishme strategjike për komunitetet dhe procesin e kthimit dhe një mekanizëm në nivelin komunal për lehtësimin e integritet të qëndrueshëm të personave të kthyer dhe të komuniteteve ekzistuese minoritare.

Qëndrimi i UNHCR-së për Nevojat e Vazhdueshme për Mbrojtje Ndërkombëtare të Individëve në Kosovë, qershor 2006, nënvizon principet kryesore ndërkombëtare për procesin e kthimit dhe është bazë për politikën e riatdhesimit të IPVQ-ve dhe UNMIK-ut.

Njëllloj i rëndësishëm është Kapitulli 4 “Të Drejtat e Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur” i pakos së Ahtisaarit.

Kushtetuta në Nenin 156 të Kushteve Tranzitore (Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur) cek që “(...) Republika e Kosovës do të promovojë dhe lehtësojë kthimin e sigurtë dhe me dinjitet të

⁵⁸Principet Udhëzuese për Zhvendosje të Brendshme, UN Doc. E/CN.4/1998/53/Add.2, Principi 21 thekson që “pronat do të mbrohen nën çdo rrethanë; pronat dhe posedimet e lëna prapa nga personat e zhvendosur duhet të mbrohen nga shkatërrimi dhe përvetësimi, okupimi apo shfrytëzimi arbitrar dhe i jashtëligjshëm”. Parimi 29.2 tregon se autoritetet kompetente.

⁵⁹ “Principet mbi Strehimin dhe Rikthimin e Pronës për Refugjatë dhe Persona të Zhvendosur” (‘Principet Pinheiro’) formalisht janë miratuar nga Nën-Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut më 11 gusht 2005. Shih Principet mbi Strehimin dhe Rikthimin e Pronës për Refugjatë dhe Persona të Zhvendosur, E/CN.4/Sub.2/2005/17.

⁶⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, 15 maj 2001, dhe Kushtetuta e Kosovës i garanton të drejtat e të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur nga Kosova “për t’u kthyer në shtëpitë e tyre, dhe për t’i rikthyer pronat dhe posedimet e tyre personale” dhe deklaron që “institucionet dhe organet kompetente në Kosovë do t’i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për ta lehtësuar kthimin e sigurtë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur në Kosovë”.

⁶¹AKP-ja përbëhet nga Sekretariati Ekzekutiv, Bordi Mbikëqyrës dhe Komisioni për Çështjet e Pronës (KÇP) si trup kuazi juridik. Sa i përket zgjidhjes së konflikteve mbi pronën, KÇP-ja do të marrë një vendim mbi pronën në raport me titullin, të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës dhe të drejtat mbi posedimet ligjore. Vendimet e KÇP janë përfundimtare nëse nuk ka ankesa. Vendimet e KÇP-së përbëjnë përcaktim të titullit dhe prandaj kërkuesit e suksesshëm që bartin vendime të KÇP-së do të mund ta regjistrojnë pronësinë e tyre (apo të drejtën për shfrytëzim) në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Patundshme në Kosovë.

⁶² Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10 mbi Zgjidhjen e Çështjeve Lidhur me Pronën e Patundshme Private, përfshirë këtu edhe Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e zëvendësuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50.

refugjatëve dhe personave të zhvendosur dhe do t'iu ndihmoj atyre në rikthimin e pronës dhe posedimeve të tyre (...)"⁶³

Dokumentet kryesore politike vendore për kthimin vullnetar të personave të zhvendosur janë Rekomandimet e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes për Azhurnimin e Politikave dhe Procedurave për Procesin e Kthimit të majit 2006, Manuali i Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm i qershorit 2006 dhe Protokoli për Kthimin Vullnetar dhe të Qëndrueshëm, i nënshkruar në qershor të vitit 2006 nga UNMIK-u, Qeveria e Serbisë dhe IPVQ-të.

Protokoli për Kthimin Vullnetar dhe të Qëndrueshëm ofron përkrahje për personat e zhvendosur nga Serbia që kanë vendosur të kthehen në Kosovë.

Për më tepër, shumica e komunave çdo vit hartojnë Strategji Komunale për Kthim që duhet të përkrahin procesin e kthimit vullnetar të personave të zhvendosur dhe refugjatëve në Kosovë sipas Manualit të Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm. Raporti i OSBE-së për Zbatimin e Strategjive Komunale për Kthim⁶⁴ thekson mungesën e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tri komuniteteve në procesin e planifikimit dhe zbatimit të kthimit në nivelin komunal.

Dokumenti kryesor politik vendor për kthimin e detyruar të personave që nuk kanë mundur të marrin azil apo nënshetësi në vendet tjera është Strategjia për Riintegrimin e Personave të Riadhesuar, e hartuar nga Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u.

Dokumentet tjera relevante për riadhesim janë Marrëveshjet Bilaterale për Pranim të Sërishëm të cilat UNMIK-u i ka nënshkruar me Gjermaninë, Zvicrën dhe Suedinë.

Në nëntor të vitit 2007, OSBE-ja së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka hartuar një set politikash dhe rekomandimesh ligjore gjatë konferencës 'Ju jeni të zhvendosur, të drejtat tuaja nuk janë'. Si rezultat, janë hartuar rekomandime konkrete për mbrojtjen e të drejtave të personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpi dhe për strehim dhe rikthim të pronës. Theks i veçantë i është kushtuar mbrojtjes së këtyre të drejtave për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptase.

Këto dokumente përbëjnë kornizën e përgjithshme në Kosovë për politikën e kthimit pa marrë parasysh etnicitetin e personave të kthyer.

Në këtë kontekst, rekomandimet vijuese, të hartuara për të adresuar gjendjen e personave të kthyer nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptase, pa marrë parasysh statusin e tyre në vendet pritëse, duhet të shihen si rekomandime plotësuese apo ritheksuese në dokumentet ekzistuese të politikave.

Masat

Niveli Qendror

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vetëdijshme që shtrirja e gjerë e varfërisë dhe pozita e pafavorshme dhe diskriminuese e këtyre e tri komuniteteve në Kosovë kërkon së pari forcimin e kapaciteteve të vetë komuniteteve që jetojnë në Kosovë për t'iu mundësuar atyre t'i forcojnë kapacitetet e tyre absorbuese.

Autoritetet relevante në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare do të hartojnë një databazë duke i përdorur të dhënat në dispozicion për numrin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve që

⁶³ Shih Kushtetutën e Kosovës. Internet : <http://www.kushtetutakosoves.info/?cid=2,275>

⁶⁴ Raporti i OSBE-së: Planifikimi dhe Zbatimi i Strategjisë për Procesin e Kthimit në Komunitet në Kosovë, prill-maj 2007

aktualisht jetojnë në Evropën Perëndimore si refugjatë (kërkuesit e refuzuar të azilit), në Serbi si persona të zhvendosur apo si refugjatë në vendet e tjera siç janë ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë që personat që janë larguar nga Kosova para 1 janarit 1998 dhe janë kthyer në Kosovë nga Evropa Perëndimore apo vendet e rajonit do të kenë të drejtë ta marrin statusin e qytetarit të Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të sigurojë që strategjitë dhe politikat relevante për kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur do të ofrojnë qasje përmbajtjesore dhe gjithpërfshirëse që përfshijnë aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave, qasjen në pronë, shërbimet esenciale (arsimi, shëndeti, shërbimet sociale) dhe dialogun ndërtnik. Zbatimi i këtyre elementeve duhet të sigurohet në projektet përkatëse të kthimit në pajtim me Manualin e Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm dhe Protokolin për Kthim Vullnetar dhe të Qëndrueshëm.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të adresojë zgjidhje alternative për procesin e kthimit duke hartuar një kornizë për integrimin dhe rivendosjen lokale (përfshirë skemat për dhënien e pronës) për personat e zhvendosur, që nuk dëshirojnë të kthehen në vendin e tyre të origjinës.

Ministritë relevante do të sigurojnë që Strategjia për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar do të adresojë të gjitha çështjet për personat e kthyer të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase. Gjithashtu është e nevojshme që kjo strategji të zërthehet në aktivitete konkrete e specifike të mbuluara me buxhet të përshtatshëm.

Ministria e Punëve të Brendshme do të identifikojë nevojën për regjistrimin/dokumentacionin e personave të riatdhesuar dhe të asistojë me një broshurë informative në disa gjuhë për institucionet, vendet dhe procedurat me anë të cilave personat e riatdhesuar mund ta regjistrojnë statusin e tyre para ose pas kthimit në Kosovë. (Shih gjithashtu Kapitullin për Regjistrim dhe Dokumentacion).

Autoritetet përgjegjëse do të sigurojnë që fëmijët që kanë lindur jashtë Kosovës do t'i kenë certifikatat e statusit civil dhe dokumentet adekuate personale (Shih gjithashtu Kapitullin për Regjistrim dhe Dokumentacion).

Politika për kthim e Zyrës së Kryeministrit do të sigurojë që refugjatët dhe personat e zhvendosur do të mund të ushtrojnë të drejtën për kthim në vendin e tyre të origjinës. Kthimi në ndonjë lokacion tjetër në Kosovë do të lehtësohet në rast se refugjatët apo personat e zhvendosur të kthyer vendosin ta bëjnë këtë.

Autoritetet relevante do t'i përfshijnë për së afërmi organizatat e shoqërisë civile të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase në procesin vendimmarrës për zhvillimin, lehtësimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve që janë të lidhura me procesin e kthimit.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës do të sigurojë që të gjitha institucionet qendrore dhe lokale dhe mekanizmat që merren me çështjet që janë të lidhura me procesin e kthimit do të përfshijnë përfaqësues të organizatave romë, ashkali dhe egjiptase për persona të zhvendosur dhe refugjatë.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës do të themelojë një mekanizëm qendror për çështjen e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve që janë kthyer me forcë. Krijimi i këtij mekanizmi do të përfshihet në Strategjinë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar që është miratuar rishtazi. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim do të themelojnë secila një pikë kontakti për çështjet e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve.

Një pikë e kontaktit për çështjet e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve do të themelohet në Zyrën e Kryeministrit dhe do të bashkërendojë me pikat e kontaktit të MPB dhe MKK politikat dhe

aktivitetet që kanë të bëjnë me kthimin e këtyre komuniteteve. Pika e kontaktit do të lehtësojë rrjetëzimin, bashkërendimin dhe përfshirjen e përfaqësuesve të komuniteteve, organizatave të shoqërisë civile dhe palëve tjera relevante dhe të interesuara të tri komuniteteve.

MKK-ja do të sigurojë dhe udhëzojë komunat që të përfshijnë çështjet e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të kthyer në Strategjitë e tyre Komunale për Kthim⁶⁵.

MKK-ja do të sigurojë që komunat të përfshijnë përfaqësuesit e personave të zhvendosur dhe refugjatëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase në Grupet e tyre Punuese Komunale siç është paraparë me Manualin e Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të personave të zhvendosur.

MKK-ja në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare do të luaj rol proaktiv në ofrimin e udhëzimeve për mekanizmat relevant komunal për kthim (Zyrtarët Komunal për Kthim, Grupi Punues Komunal për Kthim) për ti përkrahur komunitetet lokale në hartimin e projekteve për kthim (shih gjithashtu Rekomandimet për Komunat, pika 2).

Zyra e Kryeministri të Republikës së Kosovës do të përkrah pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptase në Grupin Punues për Dialog të Drejtpërdrejt. Grupi Punues do të identifikojë zgjidhjet për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit nga Kosova që janë zhvendosur në Serbi pa u regjistruar.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës do të sigurojë që organizatat e shoqërisë civile të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve do të përfshihen në hartimin dhe rishikimin e dokumenteve për procesin e kthimit.

Komunat

Të gjitha komunat do të përfshijnë çështjen e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të kthyer në Strategjitë e tyre Komunale për Kthim dhe do të hartojnë projekte relevante në bashkëpunim të ngushtë me komunitetet.

Autoritetet komunale do të sigurojnë fushatat e kontaktit dhe ofrimin e informatave për personat e zhvendosur të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase nga komunat e tyre dhe përfaqësimin adekuat të këtyre përfaqësuesve në Grupin Punues Komunal për Kthim. Për më tepër, autoritetet komunale do të sigurojnë që personat e zhvendosur të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase janë të përfshirë në mënyrë proporcionale në aktivitetet dhe projektet e kthimit të hartuara nga komunat. Komunat duhet të koordinohen me qeverinë qendrore të Kosovës në zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar si dhe duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë gjithashtu personave të kthyer me detyrim nga vendet pritëse.

Burimet Financiare

Institucionet komunale do të sigurojnë pjesëmarrjen korrekte dhe të barabartë të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në planifikimin dhe zbatimin e projekteve të kthimit, mekanizmi qendror për rishikim dhe miratim do të sigurojë alokim korrekt dhe të barabartë të fondeve për projekte.

Strategjitë dhe politikat relevante dhe planet zbatuese për integrimin e personave të zhvendosur dhe personave të kthyer me forcë do të përfshijnë një ndarje korrekte të burimeve financiare për të gjitha komunitetet etnike sipas përqindjes së tyre në mesin e personave të kthyer.

⁶⁵ Shih edhe Planin Aksional të Kosovës për Zbatimin e Partneritetit Evropian 2006, gusht 2006, Prioriteti 28, Veprimi Nr. 9 "Përfshirja e komuniteteve, personave të kthyer, përfaqësuesve të femrave në vendimmarrje dhe planifikimin e çështjeve të kthimit".

Institucionet relevante të Republikës së Kosovës do të bëjnë çdo përpjekje për mbledhjen e burimeve financiare për riintegrimin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të kthyer dhe për forcimin e kapacitetit të komuniteteve.

Institucionet qendrore të Republikës së Kosovës do të përkrahin komunat që pranojnë romët, ashkalijtë dhe egjiptasit e kthyer, në përpjekje për të pranuar përkrahje financiare nga donatorët ndërkombëtarë për riintegrimin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës do të inkurajojë bashkësinë ndërkombëtare të aplikojë rregullat dhe procedurat e njëjta për të gjitha komunitetet gjatë ofrimit të përkrahjes financiare për procesin e kthimit dhe rindërtimit.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës do të identifikojë mundësitë për përkrahjen e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve që janë kthyer vullnetarisht në vitet e fundit pa pranuar asnjë lloj të asistencës.

Personat e Kthyer nga Vendbanimet Joformale

Qeveria dhe Komunat janë të vetëdijshme që personat e kthyer që kanë jetuar në vendbanime joformale kanë nevojë për masa të veçanta për rregullimin e tokës, për ta mbrojtur të drejtën e tyre për kthim dhe të drejtat e tyre për strehim. Këto masa mund të përfshijnë alokimin e shfrytëzimit të tokës, riparcelizimin, regjistrimin e transferimeve joformale dhe/ose trashëgimin dhe integrimin në planet hapësinore komunale dhe urbane. Në rastet kur rregullimi është i pamundur (p.sh. për shkak të rrezikut shëndetësor për shkak të afërsisë të lumi apo toka e mbeturinave), duhet të jenë në dispozicion tokat dhe/ose strehimi alternativ.

MKK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Komunat do të zhvillojnë një studim të vendbanimeve të shkatërruara të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të Kosovës me theks të veçantë në lehtësimin e ofrimit të kompensimeve për humbjet e shkatëruara, në formë të rivendosjes dhe/ose kompensimit si dhe për të mbrojtur të drejtën e personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpi vullnetarisht apo për t'u integruar.

MMPH në bashkëpunim me MKK dhe Komunat do të sigurojë që shkatërrimi i vendbanimeve joformale nuk do ta pengojë të drejtën për kthim të refugjatëve dhe personave të zhvendosur romë, ashkali dhe egjiptas në vendin e tyre të origjinës.

MMPH dhe Komunat do të sigurojnë respektimin e kërkesave të Standardit të Pronës (Qëllimi 6.8) dhe Prioritetit 31 të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian, dhe t'i ndërpresin përpjekjet e paarsyeshme për zhvillimin e tokës publike që kanë vendbanime të vjetra joformale nga komunitetet minoritare apo grupe tjera vulnerable për qëllime tjera prej përdorimit rezidencial nga banorët e mëhershëm.⁶⁶ Nëse është i nevojshëm rizhvillimi, atëherë personave të zhvendosur do t'u ofrohet kompensimi apo strehimi alternativ.

Në rastet kur vendbanimet joformale ku zhvillohen projektet e kthimit dhe rindërtimit okupojnë tokën publike, shtetërore apo shoqërore, komunat dhe autoritetet qendrore do të legalizojnë gjendjen e tyre, në bashkëpunim me institucionet e tjera qeveritare dhe aktorët e tjerë relevantë ndërkombëtar (Shih gjithashtu Kapitullin për Qasje në Strehim dhe Vendbanime Joformale).

⁶⁶Plani për Zbatimin e Standardeve për Kosovën, Qëllimi 6.8: Autoritetet komunale do t'i ndërpresin përpjekjet e paligjshme apo të paarsyeshme për zhvillimin e tokës publike në të cilën janë të vendosura për një kohë të gjatë vendbanimet joformale të grupeve minoritare apo të grupeve të tjera vulnerable; EPAP, Prioriteti 31: Rregullarizimi i vendbanimeve joformale. Gjetja e zgjidhjeve të qëndrueshme për riatdhesim për integrimin e pakicës rome e cila jeton në kushte të rrezikshme për jetë në kampe dhe për grupet e personave të zhvendosur që jetojnë në qendra joformale.

Komunat, kurdo që të jetë e nevojshme, do të lehtësojnë riparcelizimin, alokimin e përdorimit të tokës, integrimin në plane hapësinore dhe urbane dhe njohjen *de facto* të zaptimit të gjatë të tokës shoqërore.

Pranimi dhe akomodimi ad-hoc

Autoritetet relevante do të sigurojnë zbatimin e plotë të dokumenteve të miratuara të politikave (p.sh. Procedurat e ripranimit) që ofrojnë një mekanizëm pranues dhe përkrahës për personat e kthyer me forcë nga Evropa Perëndimore dhe nga vendet e tjera.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës do të zbatojë një program të strehimit për të ofruar akomodim të mjaftueshëm dhe preliminar për të kthyerit potencial. Institucionet qeverisëse, prandaj, do të studiojnë zgjidhjet siç është akomodimi i përkohshëm në pronë që aktualisht është nën administrimin e AKP-së për personat e kthyer që nuk kanë akomodim.

Informatat dhe Kontakti

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës në bashkëpunim me MKK-në dhe me përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare do të sigurojë fondet e nevojshme për t'iu mundësuar institucioneve komunale, më saktësisht Zyrtarëve Komunal për Kthim kontakte dhe informata më efikase dhe më specifike për refugjatët dhe personat e zhvendosur romë, ashkali dhe egjiptas dhe për ta lehtësuar vendimmarrjen e tyre të informuar.

Në veçanti, autoritetet relevante komunale (Zyrtarët Komunal për Kthim) në bashkëpunim me UNHCR-në dhe agjencitë partnere zbatuese dhe organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare do ta rrisin numrin e Vizitave Informative specifike për personat e zhvendosur romë, ashkalinj dhe egjiptas. Përfaqësuesit e komuniteteve do të përfshihen në Vizitat Informative.

Institucionet relevante do të sigurojnë që të kthyerit potencial do të marrin të gjitha informatat e nevojshme për ta marrë pastaj vendimin e informuar. Në veçanti, Agjencioni Kosovar i Pronës (AKP) do t'i intensifikojë aktivitetet e kontaktit për personat e zhvendosur dhe refugjatët romë, ashkalinj dhe egjiptas.

AKP do të bashkërendohet me MPB për të ofruar të gjitha informatat për pronën nëpërmjet autoriteteve relevante në vendet pritëse dhe organizatat që zbatojnë programet e asistencës për riatdhesim.

Institucionet përgjegjëse do të ndërmarrin hapat e nevojshëm për njohjen e certifikatave apo dokumenteve (p.sh. certifikatat e lindjes, certifikatat arsimore/diplomat, dokumentet e punësimit dhe dokumentet e pensionit, certifikatat e shëndetit) të lëshuara nga Shtetet e tjera dhe në rast se i kanë humbur gjatë kthimit, autoritetet relevante do t'i përkrahin personat e kthyer që t'i marrin këto dokumente apo kopjet e tyre nga vendet pritëse (Shih gjithashtu Kapitullin për Regjistrim dhe Dokumentacion).

Bashkësia Ndërkombëtare

Vendet pritëse duhet të marrin në konsideratë dhënien e lejeve të qëndrimit të paktën për ato grupe të refugjatëve që në mes tjerash kanë jetuar në vendet pritëse për një kohë të gjatë, që kanë punësim të përhershëm, fëmijët e të cilëve shkojnë në shkollë, dhe që vuajnë nga sëmundjet që nuk mund të shërohen në Kosovë.

Vendet pritëse kërkohen të përmbahen nga kthimi i detyruar i personave prona e të cilëve është zaptuar ilegalisht apo shkatërruar derisa të garantohet që personi i kthyer mund ta rikthejë pronën e tij/saj.

Vendet pritëse kërkohet të marrin në konsideratë dhënien e burimeve financiare për t'iu mundësuar autoriteteve kosovare të krijojnë akomodim të përkohshëm për personat e kthyer që nuk kanë asnjë akomodim, siç është dhënia me qira e pronës që aktualisht është nën administrimin e AKP-së.

Organizatave ndërkombëtare do të përkrahin pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në Grupin Punues për Dialog të Drejtpërdrejt. Grupi Punues do të identifikojë zgjidhjet për pjesëtarët e këtyre komuniteteve që janë zhvendosur në Serbi pa u regjistruar.

Bashkësia ndërkombëtare do t'i jap prioritet dhe të sigurojë mbrojtjen e të drejtës për kthim të romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në vendin e tyre të origjinës me anë të zgjerimit të "zonave të mbrojtura"⁶⁷ apo me anë të masave të tjera të ngjashme.

Organizatave ndërkombëtare si OSBE-ja, UNHCR-ja dhe Këshilli i Evropës do të lehtësojnë bashkëpunimin më të ngushtë në mes romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në Kosovë dhe organizatave të personave të zhvendosur dhe refugjatëve të tri komuniteteve për t'i përfshirë në mënyrë më të mirë brengat e tyre në politikat dhe aktivitetet e procesit të kthimit.

Shoqëria civile romë, ashkali dhe egjiptase

Organizatave për personat e zhvendosur romë, ashkali dhe egjiptas jashtë Kosovës do të forcojnë rrjetëzimin e tyre, do të lehtësojnë shpërndarjen e informatave për procesin e kthimit dhe mundësitë, do të zhvillojnë bashkërendim dhe bashkëpunim më të ngushtë me organizatave vendore dhe ndërkombëtare që punojnë në sektorin e personave të zhvendosur dhe refugjatëve (UNHCR-ja dhe agjencitë partnere zbatuese, Këshilli Danez për Refugjatë, shoqata e personave të zhvendosur UNIJA, etj).

Ata do të emërojnë përfaqësues nga komunitetet e tyre si pjesëtarë zyrtarë në Grupet Punuese Komunale për Kthim për të qenë në gjendje të ushtrojnë ndikim të menjëhershëm në politikat komunale për kthim, në planifikimin dhe zbatimin e projekteve për kthim dhe në aktivitetet e tjera që janë të lidhura me procesin e kthimit.

Organizatave për personat e zhvendosur që veprojnë në Kosovë dhe jashtë saj ftohen ta fuqizojnë rrjetëzimin e tyre për të qenë partnerë efektiv në procesin e kthimit.

2.7. Regjistrimi dhe Dokumentacioni

Përshkrimi i Gjendjes

E drejta për t'u njohur si person para ligjit është e drejtë themelore e njeriut. Regjistrimi civil është parakusht për qasje në të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Regjistrimi i statusit civil është dokumenti i vetëm zyrtar publik, që dëshmon statusin civil të një personi para familjes së tij/saj, shoqërisë dhe Shtetit. Regjistrimi civil e njeht emrin e një personi, e drejtë kjo që personi nuk mund ta mohojë, që e identifikon personin si pjesë përbërëse të shoqërisë në të cilën ai/ajo jeton dhe i ndërmer marrëdhëniet gjyqësore. Identiteti i personave që nuk janë pjesë e regjistrimit civil nuk njihet nga sistemi ligjor dhe ata nuk mund të ekzekutojnë

⁶⁷Sipas Draft Ligjit për Krijimin e Zonave Speciale të Mbrojtura (nëntor 2007), "Zona Speciale e Mbrojtur" do të jetë një zonë e definuar me hartë, ose një zonë e definuar rreth një monumenti, ndërtese, grupi ndërtesash, fshatit apo ndonjë qyteti historik që mund të mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet që mund ta dëmtojë kontekstin e saj historik, kulturor, arkitektonik apo arkeologjik apo mjedisin natyror. Rindërtimi i vendbanimit të Rudeshit (më parë i banuar nga egjiptasit të cilët sot janë të zhvendosur në Mal të Zi) në Istog është shtyrë për shkak të përfshirjes së këtij vendbanimi në 'zonë të mbrojtur kulturore'.

akte të vlefshme ligjore. Ata me gjasë do të përjashtohen nga ushtrimi i të drejtave dhe obligimeve.

Në përgjithësi, çështja e regjistrimit dhe dokumentacionit përfshin dy procedura të ndryshme dhe dy kategori të ndryshme të dokumenteve: A) Regjistrimi i statusit civil që mundëson regjistrimin e fakteve vitale të statusit civil të një personi siç janë certifikata e lindjes, martesës dhe vdekjes; dhe B) regjistrimi i banorëve rezidentë të Kosovës që i mundëson personit të marr lejen e njoftimit dhe dokumentin e udhëtimit.

Në Kosovë, shumë romë, ashkalijë dhe egjiptas nuk janë të regjistruar si banorë rezidentë dhe nuk kanë status civil apo nuk i kanë të gjitha dokumentet e nevojshme. Kategori të ndryshme të njerëzve ndikohen nga mungesa e dokumenteve personale:

1. Banorët e Kosovës
2. Personat e zhvendosur në Kosovë
3. Personat e zhvendosur në Serbi dhe në Mal të Zi
4. Personat e kthyer nga Serbia dhe Mali i Zi
5. Personat që janë riatdhesuar në Kosovë
6. Personat që do të riatdhesohen në Kosovë

Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve që nuk janë të regjistruar si banorë rezidentë dhe që nuk kanë status civil. UNHCR-ja vlerëson që rreth 20% deri në 40% të këtyre komuniteteve nuk janë të regjistruar si banorë rezidentë në Kosovë.⁶⁸

Arsyet për përqindjen relativisht të madhe të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve që nuk janë të regjistruar si banorë rezidentë dhe nuk kanë status civil janë të shumëfishta, përfshirë këtu procedurat komplekse dhe të pavolitshme (posaçërisht kur fëmijët nuk lindin në spital), varfëria dhe analfabetizmi, mungesa e regjistrimit tek disa gjenerata, mungesa e vetëdijes për obligimet dhe përparësitë e regjistrimit të këto komunitete, si dhe jetesa në vendbanime joformale. Femrat dhe vajzat e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptase janë më të ndjeshme për shkak të martesave të hershme dhe shpeshherë të paregjistruara dhe për shkak të përjashtimit apo largimit nga shkolla. Për më tepër, tarifatat për lëshimin e certifikatave të statusit civil apo të regjistrimit si banorë rezidentë dallojnë në komunat e ndryshme dhe mund të përbëjnë pengesë për familjet e varfra që t'i marrin dokumentet⁶⁹.

Mungesa e regjistrimit dhe dokumenteve e pengon njohjen e individit të ndikuar si person para ligjit dhe e pengon qasjen e tij/saj në të gjitha drejtat themelore⁷⁰, përfshirë të drejtën për arsim, për shëndetësi, për përfitimet sociale, për pjesëmarrje në zgjedhje dhe për lirinë e lëvizjes (të drejtën për t'u larguar nga vendi). Për më tepër, personat jorezidentë në Kosovë nuk mund të marrin pjesë në regjistrimin e ekonomive familjare dhe në regjistrimin e popullsisë të paraparë

⁶⁸UNHCR Kosovë – Zyra e Shefit të Misionit Office (OCM), Njësi i Mbrojtjes, Fushata për Regjistrimin Civil të Komunitetit roma, ashkali, egjiptas në Kosovë-Plani Aksional, qershor 2006, p.1.

⁶⁹Sipas Raportit të OSBE-së të vitit 2007 për Regjistrimin Civil të Pjesëtarëve të Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptas. Konkludimet e ushtrimit Monitorues (11 dhjetor 2006-15 janar 2007), tarifatat për lëshimin e p.sh. certifikatës martesore apo dëshmia që një person është i gjallë dallon deri në 9 €. Për më tepër, derisa lëshimi i letërnjoftimit është falas, zëvendësimi apo korigjimi i letërnjoftimit mund të kushtojë deri në 20 €.

⁷⁰Për shembull personat që nuk kanë regjistrim të banimit janë de facto të përjashtuar nga marrja e ndihmës ligjore. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/36 mbi Ndihmën Ligjore, Seksioni 10: “(...) Klasat vijuese të personave, sipas prioritetit të alokimit të burimeve, janë të kualifikuar të marrin ndihmë ligjore: a) banorët e përhershëm të Kosovës; b) banorët e përkohshëm të Kosovës Temporary residents of Kosovo nga juridiksionet që ofrojnë ndihmë reciproke ligjore për banorët e përhershëm të Kosovës; c) personat e tjerë të përcaktuar sipas ligjit apo marrëveshjeve ndërkombëtare. (...)”.

sipas legjislacionit aplikativ. Megjithatë, kjo është e rëndësishme meqë sipas legjislacionit aplikativ⁷¹ komunitetet e caktuara minoritare mund të gjenden në pozitë për t'i gëzuar të drejtat specifike të komuniteteve apo të kualifikohen për masa të veprimit afirmativ kur të arrijnë një numër apo përqindje të caktuar të popullsisë. Për më tepër, disponueshmëria e të dhënave të besueshme statistikore mbi përbërjen etnike të popullsisë së Kosovës është element kyç për zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare si dhe për hartimin e politikës efektive të pakicave që ka në shënjestër nevojat specifike të komuniteteve.

Situata e mijëra romëve, ashkalijve dhe egjiptasve që aktualisht jetojnë jashtë Kosovës si persona të zhvendosur, refugjatë apo emigrantë kërkon vëmendje të veçantë. Sipas vlerësimeve të UNHCR-së, në Serbi vetëm 23.000 prej 40.000-50.000 romëve, ashkalijve dhe egjiptasve janë të regjistruar si persona të zhvendosur (Shih edhe Kapitullin për Kthimin dhe Rintegrimin për më shumë hollësi). Të tjerët, gjithashtu rreth 20.000 apo më shumë, nuk kanë dokumente themelore të identifikimit dhe shumica prej tyre kurrë nuk janë regjistruar në librat e regjistrimit që janë transferuar nga Kosova në Serbi. Refugjatët dhe persona e zhvendosur që nuk kanë dokumente themelore janë posaçërisht të rrezikuar të shndërrohen në qytetarë pa shtet.⁷²

Një fenomen tjetër që mund të vërehet në mesin e personave të kthyer nga Evropa Perëndimore: në disa raste, personat e kthyer pohojnë që i kanë humbur certifikatat apo dokumentet që i kanë marrë gjatë qëndrimit të tyre në Evropën Perëndimore (certifikatat e lindjes, certifikatat e shkollës, etj) dhe ballafaqohen me vështirësi gjatë marrjes së kopjeve të certifikuar kur të kthehen në Kosovë.

Korniza Ligjore dhe Institucionale

Standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut që janë të aplikueshme drejtpërdrejt në Kosovë⁷³ mbrojnë të drejtën e çdo personi që të njihet kudo si person para ligjit (Neni 16, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike) dhe të drejtën për shtetësi (Neni 15.1, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut). Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut mbron çdo person që mos t'i mohohet shtetësia e tij/saj apo e drejta për ta ndryshuar shtetësinë e tij/saj (Neni 15.2). Të gjithë fëmijët kanë të drejtën të mbrohen nga diskriminimi, të regjistrohen menjëherë pas lindjes, të kenë emër dhe të kenë shtetësi.⁷⁴ Autoritetet, në juridiksionin e të cilave aplikohen këto standarde ndërkombëtare, janë të obliguara t'i zbatojnë këto të drejta në pajtim me ligjin e tyre kombëtar në veçanti aty ku fëmija përndryshe do të ishte pashtetësi.

Republika e Kosovës është e përkushtuar ndaj standardeve ndërkombëtare që synojnë parandalimin apo zvogëlimin e mungesës së shtetësisë siç janë: Konventa e Kombeve të Bashkuara e vitit 1954 për Statusin e Personave pa Shtetësi, Konventa e vitit 1961 për Zvogëlimin e Mungesës së Shtetësisë, Konventa Evropiane mbi Shtetësinë e vitit 1997 dhe Konventa e Këshillit të Evropës e vitit 2006 mbi Shmangien nga Mungesa e Shtetësisë në raport me Shtetet e Reja.

Regjistrimi i banorëve rezidentë rregullohet me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/13 për Regjistrin Qendror Civil, dhe Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut Nr. 2001/12 përmban kriteret dhe procedurat me anë të cilave përcaktohet identiteti dhe pranueshmëria e aplikantëve. Në nivelin komunal, qendrat komunale për regjistrim civil i kryejnë këto procedura, derisa në nivelin qendror është operacional regjistri qendror civil.

⁷¹Si për shembull për njohjen dhe përdorimin e gjuhëve minoritare nga autoritetet komunale, Shih: Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 02/L-37 mbi Përdorimin e Gjuhëve, i miratuar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/51 të datës 20 tetor 2006.

⁷²Shih UNHCR/PRAXIS, mars, 2007: Analizë e Gjendjes së Personave të Zhvendosur nga Kosova në Serbi: Ligji dhe Praksa, p.11 ff

⁷³ Shih Rregulloren e UNMIK-ut e 2001/9 e amendamentuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2002/9.

⁷⁴ Neni 24, ICCPR dhe Neni 2, Neni 7 i Konventës së vitit 1989 për të Drejtat e Fëmijëve.

Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 2004/46 mbi Regjistrat e Statusit Civil, i nxjerr nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/21 përcakton rregullat dhe procedurat me anë të cilave regjistrohen faktet themelore të lindjes, martesës dhe vdekjes në zyrat komunale të statusit civil. Gjithashtu në këtë kuadër ekziston edhe Ligji nr 02-l-26 , per ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit nr 2004/46 per Regjistrat e Gjendjes Civile, i shpalluar me rregulloren e UNMIK-ut 2008/25 te dates 16.05.2008.

Sa i përket politikave, në maj të vitit 2006, Zyra e Kryeministrit lëshoi “Rekomandimet për Azhurnimin e Politikave dhe Procedurave të Kthimit” që njohin punën e pakryer me kërkesat për dokumentet e regjistrimit civil dhe i udhëzojnë komunat “... të sigurojnë që kërkesat në pritje për regjistrimin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të kompletohen brenda gjashtë muajve të ardhshëm. Për këto grupe nuk do të aplikohen tarifa të vonshme për shërbimet administrative”. Qeveria e Republikës së Kosovës është e vetëdijshme për nevojën e vazhdueshme për të siguruar zbatimin e këtyre Rekomandimeve.

Qeveria e Republikës së Kosovës është gjithashtu e përkushtuar të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE) Prioriteti 28, i cili i referohet dokumenteve dhe në mes tjerash cek që: “(..) Të rritet efikasiteti i lëshimit të dokumenteve personale për të gjitha komunitetet përfshirë këtu edhe personat e kthyer (...)”. Përgjegjësia për zbatimin e këtij veprimi është në duart e Ministrisë së Punëve të Brendshme, komunave dhe UNMIK-ut.⁷⁵

Masat

Niveli qendror

Qeveria e Republikës së Kosovës do të ndër marr hapat e nevojshëm për ta mundësuar regjistrimin civil dhe rezidentë të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të Kosovës për të siguruar që të gjithë personat nga Kosova janë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre të shtetësisë dhe të Drejtat themelore të Njeriut.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të bashkëpunojnë ngushtë me Qeverinë e Republikës së Serbisë, vendet pritëse dhe organizatat ndërkombëtare për të siguruar që të gjithë personat e zhvendosur, refugjatët dhe emigrantët me origjinë nga Kosova, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, janë në gjendje të marrin shtetësinë, statusin civil dhe regjistrimin si banorë rezidentë të Kosovës, nëse dëshirojnë ta bëjnë këtë.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vetëdijshme për gjendjen veçanërisht të ndjeshme të mijëra romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të zhvendosur të cilët nuk kanë regjistrim themelor dhe janë të zhvendosur nga Kosova, dhe në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Serbisë do të ndër marr masa për ta parandaluar gjendjen ku këta persona do të mbesin pa shtetësi në të ardhmen.

Ministria e Punëve të Brendshme do të identifikojë nevojën për regjistrimin/dokumentacionin e personave të riatdhesuar dhe do të ndihmojë me broshurat informative në disa gjuhë për institucionet, vendet dhe procedurat, me anë të të cilave personat e riatdhesuar mund ta regjistrojnë statusin e tyre civil dhe vendbanimin e tyre para apo gjatë kthimit në Kosovë. Autoritetet përgjegjëse do të sigurojnë që fëmijët që kanë lindur jashtë vendit do të marrin certifikata adekuate të statusit civil si dhe dokumentet personale (Shih edhe Kapitullin mbi Kthimin dhe Integrimin).

Autoritetet përgjegjëse do të ndër marrin hapat e nevojshëm për njohjen e dokumenteve (siç janë certifikatat/diplomat arsimore dhe akademike; dokumentet e punësimit dhe dokumentet e

⁷⁵ Plani i Veprimit i Kosovës për Zbatimin e Partneritetit Evropian 2006, Prioriteti Nr. 28, veprimi Nr. 12.

pensionit; certifikatat e shëndetit) të lëshuara nga Shtetet tjera për të siguruar riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar (Shih edhe Kapitullin mbi Kthimin dhe Integrimin).

Qeveria e Republikës së Kosovës do të hartojë një politikë për ta lehtësuar regjistrimin e këtyre komuniteteve dhe të parandaloj gjendjen ku një numër i konsiderueshëm i personave do të ballafaqohen me probleme të ngjashme në të ardhmen. Kjo politikë duhet të adresojë gjendjen e personave që jetojnë në Kosovë dhe të personave që aktualisht jetojnë jashtë Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të kërkoj asistencë nga grupet ndërkombëtare të interesit ta furnizojnë çdo person me dokumente të humbura dhe të sigurojnë qasje të përmirësuar dhe kontakt për të shmangur mungesën e regjistrimit në të ardhmen.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të lëshojë instruksione me shkrim ku i obligon të gjitha komunat të miratojnë procedura specifike për zbatimin e “Rekomandimeve për Azhurnimin e Politikave dhe Procedurave të Kthimit” të Zyrës së Kryeministrit (24 maj 2006) duke iu referuar në mënyrë specifike regjistrimit të personave që nuk kanë dokumente dhe që janë pjesëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të hartojë një politikë koherente, transparente dhe përmbytësore për t’iu shmangur pengesave burokratike në nivelin komunal dhe rasteve të ardhshme të personave të paregjistruar.

Autoritetet qendrore do të autorizojnë masat afatshkurta që do të çojnë në procedura më fleksibile dhe do të zbatojnë masa të veçanta siç është heqja dorë nga tarifat apo “dritaret e përgjithshme të mundësive” me ç’rast procedurat standarde zëvendësohen me procedura më fleksibile. Këto masa afatshkurtra do të jenë valide për të gjithë personat që jetojnë në Kosovë dhe do të shoqërohen me fushata të informimit dhe kontaktit me shënjestër specifike të këto tri komunitete.

Autoritetet qendrore dhe komunale do të sigurojnë që do të monitorohet zbatimi i këtyre masave afatshkurtra në nivelin komunal.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të zbatojë ndryshime sistematike dhe të qëndrueshme (për gjendjen dhe procedurat ligjore) që do të çojnë në një kornizë të re ligjore me qasje të orientuar kah klientët e cila do të përmirësojë mundësitë e regjistrimit dhe të marrjes së të gjitha dokumenteve të nevojshme.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës do të sigurojë bashkëpunimin në mes Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për të siguruar ekzistimin e mekanizmave referues për banorët e paregjistruar të identifikuar në sistemin arsimor dhe në sistemin e shëndetësisë.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të emërojë një trup adekuat përgjegjës për mbledhjen e statistikave për mungesën e regjistrimit në mesin e popullsisë, përfshirë këtu edhe rastet e mungesës së shtetësisë. Ky trup do të monitorojë trendet e regjistrimit dhe do të bëjë rekomandime për Qeverinë e Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të organizojë, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, fushata të kontaktit dhe të vetëdijesimit për t’i informuar romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit për nevojën dhe procesin e regjistrimit.

Ministria e Punëve të Brendshme do të identifikojë nevojën për regjistrimin/dokumentacionin e personave të riatdhesuar dhe do të ndihmojë me broshurat informative në disa gjuhë për institucionet, vendet dhe procedurat me anë të të cilave personat e riatdhesuar mund ta regjistrojnë statusin e tyre civil dhe vendbanimin e tyre para apo gjatë kthimit në Kosovë (Shih edhe Kapitullin mbi Kthimin dhe Integrimin).

Amendamentet procedurale

Institucionet përgjegjëse relevante do të definojnë një komplet modest dhe të harmonizuar të tarifave minimale dhe maksimale për çdo certifikatë dhe shërbim të statusit civil për t'iu shmangur vendosjes së tarifave joproporcionale në komunat e ndryshme.

Institucionet përgjegjëse relevante do të zgjerojnë dhe lehtësojnë përdorimin e procedurave të dëshmitarëve për të përcaktuar identitetin dhe pranueshmërinë e aplikantëve.

Ministria e Punëve të Brendshme do të bëjë rishikimin e procedurave për publikun dhe për zyrtarët komunal për regjistrim për t'i udhëzuar individët nëpër sistem në mënyrë koherente. Nëse një individ nuk mund t'i përmbush kushtet për regjistrimin si banorë rezidentë apo regjistrimin e statusit civil, ai/ajo duhet të marr informata për procedurat e mëtutjeshme dhe duhet siguruar që ai/ajo kanë qasje në masat që mundësojnë vazhdimin me procedurat e nevojshme, përfshirë këtu edhe qasjen në gjykata.

Personat e kthyer që nuk i kanë të gjitha dokumentet, në veçanti fëmijët që kanë lindur në Evropën Perëndimore, do të përkrahen nga autoritetet relevante në përpjekjet e tyre për t'i marrë të gjitha dokumentet urgjentisht dhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e vendeve pritëse.

Amendamentet ligjore

Qeveria dhe Kuvendi do të sigurojnë ndryshimin e legjislacionit aplikues për ndihmë ligjore për të siguruar që grupet vulnerabile që nuk janë të regjistruara si banorë rezidentë të kenë qasje në ndihmë ligjore falas në veçanti për rastet kur ata ballafaqohen me rrezikun e mbetjes pa shtetësi.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të krijojë mekanizmat që iu lejojnë personave të zhvendosur dhe refugjatëve që nuk kanë qenë prezent në Kosovë gjatë regjistrimit të fundit civil dhe që ende jetojnë jashtë Kosovës të regjistrohen dhe t'i marrin të gjitha dokumentet e nevojshme.

Qeveria do të krijojë mekanizma që lehtësojnë regjistrimin dhe qasjen në dokumente për personat që kanë lindur në Republikat e tjera të ish Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë.

Qeveria do të sigurojë që të gjitha dokumentet dhe udhëzimet relevante për regjistrimin civil të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve do t'i shpërndahen të gjitha institucioneve relevante komunale.

Qeveria do të sigurojë që, deri në atë masë që është e mundur, fëmijët jashtëmartesor, të kenë qasje në regjistrimin civil me kushte të barabarta me fëmijët që kanë lindur në martesë të regjistruara.

Komunat

Komunat do të zbatojnë përbrenda legjislacionit në fuqi një obligim specifik për nëpunësit e zyrave për regjistrimin e statusit civil që të lëshojnë vendime me shkrim për të gjithë personat të cilëve iu janë refuzuar kërkesat për regjistrim dhe të ofrojnë informata me shkrim për masat që këta persona mund t'i ndjekin për ta kryer regjistrimin civil.

Zyrat e regjistrimit do t'i informojnë të gjithë aplikuesit për procedurat ekzistuese të apelit.

Të gjitha komunat do të aktivizojnë "bordet e rishikimit" për të lehtësuar regjistrimin e komuniteteve vulnerabile që nuk kanë dokumente.

Komunat, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve do të krijojnë "ekipe mobile" për fushata të kontaktit me romët, ashkalijtë dhe egjiptasit.

Komunat do të ndajnë burime adekuate nga buxheti komunal për të siguruar operacionet e ekipeve mobile dhe zbatimin e aktiviteteve të kontaktit për regjistrim civil me shënjestër në komunitetet roma, ashkali dhe egjiptas.

Komunat do të caktojnë një pikë kontakti të regjistrimit civil nga komunitetet roma, ashkali dhe egjiptas që do të bashkërendojë përpjekjet komunale dhe do të sigurojë dhe mbledh informatat relevante.

Komunat do të miratojnë një qasje të ndjeshme gjinore që i ndihmon nënat dhe foshnjat në raste të lindjeve në shtëpi dhe e promovon regjistrimin civil të të gjitha foshnjave të sapolindura.

Komunat do të themelojnë një mekanizëm bashkëpunues në mes të autoriteteve relevante komunale, përfshirë këtu autoritetet shëndetësore dhe mamitë, dhe komunitetet roma, ashkali dhe egjiptas, përfshirë përfaqësuesit joformal të komuniteteve dhe femrat nga komunitetet që ndihmojnë në lindjet në shtëpi, për ta penguar joregjistrimin e mëtejshëm.

Komunat do t'i njohin të dhënat rreth regjistrimit të mbledhura nga shoqëria civile roma, ashkali dhe egjiptase dhe t'i pranojnë ato për lehtësimin e mëtutjeshëm të regjistrimit dhe lëshimit të dokumenteve

Komunat duhet të përkujdesën për veprime afirmative aty ku ka mundësi të kandidatve potencial-intelektual të ofroj poste në drejtoritë komunale, sidomos kur behët fjale për edukim shëndetësi dhe kulturë.

Organizatat Ndërkombëtare

Organizatata ndërkombëtare do ta përkrahin shoqërinë civile dhe autoritetet relevante dhe aktivitetet e tyre që kanë në shënjestër romët, ashkallijtë dhe egjiptasit në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

Organizatata ndërkombëtare do të lehtësojnë trajnimin e romëve, ashkallijve dhe egjiptasve për t'i informuar komunitetet e tyre për nevojën dhe rëndësinë e regjistrimit.

Bashkësia ndërkombëtare dhe autoritetet relevante do të sigurojnë që të gjithë romët, ashkallijtë dhe egjiptasit që jetojnë jashtë Kosovës janë të informuar dhe do të kenë mundësi të marrin pjesë në regjistrimin e planifikuar.

Bashkësia ndërkombëtare është e thirrur të bëjë krejt çka është e mundur për ta përkrahur regjistrimin e romëve, ashkallijve dhe egjiptasve me origjinë nga Kosova, por që jetojnë momentalisht në Serbi pa u regjistruar si persona të zhvendosur. Ky regjistrim duhet t'u lejoj atyre që ose të marrin statusin e personave të zhvendosur në Serbi ose të kthehen në Kosovë nëse dëshirojnë.

Organizatata ndërkombëtare do të hartojnë një udhëzues që i udhëzon autoritetet relevante për procedurat e verifikimit dhe regjistrimit për komunitetet e caktuara vulnerable, duke i marrë parasysh praktikatat më të mira të vendeve tjera.

Komunitetet roma, ashkali dhe egjiptas

Shoqëria civile e romëve, ashkallijve dhe egjiptasve do të vazhdojë të mbledh të dhënat relevante për regjistrimin dhe dokumentacionin. Personat dhe organizatat e shoqërisë civile nga komunitetet roma, ashkali dhe egjiptas do të marrin pjesë në përpjekjet për informimin e pjesëtarëve të tri komuniteteve për nevojën dhe rëndësinë e regjistrimit.

2.8 Çështjet Gjinore

Përshkrimi i Gjendjes

Përmirësimi i gjendjes së femrave romë, ashkali dhe egjiptase është posaçërisht i rëndësishëm, meqë femrat e komuniteteve romë, ashkali, egjiptase mund të konsiderohen të diskriminuara në mënyrë të dyfishtë – si pjesëtarë të komuniteteve të tyre dhe si femra.

Komunitetet roma, ashkali dhe egjiptase dhe femrat e këtyre komuniteteve në veçanti janë ballafaquar me pengesa të shumta sociale, politike dhe ekonomike në Kosovë, siç është mungesa e lirisë të lëvizjes për shkak të pasigurisë pas luftës, diskriminimi etnik, dhe niveli i ulët i edukimit në komunitetet e tyre, dhuna dhe mungesa e qasjes në vendimmarrje politike. Një tjetër problem me të cilin bërballen është dhuna, sidomos dhuna në familje e cila është e përhapur por e pa adresuar.

Femrat nga këto komunitete konsiderohen të kenë pozitë tejet të dobët në tregun e punës, statusi i tyre arsimor është shumë i ulët dhe statusi i tyre shëndetësor duket të jetë shumë më i dobët sesa statusi i femrave të komunitetwve tjera dhe komunitetit shumicë.

Megjithatë, për këtë fakt ekzistojnë vetëm disa të dhëna; meqë edhe dokumentet e politikave gjinore siç janë Programi Programi Kosovës për Barazi Gjinore 2008-2013 apo Strategjia Kombëtare për Gjininë si pjesë e Strategjisë Planifikuese për Zhvillimin e Kosovës (SPZHK) (2007) fare nuk përmendin gjendjen e femrave romë, ashkallike dhe egjiptase.

Prandaj, Pwr kwttw arsye do të ishte tejet e rëndësishme që në bashkëpunim me Rrjetin e grave Rome, Ashkallike dhe Egjiptase të zhvillohet një studim për gjendjen aktuale të këtyre femrave..

Një karakteristikë tjetër e gjendjes së femrave romë, ashkali dhe egjiptase është mungesa e pjesëmarrjes në jetën publike. Aktualisht, vetëm një femër nga komuniteti ashkali është anëtare e Kuvendit të Kosovës. Në anën tjetër, femrat nga tri komunitetet janë mjaft aktive në sektorin e shoqërisë civile; ato në mes tjerash i kanë krijuar rrjetet e grupeve të femrave roma, ashkali dhe egjiptase dhe i udhëheqin disa OJQ.

Në disa studime, UNDP-ja e ka përmenduar gjendjen e femrave të këtyre komuniteteve:

Punësimi⁷⁶

Shkalla e Papunësisë
Mosha 15-24: femrat jo-romë 81% femrat romë: 99%
Mosha 25-54: femrat jo-romë 60% femrat romë: 73%
Mosha më e vjetër se 55: femrat jo-romë 55% femrat romë 71%
Shkalla e Papunësisë
Total: femrat jo-romë: 76% femrat romë: 90%
Total: popullsia shumicë mashkullore: 39% meshkujt romë: 63%

Ulja e shkallës së papunësisë në mesin e grupmohave më të vjetra në krahasim me grupmohat e reja mund të kuptohet si indikator i përkeqësimit të gjendjes ekonomike të komuniteteve në përgjithësi dhe për pozitën e femrave në veçanti.

⁷⁶ Për të dhëna shih: UNDP, Fytyrat e Varfërisë, Fytyrat e Shpresës. Bratislavë 2005. Shumica e vendeve nuk i njohin ashkalljtë dhe egjiptasit si grupe të veçanta etnike. Prandaj, shumica e botimeve ndërkombëtare i përmendin vetëm romët, mirëpo kjo zakonisht i përfshin edhe ashkalljtë dhe egjiptasit.

Edukimi⁷⁷

Shkalla e Aftësive për Shkrim dhe Lexim
Mosha 15-24: jo-rome 98% Roma: 65% femrat rome: 56%
Mosha 25-34: jo-rome < 98% Roma: 76% femrat rome: 69%
Përqindja e Aftësive për Shkrim dhe Lexim në mesin e Djemve dhe Vajzave
Mosha 15-24: jo-rome 0.99; Roma: 0.74
Mosha 25-34: jo-rome 0.99; Roma: 0.83

Të dy shënimet tregojnë jo vetëm pozitën e pafavorshme të romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në përgjithësi, por edhe pozitën dyfish të pafavorshme të femrave të këtyre komuniteteve.

Shëndeti

Sa i përket statusit shëndetësor, vetëm disa të dhëna – nga viti 2000 – gjithashtu tregojnë pozitën e pafavorshme të femrave të këtyre komuniteteve.

Sipas studimeve mbi shëndetësinë riprodhues në komunitete, të zhvilluar nga Mjekët e Botës (DOW) në vitin 2001, 56 përqind e nënave të përfshira në këtë studim nga kampi për persona të zhvendosur të komuniteteve romë, ashkali, egjiptas në Plemetin kanë lindur në shtëpi; 12% raportuan që kanë humbur foshnjën në muajin e parë pas lindjes.

Studimi gjithashtu zbuloi që 40% e nënave ashkali në komunën e Fushë Kosovës nuk janë takuar me ndonjë mjek gjatë shtatzënisë së tyre; të gjitha përveç nëntë përqind prej tyre kanë thënë se nuk menduan se kjo do të ishte e rëndësishme. 75 përqind të femrave seksualisht aktive të përfshira në këtë studim nuk kanë përdorur asnjë mjet kontrceptiv; 79 përqind prej tyre nuk kishin asnjë informatë për mjetet kontrceptive.

Të dhënat e pakta theksojnë nevojën për adresimin e gjendjes së femrave të këtyre komuniteteve. Strategjia për Integrimin e Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve do ta trajtojë gjininë si një çështje tejet të rëndësishme që ndërlidhet në të gjithë sektorët që i adreson kjo strategji.

Për të arritur zbatimin adekuat të masave relevante, çështjet gjinore duhet të futen në politikat e përgjithshme.

Ministritë apo institucionet relevante qeveritare, që janë në krye të zbatimit të strategjisë, duhet të sigurojnë që masat për femrat rome, ashkali dhe egjiptase janë përfshirë në masat e tyre të përgjithshme dhe që buxhetet respektive i marrin parasysh çështjet gjinore dhe të ofrojnë linja specifike buxhetore për masat që synojnë femrat rome, ashkallike dhe egjiptase.

Prandaj, ministrisë dhe institucionet relevante qeveritare do të konsultohen me mekanizmat institucional për arritjen e barazisë gjinore (në nivelin qendror dhe lokal) dhe me rrjetin e grupeve të femrave rome, ashkali dhe egjiptase.

Përveç kësaj, do të sigurohet që strukturat e femrave rome, ashkali dhe egjiptase (organizatat joqeveritare, rrjetet, individët e respektuar të komuniteteve) do të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve/masave.

⁷⁷ Për të dhëna shih: UNDP, Fytyrat e Varfërisë, Fytyrat e Shpresës. Bratislavë 2005

Korniza Ligjore dhe Institucionale

Ligjet të cilat adresojnë çështjet gjinore janë:

Ligjin Kundër Diskriminimit (Ligji Nr. 2004/32), Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/27 (për Ligjin për Punë Themelore në Kosovë), Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/36 (për Shërbimin Civil në Kosovë) apo Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut Nr. 2003/2 që e zbaton Rregulloren Nr. 2001/36.

Ligjet dhe rregulloret specifike për gjininë janë: Ligji për Barazi Gjinore (Ligji Nr. 2004/18), i miratuar nga Kuvendi i Kosovës 2004, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 (për Ndalimin e Trafikimit të Personave në Kosovë) dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 (për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje).

Dokumentet tjera relevante të politikave janë Programi Kosovës për Barazi Gjinore që është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 24 Prill 2008..

Institucionet që punojnë për barazi gjinore janë: Agjencioni për Barazi Gjinore (Zyra e Kryeministrit); Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore – (Zyra e Kryeministrit); Njësitë për të Drejta të Njeriut në ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Njësitë për Barazi Gjinore – Institucioni i Ombudspersonit; Zyrtarët për Barazi Gjinore në ministri; Komisioni Parlamentar për Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore dhe Këshilli Ndërmintorror për Barazi Gjinore.

Në nivelin komunal, Zyrtarët për Barazi Gjinore/Njësitë për të Drejta të Njeriut në Komuna dhe Komisionet Komunale për Barazi Gjinore punojnë në këtë çështje.

Masat

Masat e Përgjithshme

Mekanizmat institucional për arritjen e barazisë gjinore (në nivelin qendror dhe lokal) dhe rrjeti i grupeve të femrave rome, ashkali dhe egjiptase do të përfshihen në dizajnimin, zbatimin dhe monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha aktiviteteve të kanë të bëjnë me femrat rome.

Edukimi

Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASHT) në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, është përgjegjëse për zbatimin e masave të përmendura më poshtë.

Prodhimi i të dhënave kualitative dhe kuantitative për prirjet e përgjithshme të edukimit të të dhënat e ndara gjinore dhe etnike çdo dy vite

Zhvillimi i programit shkollor që promovon rolet e reja gjinore me fokus të veçantë në nxënësit e shkollave fillore

Krijimi i Qendrave për Edukim të Komunitetit ku studentët nga familjet e pafavorizuara mund t'i kryejnë detyrat e shtëpisë dhe të kalojnë kohën duke lexuar

Organizimi i orëve plotësuese për vajzat dhe fëmijët që studiojnë dhe duhet të punojnë në shtëpi

Zbatimi i programeve edukative dhe aftësuese për femrat dhe meshkujt e rinj që nuk mund të vijnë shkollimin formal të mesëm apo të lartë

Zhvillimi dhe zbatimi i programeve edukative “peer2peer“ për prindërit e rinj që promovojnë rolet të barabarta prindërore

Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të punës dhe programeve studimore për prindërit e rinj roma, ashkali, egjiptas

Inkurajimi i pjesëmarrjes aktive i nënave në shkollimin e fëmijëve me anë të pjesëmarrjes në takimet e prindërve, përfshirjes në bordet e shkollave, etj.

Përkrahja e çifteve të reja martesore të mbesin në shkollë, lehtësimi i diskutimeve se si martesë dhe shkollimi mund të ndodhin në të njëjtën kohë, nuk ka nevojë për ta lënë anash shkollimin – këto programe duhet të kenë në shënjestër studentët e shkollave të mesme dhe universiteteve.

Zhvillimi i programeve për motivimin e familjeve (gjeneratën e dytë dhe të tretë) për krijimin e mjedisit përkrahës për çiftet e reja që të vijojnë shkollimin sekondar dhe terciar

Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të mentorimit për studentët e shkollave të mesme dhe universitete duke i marrë parasysh praktikat më të mira dhe mësimet e vendeve fqinje.

Punësimi

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, është përgjegjëse për zbatimin e masave të përmendura më poshtë:

Deri në vitin 2010, Universiteti i Prishtinës (Fakulteti Ekonomik) së bashku me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të prodhojë të dhëna kuantitative dhe kualitative për fuqinë punëtore të komuniteteve romë, ashkali, egjiptas posaçërisht për punësimin e kategorizuar në bazë të: moshës, gjinisë, edukimit, aktiviteteve ekonomike dhe profesionit

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me donatorët dhe institucionet relevante financiare do të zbatojë masa që inkurajojnë vetëpunësimin e familjeve romë, ashkallike dhe egjiptase.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të alokojë fonde për ndërmarrjet e përbashkëta të familjeve romë, ashkali dhe egjiptase me kushte speciale për kreditë për femra

Komunat, rrjetet e bizneseve dhe shoqëria civile do të hartojnë Planet Rajonale të Veprimit për përkrahjen e iniciativës sipërmarrëse në mesin e femrave, përfshirë studimet, kurset e trajnimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, punëtoritë për përdorimin e kredive të vogla për biznese, dizajnimi i punëtorive për femra dhe për menaxhimin e roleve të ndryshme (nëna, bashkëshorte, nëna të vetme, profesioniste)

Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Bankën Botërore, Unifem, Unicef, UNDP dhe me Rrjetin e grave Romë, Ashkallike dhe Egjiptase dhe organizata të tjera të grave, do të bëjë një vlerësim përmbajtësor të varfërisë në mesin e femrave romë, ashkallike dhe egjiptase, duke marrë parasysh ndikimin që varfëria ka në shëndetin, edukimin, barazinë gjinore dhe në ciklin e jetës

Rekrutimi i femrave nga tri komunitetet në shkolla të administratës publike dhe sigurimi i bursave të plota

Shëndeti

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, është përgjegjëse për zbatimin e masave të përmendura më poshtë.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, me përkrahjen e organizatave ndërkombëtare, do të prodhojë një studim përmbajtësor kualitativ dhe kuantitativ të gjendjes shëndetësore të tri komuniteteve

MSH do t'iu ofrojë qasje femrave të komuniteteve romë, ashkali, egjiptas në shërbimet shëndetësore duke i eliminuar praktikat diskriminuese

Qeveria- Agjencia për barazi gjinore do të krijojë mekanizma institucional në të gjitha nivelet për të siguruar një rrjedhë të rregullt të informatave në mes komuniteteve romë, ashkali, egjiptas dhe institucioneve të shëndetit publik

Zbatimi i modelit të ndërmjetësuesve të shëndetit në komunitet për t'i përkrahur femrat e komuniteteve roma, ashkali, egjiptas në veçanti për shëndetin riprodhues dhe të drejtat e tyre

Trajnimi dhe punësimi i femrave në Qendrat e Mjekësisë Familjare në mbarë Kosovën

Themelimi i Qendrave për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare në rajone me numër të konsiderueshëm të banorëve romë, ashkali dhe egjiptas dhe të sigurohet kontakti me komunitetet

Dhuna Kundër Femrave dhe Diskriminimi i Femrave

Në bashkëpunim me shoqërinë civile, Qeveria e Kosovës do të hartojë programe dhe do të krijojë struktura institucionale që do ta luftojnë dhunën kundër femrës

Qeveria e Republikës së Kosovës –Agjencia për barazi gjinore do të zbatojë programe që synojnë parandalimin e dhunës në familje me anë të forcimit të rezistencës mashkullore ndaj sjelljeve të dëmshme dhe me anë të promovimit të identiteteve të barabarta gjinore

Agjencia për barazi gjinore, do të ndërtojë partneritet efektiv me rrjetin e grave dhe OJQ-të e grave rome, ashkali dhe egjiptase për luftimin e praktikave tradicionalisht të dëmshme

Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Qendrat lokale për Punë Sociale, në bashkëpunim me shoqërinë civile do të zhvillojnë mekanizma për regjistrimin dhe monitorimin e martesave të hershme për të dizajnuar veprime të orientuara

Qeveria do të inkurajojë UNICEF-in, UNIFEM-in dhe organizatat e tjera joqeveritare të prodhojnë të dhëna kualitative dhe kuantitative për të gjitha praktikat që janë të dëmshme për femrat dhe meshkujt

UNIFEM-i dhe organizatat dhe rrjetet e grupeve të grave dhe organizatat tjera të shoqërisë civile do të punojnë me Rrjetin e grave Rome, Ashkalike dhe Egjiptase dhe organizatat të tjera të ketyre komunitetev për t'i përkrahur ato dhe aktivitetet e tyre përpara institucioneve shtetërore, përbrenda komuniteteve dhe në media

Pjesëmarrja Politike

Përkrahja e pjesëmarrjes politike të femrave nga komunitetet në nivelin lokal dhe qendror nëpërmjet hartimit të programeve për trajnim dhe mentorim

Hartimi i programeve të veçanta për fuqizimin e organizatave të femrave rome, ashkalike dhe, egjiptase për integrimin e perspektivës së femrës në punën e strukturave politike të komuniteteve romë, ashkali, egjiptas

Fuqizimi i femrës në komunitete si votuese nëpërmjet fushatave për edukimin e votuesve dhe nëpërmjet shmangies nga votimi familjar në zgjedhje

Mediat

Zhvillimi dhe transmetimi i programeve edukative të cilat promovojnë role të barabarta gjinore, modele të reja të prindërve dhe përgjegjësisë së meshkujve të rinj që t'i përkrahin femrat për edukim dhe zhvillimi të karrierës, dhe të cilat inkurajojnë ambiciet e prindërve që të investojnë në edukimin formal të vajzave të tyre

Zhvillimi i kapaciteteve të femrave roma, ashkali, egjiptas dhe organizatave të tyre për t'iu mundësuar atyre t'i shfrytëzojnë mediat në mënyrë efikase

Organizatrat dhe donatorët ndërkombëtarë duhet të ofrojnë përkrahje financiare për programet e zhvillimit të kapacitetit të mediave të cilat transmetojnë raporte objektive për tri komunitetet me fokus të veçantë në gjendjen e femrave romë, ashkallike dhe egjiptase në komunitet dhe shoqëri.

2.9 Kultura, Mediat dhe Informimi

Përshkrimi i Gjendjes

Konflikti në Kosovë shkaktoi ndërprerjen e aktiviteteve kulturore dhe mediatike në Kosovë duke prekur edhe këto tre komunitete. Në periudhën pas konfliktit, këto aktivitete u rigjallëruan në mënyrë të ngadalshme pasi administrata ndërkombëtare në Kosovë dhe Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës (IPVQ) i përqendruan politikat e tyre në nevojat e komuniteteve tjera. Shumica e aktiviteteve kulturore dhe mediatike të romëve, ashkallijve dhe egjiptasve mbetën në nivelin e projekteve, kryesisht të financuara nga donatorët ndërkombëtarë.

Në tri departamentet e MKRS-së atë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë të hartura të aprovuara dhe të zbatueshme në vazhdimësi Politikat Programore të veçanta për përkrahjen dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve/ minoritetve , e në kuadër të kësaj edhe në përkrahjen e kulturës dhe aktiviteteve sportive të komunitetëve Romë, Ashkali dhe Egjiptas.

Vetëm një numër i vogël i pjesëtarëve të komuniteteve që kanë mbetur në Kosovë janë të trajnuar në gazetari profesionale, ndërsa një numër tejet i vogël prej tyre kanë marrë pjesë në trajnime profesionale për menaxhim dhe promovim kulturor apo në profesione artistike.

Duhet përkujtuar që ekziston një diferencim i rëndësishëm në mes të tri komuniteteve. Derisa ashkallijtë dhe egjiptasit e përdorin gjuhën shqipe si gjuhë të nënës dhe qëndrojnë shumë afër me kulturën shqiptare, romët në përgjithësi e flasin gjuhën romani si gjuhën e tyre të parë dhe kanë traditë të dallueshme kulturore të ndikuar nga grupet e tjera etnike si shqiptarët, serbët apo turqit.

Sa i përket mediave, kulturës dhe informimit, kjo do të thotë që ashkallijtë dhe egjiptasit mund të mbështeten në aktivitetet mediatike dhe kulturore në gjuhën shqipe – nëse ato i adresojnë dhe pasqyrojnë nevojat e dy komuniteteve, përderisa romët do të kenë nevojë për aktivitete “plotësuese” mediatike dhe kulturore në gjuhën e tyre.

Vetëm disa institucione në Kosovë janë të përkushtuar ndaj aktiviteteve mediatike dhe kulturore të këtyre tri komuniteteve. Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka program të rregullt televiziv në gjuhën rome (45 minuta në javë). Stacionet private televizive nuk transmetojnë programe specifike për tri komunitetet.

Që nga nëntori i vitit 2007 në Prizren vepron radio stacioni në gjuhën romani “Radio Romano Avazo”. Pajisjet janë siguruar nga një donator privat, megjithatë, radio stacioni ballafaqohet me probleme serioze meqë shpenzimet e tjera nuk janë të mbuluara plotësisht.

Disa radio stacione transmetojnë programe në gjuhën romani apo transmetojnë programe në gjuhët tjera (shqip, serbisht) për tri komunitetet⁷⁸. Shumica e këtyre aktiviteteve mediatike zbatohen me fonde të projekteve, që shpeshherë nënkupton që në fund të projektit pushojnë edhe aktivitetet mediatike. Përveç programeve të RTK-së në gjuhën romani, nuk ka asnjë medium tjetër që është pjesë integrale dhe e qëndrueshme e spektrit mediatik në Kosovë.

Për më tepër, shumica e këtyre aktiviteteve mediatike, në veçanti transmetimet e radio stacioneve janë programe muzikore dhe përshëndetje, dhe nuk përmbajnë pothuajse asnjë lajm apo informatë të rëndësishme dhe relevante për këto komunitete.

⁷⁸ Sipas Komisionit të Pavarur për Media 15 media kombëtare dhe nacionale transmetojnë programe në gjuhën rome dhe programe të informimit për komunitetet roma, ashkali dhe egjiptase. Megjithatë, për shkak se shumica e transmetimeve mvaren nga fondet e projekteve, numri i saktë i këtyre programeve është më i vogël.

Mediat kryesore të shtypura nuk ofrojnë rregullisht hapësirë për mbulimin e gjendjes aktuale në Kosovë nga perspektiva e tri komuniteteve apo nuk i shohin këto komunitete si lëxues të rëndësishëm interesi i të cilëve duhet të pasqyrohet në medime.

Ekzistojnë vetëm dy revista periodike në gjuhën romani (njëra prej tyre është revistë për fëmijë). Vetëm një numër i vogël i pjesëtarëve të tri komuniteteve punojnë me mediat elektronike apo ato të shtypura në Kosovë.

Kjo qartë tregon që ekziston një mungesë e konsiderueshme e mediave në Kosovë që adresojnë nevojat dhe interesat e tri komuniteteve apo madje edhe e mediave që udhëhiqen nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve.

Institucionet kulturore (teatrot, muzetë, galeritë, sallat e koncerteve, libraritë, etj) kanë fare pak aktivitete kulturore për tri komunitetet apo nuk i konsiderojnë këto komunitete si audiencë apo vizitorë. Një pjesë e mirë e komunitetit artistik që ka ekzistuar para konfliktit është larguar.

Në institucionet kulturore të MKRS-së (teatrot, muzetë, galeritë, sallat e koncerteve, bibliotekat etj) kanë qasje të barabartë për shfrytëzimin e tyre të gjitha komunitetet pa diskriminim duke përfshirë edhe komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas, gjithmonë duke respektuar ligjet që kanë të bëjnë me kulturën dhe Ligjin Kundër Diskriminimit. Komunitetet, Romë, Ashkali dhe Egjiptas duhet të parashtrajnë kërkesat e tyre për shfrytëzimin e institucioneve të kulturës dhe të sportit dhe ato kërkesa do të aprovohen nga MKRS-ja me ç'rast do të përmbushen nevojat e këtyre komuniteteve.

Që nga përfundimi i konfliktit janë mbajtur vetëm disa ngjarje kulturore të këtyre tri komuniteteve. Disa aktivitete kulturore për komunitetin romë janë mbajtur më 8 prill – Dita Ndërkombëtare e Romëve që festohet në mbarë botën. Megjithatë, shumica e ngjarjeve kulturore janë financuar nga organizatat ndërkombëtare dhe aty morën pjesë kryesisht romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit dhe ndërkombëtarët që punojnë në Kosovë, dhe pothuajse asnjë shqiptar apo serb i Kosovës.

Ekziston nevoja urgjente për riaktualizimin e kulturës dhe traditave të komuniteteve tek komunitetet tjera, por edhe tek gjeneratat e reja të komuniteteve. Gjenerata e re gjithnjë e më tepër influencohet nga kulturat e tjera – nga kultura botërore rinore dhe nga kultura e grupeve tjera etnike në Kosovë – shqiptarët, serbët dhe turqit e Kosovës. Ky proces është jashtëzakonisht i fuqishëm në Kosovë si pasojë e mungesës së personaliteteve të suksesshme nga komunitetet dhe për shkak të mungesës së prezencës apo pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komuniteteve në jetën publike dhe për shkak të statusit inferior që tri komunitetet e kanë në shoqërinë kosovare.

Përveç kësaj, mund të thuhet që kultura e këtyre komuniteteve nuk prezantohet në mënyre reale por në një mënyrë e cila vetëm sa i përkeqëson paragjykimet dhe stereotipet.

Korniza Ligjore dhe Institucionale

Ligji i aplikueshëm në Kosovë nuk frenon në asnjë mënyrë mediat në gjuhën e komuniteteve minoritare në Kosovë. Ai, thekson që komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të “ofrojnë informata në gjuhën dhe alfabetin e Komunitetit të tyre, duke i krijuar dhe mirëmbajtur mediat e tyre”, dhe të “garantohet qasja dhe përfaqësimi në mediat publike si dhe programet në gjuhët relevante”.

Ky kapitull prandaj jo vetëm që cakton mburoja për mediat private elektronike apo të shtypura, por gjithashtu garanton përfshirjen e komuniteteve në procesin e vendimmarrjes dhe për përfaqësimin e tyre në institucionet relevante për t’iu mundësuar atyre që të marrin pjesë në zhvillimin e programeve, procesin e editorializimit, dhe në mekanizmat për mbikëqyrje.

Në vitin 2007, Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media vendosi të zbatojë zbritje në tarifën e licencës për transmetuesit që ju shërbejnë komuniteteve minoritare. Megjithatë, për shkak të ankesave ndaj këtij vendimi, Bordi për Shqyrtimin e Ankesave të Mediave vendosi në tetor të vitit 2007 që Komisioni i Pavarur për Media duhet ta rishikojë modelin për tarifën për licencë.

Në Zyrën e Kryeministrit është themeluar një Fond për Përkrahen e Mediave të Pakicave, Multietnike dhe të Pafavorizuara. Në bazë të ligjit të aplikueshëm (Rregullorja e UNMIK 2006/14 për Radio Televizionin e Kosovës), ky fond financohet nga pesë përqindëshi i Tarifës për Transmetim Publik. Megjithatë, për shkak të ndërprerjes së kontratës për mbledhjen e tarifës nëpërmjet Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), momentalisht nuk ka asnjë kontribut në këtë fond. Përveç kësaj, KEK-u deri më tani nuk ka depozituar para në këtë Fond për periudhën kur ende e ka mbledhur tarifën.

Po ashtu me 03 dhjetor 2008 Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar rregulloren NR.01/2008 për funksionimin e fondit për mbeshtetjen e mediave minoritare, multietnike dhe grupeve tjera të veçanta

Sa i përket aktiviteteve dhe institucioneve kulturore, ligjet në vijim janë të rëndësishme: Ligji Nr. 02/L-51 (për Botimin e Aktiviteteve dhe Librave); Ligji Nr. 02/L-88 (Ligji për Trashëgiminë Kulturore); Ligji Nr. 02/L-57 (për Institucionet Kulturore), Ligji Nr. 02/L-12 (për Teatrin), Ligji Nr. 02/L-59 (për Filarmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës). Megjithatë, asnjëri prej këtyre ligjeve nuk i përmend institucionet dhe aktivitetet kulturore të apo për pjesëtarët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase.

Masat

Ministria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, është përgjegjëse për zbatimin apo bashkërendimin e masave të përmendura më poshtë.

Megjithatë, zbatimi i të gjitha masave të propozuara kërkon edhe pjesëmarrjen që nga fillimi të përfaqësuesve dhe organizatave të tri komuniteteve.

Masat për Institucionalizim

Krijimi i Komisionit të përbashkët për Kulturë dhe Informim në Ministrinë e Kulturës dhe në Departamentin për Informim, me përfshirje të përfaqësuesve të komuniteteve dhe ministrive relevante

Komisioni për Kulturë dhe Informim do të hartojë planet e hollësishme relevante për zhvillimin e mëtutjeshëm kulturor dhe mediatik të komuniteteve.

Përfaqësuesit e komuniteteve do të përfshihen në procesin e zhvillimit dhe Ministria e Kulturës dhe Departamenti për Informim do të punësojnë nga një person nga secili komunitet.

Përfaqësuesit e komuniteteve do të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes për aktivitetet kulturore dhe mediatike në të gjitha nivelet

Themelimi i katër Qendrave Rajonale për Kulturë dhe Informim dhe një Qendër Kombëtare për Kulturë dhe Informim (Prishtinë) dhe furnizimi i tyre me pajisjet e nevojshme

Institucionet publike të kulturës si teatrot, muzetë, galeritë, sallat e koncerteve, libraritë, etj. do të zhvillojnë aktivitete të rregullta me përfshirje të artistëve nga komunitetet apo që synojnë komunitetet si audiencë.

Qeveria do të ofrojë burime financiare për zhvillimin e rregullt të aktiviteteve kulturore siç janë shfaqjet teatrale dhe ekspozitat dhe leximet.

Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Ministria e Kulturës dhe Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, është përgjegjëse për zbatimin apo bashkërendimin e masave të përmendura më poshtë.

Zbatimi i veprimeve afirmative në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet relevante në punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve në institucionet mediatike dhe kulturore në të gjitha nivelet

Zbatimi i veprimeve afirmative në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet relevante siç është kuota për studentë të komuniteteve në fakultetet apo akademitë e artit dhe bursat për studentë

Punësimi i pjesëtarëve të tri komuniteteve në Qendrat për Kulturë dhe Informim

Trajnimi i pjesëtarëve të tri komuniteteve për aftësi siç janë menaxhimi i pajisjeve teknike, politikat editoriale, gazetaria, menaxhimi dhe komunikimi

Përkrahja e aktiviteteve për zhvillim të kapaciteteve për gazetarë dhe për botimin e gazetave, revistave dhe dokumentarëve

Trashëgimia Kulturore

Lehtësimi i kërkimeve dhe studimeve të tri komuniteteve në fushën e trashëgimisë kulturore

Me Ligjin për Trashëgimi Kulturore Nr.2006/02-L 88 janë paraparë mundësitë dhe procedurat e kërkimeve dhe studimeve në fushën e Trashëgimisë Kulturore për të gjitha komunitetet që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore të tri komuniteteve dhe përfshirja e saj në listën e trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kosovës

Me Ligjin për Trashëgimin Kulturore është e paraparë mënyra dhe kushtet për përfshirjen e Trashëgimisë Kulturore në Listën e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, sipas së cilës Trashëgimia Kulturore të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë do të implementohet pa diskriminim.

Lehtësimi dhe përkrahja e aktiviteteve që synojnë vetëdijësimin posaçërisht në mesin e rinisë së komuniteteve për trashëgiminë kulturore të këtyre komuniteteve

Përkrahja për organizimin e aktiviteteve të rregullta kulturore me dhe për pjesëtarët e tri komuniteteve në Qendrat për Kulturë dhe Informim

Përkrahja për organizimin e aktiviteteve kulturore që synojnë promovimin e vlerave multikulturore dhe multietnike

MKRS do të vazhdojë me implementimin e Politikave Programore për promovimin dhe përkrahjen e projekteve multi-etnike në të tri departamentet për integrimin sa më të mirë të Komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas

Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, do të krijohen kushtet për mbrojtjen dhe zhvillimin institucional të gjuhës rome nëpërmjet krijimit të Komisionit për gjuhën rome, zhvillimin e shkollave verore, seminareve, etj.

Institucionet relevante do të lehtësojnë shkrimin, shtypin dhe botimin e librave, gazetave dhe revistave në gjuhën romani dhe/apo të shkruar nga autorët e tri komuniteteve

MKRS do të vazhdoj implementimin e Politikave Programore edhe në të ardhmen për komunitetet, Romë, Ashkali dhe Egjiptianë lidhur me përkrahjen e botimit të librave në gjuhët e këtyre komuniteteve.

MKRS do të përkrah dhe ndërmerr masa afirmative për artistët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas, për trajnime dhe performanca të mëtutjeshme

MKRS dhe institucione tjera relevante do të përkrahin mbledhjen dhe botimin e CD-ve me këngë të vjetra rome

MKRS do të lehtësojnë dhe përkrah studimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve, përfshirë këtu edhe përdorimin e gjuhës, zanateve tradicionale rome dhe trashëgiminë tradicionale dhe kulturore të komuniteteve

MKRS dhe institucionet tjera relevante do të zbatojnë ngjarjen kulturore “Java e Kulturës së Komuniteteve Roma, Ashkali dhe Egjiptase”

MKRS do të mbështes dhe lehtësojë ligjëratat dhe prezantimet për kulturën, historinë dhe traditën e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptase

Autoritetet relevante do të lehtësojnë fushatat e informimit që promovojnë vlerat multikulturore

2.10. Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi⁷⁹

Përshkrimi i Gjendjes

Romët, ashkalijtë dhe egjiptasit janë të nënpërfaqësuar në shkallë dhe diskriminuar në shërbimin civil në nivelin qendror dhe atë lokal në Kosovë, në veçanti kur është fjala për pozitat udhëheqëse. Këto komunitete janë të nënpërfaqësuar në shërbimin civil nëpër komuna, përkundër faktit që *Politika e Financimit të Drejtë* i obligon autoritetet komunale ta alokojnë një përqindje të caktuar të buxhetit të tyre për shërbyesit civil nga radhët e komuniteteve pakicë.

Ky mekanizëm nuk e pasqyron përfshirjen proporcionale të komuniteteve të ndryshme që e karakterizojnë përbërjen multi-etnike të komunave. Rrjedhimisht, *Politika e Financimit të Drejtë* nuk siguron në masë të mjaftueshme përfshirjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase në shërbimin civil.

Arsyet për këtë përjashtim janë të shumta dhe përfshijnë, mungesën e arsimimit, e regjistrimit civil, dokumentacionit, diskriminimit. Megjithatë, qasja dhe përfaqësimi i barabartë në administratë publike është njeri prej parakushteve për pjesëmarrje të mirëfilltë në jetën publike.

Situata është e njëjtë edhe sa i përket legjislacionit në nivelin qendror dhe komunal në Kosovë. Prej 21 subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetet minoritare, 2 janë parti të komunitetit ashkali, një është parti rome dhe një egjiptase: Partia Demokratike e Ashkalijve të Kosovës (PDAK), Partia Demokratike e Ashkalijve Shqiptarë të Kosovës (PDSHK), dhe që nga maji i vitit 2008 Unioni Demokratik i Ashkalijve (BDA); Partia e Bashkuar e Romëve të Kosovës (PREBK) dhe partia egjiptase Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK).

Romët, ashkalijtë dhe egjiptasit së bashku kanë gjithsej katër ulëse të rezervuara në Kuvendin e Kosovës. Në zgjedhjet e fundit të përgjithshme në nëntor të vitit 2007, një rom, një egjiptas dhe tre

⁷⁹Në fillim, Grupi Punues që merrej me këtë kapitull ishte titulluar “Grupi Punues V Të Drejtat e Pakicave”. Gjatë seancës së parë të grupit punues, pjesëmarrësit vendosën ta kufizojnë temën e pjesëmarrjes së romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në jetën publike, përfshirë këtu edhe vendimmarrjen, meqë të gjitha të drejtat e tjera relevante mbulohen nga kapitujt e tjerë të kësaj Strategjie.

ashkalijë janë zgjedhur në Kuvendin e Kosovës⁸⁰. Prej subjekteve të komunitetit ashkali, PDAK-ja është partia e vetme që ka fituar tri ulëse në Kuvendin e Kosovës me rreth 3,443 vota. Ata kanë dy ulëse të rezervuara dhe një ulëse të fituar në Kuvend. Partia e Bashkuar e Romëve të Kosovës (PREBK) gëzon përkrahje të kufizuar nga komuniteti romë dhe ka fituar vetëm 600 vota në zgjedhjet e fundit, derisa partia egjiptase Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) ka fituar rreth 2,121 vota. Nuk ka asnjë rom, ashkali apo egjiptas që ka ulëse në Kuvendin e Kosovës dhe që nuk i përfaqëson këto tri komunitete.

Një përfaqësues i partisë egjiptase ishte edhe pjesëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor që përgatiti zgjedhjet e vitit 2007.

Këto tri komunitete mund të arrijnë përfaqësim më të mirë në Kuvendin e Kosovës (dhe të kenë më tepër ndikim), nëse formojnë koalicione zgjedhore apo parti të përbashkëta, me përfshirjen e mundshme edhe të grupeve tjera etnike. Një shenjë pozitive në këtë drejtim është krijimi i grupit të ri parlamentar “Koalicioni 7+” që përbëhet nga tre boshnjakë të Kosovës (VAKAT), tre turq të Kosovës dhe (KTDP) dhe një përfaqësues i komunitetit rom (PREBK). Në bazë të marrëveshjes së rotacionit në mes të këtyre tri subjekteve, përfaqësuesi rom e kryeson koalicionin në vitin 2008. Njëpërmjet ndërmarrjeve të ngjashme, komunitetet rome, ashkali dhe egjiptase mund ta forcojnë pozitën e komuniteteve të vogla në Kuvendin e Kosovës. “Koalicioni 7+” ka përfaqësim të gjerë në Komisionet Parlamentare, përfshirë këtu Komisionin Parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.⁸¹

IRDK-ja në mënyrë aktive promovon interesat e komunitetit egjiptas në Kuvendin e Kosovës, duke i shtruar pyetje Qeverisë gjatë seancave plenare të Kuvendit (për shembull për punësimin dhe përfaqësimin e pjesëtarëve të këtij komuniteti në Ministrinë e ndryshme). Në anën tjetër, PDAK-ja dhe PREBK-ja duket se janë tepër pak të involvuara në avokimin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve të tyre. Në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, të gjitha këto parti marrin pjesë në rishikimin e draft legjislacionit, por nuk janë aktive në avokimin e çështjeve që janë të rëndësishme për komunitetet e tyre siç është integrimi, qasja në regjistrimin civil, arsimi, punësimi dhe prona, kthimi, dhe shkollimi në gjuhën amtare. Mbikëqyrja e punës së qeverisë dhe e zbatimit të legjislacionit është e dobët në Kuvendin e Kosovës, gjë që rezultoi edhe në debatimin e zbatimit të vetëm katër ligjeve të legjislacionit të kaluar.

Përfaqësimi politik i romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në nivelin lokal është i pamjaftueshëm si në nivelin qendror ashtu edhe në ata lokal. Në shumicën e rasteve, këto komunitete nuk arrijnë ta fitojnë numrin minimal të votave që nevojiten për të fituar një vend në Kuvendet Komunale. Për shembull, në qytetin e Prizrenit ku komuniteti rom numëron mbi 5000 pjesëtarë, asnjë rom nuk është pjesëtar i Kuvendit Komunal.

Disa romë janë pjesëtarë të Komisioneve për Ndërmjetësim dhe Komunitete që merren me çështjet e pakicave. Prej numrit të përgjithshëm të 35 komunave, 22 komuna kanë së paku një përfaqësues rom, ashkali apo egjiptas në Komisionet për Ndërmjetësim dhe Komunitete⁸². Në 20 komuna mund të gjenden Komisionet për Ndërmjetësim që kanë së paku një pjesëtar nga këto tri

⁸⁰Prej 20 partive të regjistruara të pakicave, 13 ulëse të fituara në Kuvendin e Kosovës përfshijnë: gjashtë parti serbe, dy parti boshnjake, një parti turke, një parti gorane, një parti rome, një parti ashkali dhe një parti egjiptase.

⁸¹Ulëset kë komisionet parlamentare iu ndahen grupeve parlamentare në mënyrë proporcionale dhe meqë tre anëtarë nga komuniteti ashkali nuk i janë bashkangjitur asnjë grupi parlamentar, ata nuk kanë asnjë ulëse në komisione, përveç në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, përbërja e të cilit definohet në mënyrë të qartë nga Kushtetuta e Kosovës. Në këtë komision janë dy përfaqësues të komunitetit ashkali.

⁸²Në tetë nga 22 komuna, këto Komisionet kanë nga dy përfaqësues të këtyre komuniteteve: dy ashkali në Podujevë, dy egjiptas në Klinë, dy egjiptas në Deçan, një ashkali dhe një rom në Vushtri, dy egjiptas në Gjakovë, dy romë në Rahovec, dy ashkalinj dhe një rom në Suharekë, një ashkali dhe një rom në Ferizaj.

komunitete. Përveç kësaj, në 14 komuna, përfaqësues të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase janë të punësuar në Zyrat për Komunitete.

Përfaqësimi i dobët politik është pjesërisht rezultat i faktit që rreth 20 – 40% të 35,000 romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të Kosovës nuk kanë status të regjistruar civil e as dokumente personale. Këta persona nuk janë të regjistruar në listat e votuesve dhe nuk mund të votojnë.

Për më tepër, romët që jetojnë në enklavat serbe në veri të Lumit Ibër duhet t'i ndjekin “udhëzimet politike” të komunitetit serb për të marrë pjesë në zgjedhje. Edhe në disa zona me shumicë shqiptare, pjesëtarët e këtyre tri komuniteteve shpesh preferojnë të votojnë për partinë më të fuqishme politike në nivelin lokal.

Mungesa e regjistrimit të këtyre komuniteteve gjithashtu mund të ndikojë negativisht në aftësinë e tyre për t'u kualifikuar për të drejtat specifike të komuniteteve⁸³, në të gjitha rastet kur masat speciale apo masat e veprimit pozitiv të komuniteteve pakicë i nënshtrohen arritjes së pragut të caktuar demografik. Ndërkohë nuk ka të dhëna të sakta për përfaqësimin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në sektorin e gjyqësorit.

Zhvendosja e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve dhe shkatërrimi i vendbanimeve të tëra si pasojë e luftës pati ndikim shkatërrues në pjesëmarrjen e tyre politike si dhe në organizatat e shoqërisë civile që promovojnë interesat dhe të drejtat e këtyre komuniteteve. Që nga viti 2000, janë bërë përpjekje të ndryshme për të themeluar përfaqësimin e shoqërisë civile të këtyre komuniteteve, siç është rasti i Forumit të Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptasve të Kosovës (KRAEF)⁸⁴, Qendra për Dokumentim e Romëve dhe Ashkalijve (RADC)⁸⁵ dhe Rrjeti i Femrave Rome, Ashkali dhe Egjiptase⁸⁶. Këto organizata ombrellë kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin e kësaj Strategjie dhe luajnë rol thelbësor në avokimin për përfshirjen e çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat dhe integrimin e komuniteteve të tyre në agjendën politike.

Kjo Strategji është dokumenti i parë përmbajtjesor dhe sistematik që synon ta përmirësoj gjendjen e vështirë të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të Kosovës dhe të promovoj përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Këto politika dhe planet e tyre të veprimit mund të jenë të suksesshme vetëm me pjesëmarrjen aktive të romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në zbatimin e tyre dhe nëse këto komunitete marrin pjesë në trupat dhe institucionet respektive që trajtojnë brengat e komuniteteve të tyre.

Vajzat dhe gratë duhet të kenë mundësi të barabarta dhe zëri i tyre duhet të dëgjohet në këtë proces. Përkundër ekzistimit të rrjetit të gruas rome, ashkallike dhe egjiptase dhe me përjashtimin e disa grave që kanë arritur të fitojnë pozita për të folur në emër të komunitetit të tyre, gratë rome, ashkallike dhe egjiptase kanë përfaqësim dhe ndikim të pamjaftueshëm në subjektet politike dhe në shoqërinë civile. Ato gjenden me pakicë në pozitat e zgjedhura dhe në shërbimin civil. Çështja e barazisë gjinore prek thellë mbarë shoqërinë kosovare përfshi këtu tre komunitetet në fjalë dhe duhet të adresohet nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptase edhe në kuadër të pjesëmarrjes politike dhe civile.

Korniza Politike dhe Dokumentet e Referimit

Në Kosovë ekzistojnë disa masa afirmative për të siguruar përfaqësimin e komuniteteve pakicë në nivelin qendror dhe lokal siç është rasti i ulëseve të rezervuara në Kuvendin e Kosovës dhe në

⁸³Për shembull për njohjen dhe përdorimin e gjuhës së pakicave nga autoritet komunale, Shih: Ligji Nr. 02/L-37 i Kuvendit të Kosovës, mbi Përdorimin e Gjuhës, i miratuar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/51 më 20 tetor 2006.

⁸⁴ KRAEF është aktiv që nga viti 2000.

⁸⁵ RADC është operacional që nga viti 2004.

⁸⁶ Rrjeti i Femrave Rome, Ashkali dhe Egjiptase u formua në vitin 2000.

komisionet parlamentare,⁸⁷ apo përfshirja e tyre e garantuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Në nivelin komunal, komunitetet pakicë janë të përfaqësuara në Komisionet për Komunitete dhe Ndërmjetësim të Kuvendeve Komunale apo në Zyrat Komunale për Komunitete. Megjithatë, sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale këto zyra nuk parashihen dhe nuk ekzistojnë dispozita ligjore që garantojnë pjesëmarrje në kuvendet komunale apo çfarëdo forme tjetër të pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse në nivelin lokal.

Sic ka dëshmuar mospromovimin e *Politikës së Financimit të Drejtë*, zbatimi efikas i këtyre mekanizmave dhe masave megjithatë është qenësor për promovimin apo mospromovimin e pjesëmarrjes efektive.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës rregullon sistemin e ndarjes së pushtetit në nivelin qendror duke iu mundësuar komuniteteve pakicë të jenë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës nëpërmjet ulëseve të rezervuara (prej numrit të përgjithshëm të 120 ulëseve, 20 janë ulëse të rezervuara dhe prej tyre katër ulëse janë të rezervuara për subjektet politike romë, ashkali dhe egjiptase).

Përbërja e Kryesisë së Kuvendit gjithashtu bazohet në sistemin e ndarjes së pushtetit, dhe e mundëson përfaqësimin e tetë anëtarëve përfshirë një anëtarë nga komuniteti serb i Kosovës dhe një anëtar nga një komunitet tjetër pakicë.

Çdo komunitet, pa marrë parasysh madhësinë demografike dhe përfaqësimin politik, do të përfaqësohet nga dy përfaqësues në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.⁸⁸ Kuvendi i Kosovës ka gjithsej njëmbëdhjetë Komisione. Me përjashtim të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, përfaqësimi në këto Komisione është proporcional me numrin e ulëseve që çdo parti ka në Kuvend.

Kushtetuta gjithashtu siguron që në çdo kohë së paku dy Ministri do t'iu takojnë komuniteteve që nuk e kanë shumicën e ulëseve në Kuvend. Njëra prej këtyre Ministrive do t'i takoj komunitetit serb të Kosovës dhe tjetra një komunitet tjetër pakicë të Kosovës.

Kushtetuta vazhdon të ruaj sistemin e lartpërmendur të ndarjes së pushtetit për dy mandate të Kuvendit të Kosovës. Përbërja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve megjithatë do të ndryshoj në disavantazh të komuniteteve tjera. Në vend të dy anëtarëve për çdo komunitet, komunitetet shqiptare dhe serbe të Kosovës do të kenë nga tre përfaqësues, përderisa komunitetet e tjera do të duhet të ndajnë tri ulëse. Në mënyrë të pashmangshme, komunitetet romë, ashkali dhe egjiptase do të vuajnë si pasojë e kësaj dhe do të jenë më pak të përfaqësuara në këtë Komision.

Kushtetuta dhe Ligji për Komunitetet kanë krijuar një hapësirë institucionale për konsultimin e organizatave të shoqërisë civile të komuniteteve pakicë: Këshilli Konsultativ për Komunitete (Neni 60). Ky potencial do të përmbushet nëse organizatat e shoqërisë civile nga komunitetet pakicë përfshirë ashkalijtë, egjiptasit dhe romët e Kosovës, kanë mundësi të mirëfilltë të marrin pjesë në nominimin dhe emërimin e pjesëtarëve të tyre në këtë Këshill, dhe nëse këto organizata vazhdimisht konsultohen për nevojat dhe brengat e komuniteteve.

Krijimi i Zyrës për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit është një mjet produktiv për romët, ashkalijtë dhe egjiptasit e Kosovës dhe këto komunitete do të jenë të përfshira dhe do të konsultohen për aktivitetet e kësaj zyre.

⁸⁷Kuvendi i Kosovës ka 11 Komisione, dhe prej tyre Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit është njëri prej dy komisioneve kryesore të Kuvendit të Kosovës. Çdo komunitet i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës ka së paku një përfaqësues në këtë Komision. Komisioni i mbikëqyr Qeverinë me anë të rishikimit të draft legjislativ dhe vizitave në terren për të monitoruar zbatimin e ligjeve. Gjatë mandatit të kaluar të Kuvendit të Kosovës, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka rishikuar 148 draft ligje.

⁸⁸ Komunitetet e përfaqësuara me vetëm një anëtar do të përfaqësohen nga ky anëtar në këtë Komision.

Aktualisht, instrumentet kryesore për mbrojtjen e të drejtave të pakicave në nivelin lokal janë Komisionet e Komuniteteve dhe Komisionet për Ndërmjetësim. Së bashku me Zyrat Komunale për Komunitete, këto komisione janë ndërtuar si mekanizma anti-diskriminuese për mbrojtjen e komuniteteve për të siguruar që çdo komunitet lokal, pa marrë parasysh madhësinë, gjuhën, fenë, prejardhjen etnike apo çfarëdo karakteristikë tjetër të pjesëtarëve të tij, do të ketë trajtim të barabartë nga autoritetet komunale.

Dispozitat specifike që përcaktojnë mandatin dhe përbërjen e Komisioneve të Komuniteteve dhe atyre për Ndërmjetësim, si dhe Zyrat Komunale për Komunitete, janë të definuara në Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30 mbi Vetëqeverisjen Lokale të Komunave në Kosovë.⁸⁹

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2007/30, komunat ku jetojnë një apo më tepër komunitete pakicë, Kuvendi Komunal do të emëroj një nënkryetar të dytë nga këto komunitete në mesin e Pjesëtarëve të Kuvendit Komunal. Në rast se këto komunitete nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin Komunal, Kuvendi në konsultim me komunitetet respektive do të emëroj një person nga këto komunitete që të shërbej si nënkryetar, si pjesëtar pa të drejtë vote i cili do të ketë drejtë të marrë pjesë dhe të flas në seancat e Kuvendit Komunal dhe të Komisioneve të tij.

Masat

Niveli qendror dhe lokal

Institucionet kosovare do të promovojnë pjesëmarrjen e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase në jetën publike dhe politike. Femrat rome, ashkallike dhe egjiptase duhet të kenë mundësi të marrin pjesë në mënyrë të barabartë me meshkujt në procesin e konsultimeve dhe në mekanizmat e tjerë për qasje më të mirë në të gjitha fushat e jetës publike dhe politike.

Institucionet qeverisëse qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës do të:

sigurojnë përfaqësim të barabartë të romëve, ashkallijve dhe egjiptasve në shërbimin civil, duke përfshirë edhe zbatimin e masave afirmative për promovimin e pjesëmarrjes së tyre në shërbimin civil dhe raportimin e rregullt për përfaqësimin e përmirësuar të këtyre komuniteteve.

sigurojnë që *Politika e Financimit të Drejtë* zbatohet në tërësi në nivelin lokal.

sigurojnë përfshirjen adekuate të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase në proceset formale të konsultimit, dhe pjesëmarrjen e tyre në masat politike që ndikojnë në komunitetet e tyre.

fuqizojnë dhe integrojnë individët nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptase në proceset vendimmarrëse të të gjitha niveleve si përfaqësues të zgjedhur të komuniteteve të tyre.

themelojnë mekanizma për të siguruar komunikimin e barabartë, të drejtpërdrejt dhe të hapur në mes komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptasë dhe autoriteteve qeveritare, përfshirë këtu edhe trupat këshillues dhe konsultativ.

organizojnë fushata të vetëdijesimit për zgjedhje për të rritur pjesëmarrjen e elektoratit romë, ashkali dhe egjiptas në zgjedhje.

sigurojnë që votuesit romë, ashkali dhe egjiptas të mund të marrin vendime të lira, të sigurta dhe të informuara gjatë zgjedhjeve.

sigurojnë që femrat votuese rome, ashkali dhe egjiptase kanë qasje dhe mund të marrin vendime të lira, të sigurta dhe të informuara gjatë zgjedhjeve, duke adoptuar edhe pengimin e të ashtuquajturit “votim familjar”.

⁸⁹ Ligjet tjera relevante janë: *Ligji për Zgjedhjet Komunale*; *Ligji Special për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë*; *Ligji mbi Administrimin e Kufijve Komunal*.

rishikojnë sistemin aktual të përfaqësimit politik në nivelin lokal për të mundësuar apo përmirësuar pjesëmarrjen e romëve, ashkallijve dhe egjiptasve.

sigurojnë alokimin e mjaftueshëm buxhetor për zbatimin e Strategjisë në baza vjetore dhe në plan afatgjatë.

sigurojnë lirinë e lëvizjes dhe qasjen e sigurte për udhëheqësit politik romë, ashkali dhe egjiptas tek grupet e synuara në enklava.

Sigurojnë lirinë e lëvizjes dhe pjesëmarrjen e sigurtë të votuesve romë, ashkali dhe egjiptas në enklava (nëse është e nevojshme edhe nëpërmjet qendrave mobile të votimit në afërsi të vendbanimeve romë, ashkali dhe/apo egjiptase).

Shoqëria Civile dhe Partitë Politike

Partitë politike të komuniteteve ashkallike, egjiptase dhe romë duhet t'i konsultojnë organizatat e shoqërisë civile të komuniteteve të tyre për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve dhe të avokojnë në mënyrë proaktive për të drejtat e komuniteteve në seancat plenare të Kuvendit dhe në Komisionet Parlamentare.

Shoqëria civile do të marrë pjesë në mënyrë aktive në fushatat për informimin e votuesve për komunitetet roma, ashkali dhe egjiptase

2.11. Siguria (Puna policore)

Përshkrimi i Gjendjes

Policia e Kosovës (Shërbimi Policor i Kosovës SHPK) u formua në shtator të vitit 1999 në pajtim me Rezolutën 1244 të Misionit të Kombeve të Bashkuara. Policia e Kosovës mëton të përfaqësojë multi-etnicitetin e Kosovës përbrenda forcës policore. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nëni 61 komunitetet dhe pjesëtarët tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë edhe në shërbimin policor në zonat e banuar me komunitetin përkatës. Që nga viti 1999, rreth 50 romë, ashkallijë dhe egjiptas (0.50% prej të gjithë të diplomuarve) kanë diplomuar nga Qendra Kosovare për Edukim dhe Zhvillim të Sigurisë Publike (KCPSED).⁹⁰ Aktualisht, Policia e Kosovës ka 7119 pjesëtarë (përfshirë Policinë Kufitare dhe pa i përfshirë punonjësit civil)⁹¹. Prej këtij numri, vetëm 50 policë i përkasin komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase, përfshirë 21 meshkuj dhe një femër romë; gjashtë meshkuj dhe një femër egjiptase dhe 21 meshkuj. Sipas këtyre të dhënave, në vitin 2007 vetëm 0.70% prej të gjithë policëve kosovarë ishin pjesëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase, përderisa këto komunitete përbëjnë përafërsisht në mes 1.46 – 1.75% të popullsisë së Kosovës (duke mos i përfshirë këtu rreth 100,000 persona të zhvendosur dhe refugjatë romë, ashkali dhe egjiptas që akoma nuk janë kthyer në Kosovë).

Numri i saktë i romëve, ashkallijve dhe egjiptasve, megjithatë, mund të dallojë. Deri vonë, dokumentacioni i aplikueshëm i ka paraparë vetëm këto kategori: “shqiptar”, “serb”, “romw”, “goran”, “turq”, “boshnjak” dhe “të tjerë”. Prandaj, aplikuesit ashkali dhe egjiptas që i janë bashkangjitur programit trajnues KCPSED mund të identifikohen vetëm në bazë të kategorive të lartpërmendura. Megjithatë, kur këta pjesëtarë i bashkohen Policisë së Kosovës ata kanë rastin dhe mundësinë të identifikohen si pjesëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase. Frika nga etiketimi i përkatësisë së një komuniteti të marginalizuar i cili është potencialisht i

⁹⁰ Në përgjithësi, 8159 kadetë kanë diplomuar që nga viti 1999.

⁹¹ Sipas të dhënave të SHPK-së të datës 8 shkurt 2008, numri i përgjithshëm i 7119 policëve përfshin 6011 shqiptarë, 21 ashkallijë, 215 boshnjakë të Kosovës, 5 qerkez, 3 kroatë të Kosovës, 7 egjiptas, 38 goran, 1 maqedon, 22 romë, 710 serbë të Kosovës, dhe 86 turq.

diskriminuar mund të jetë njëra prej arsyeve pse pjesëtarët e policisë mund të identifikohen edhe si pjesëtarë të komunitetit shumicë. Në anën tjetër, nuk mund të përjashtohet mundësia që personat që nuk i takojnë asnjëri prej këtyre tri grupeve, i janë bashkuar Policisë së Kosovës nën pretekstin se janë romë, ashkali apo egjiptas.

Në Policinë e Kosovës nuk ekziston sistemi i kuotës për ta rritur përfaqësimin e komuniteteve minoritare. Megjithatë, Policia e Kosovës ka një bankë të dhënash me të dhënat e ndara etnike për stafin e saj përfshirë Policinë Kufitare (përveç punonjësve civil) dhe përpiqet të inkurajojë pjesëtarët dhe femrat e komuniteteve minoritare që të aplikojnë në Policinë e Kosovës nëpërmjet konkurseve specifike për punë në mënyrë që të krijohet një forcë policore e balancuar në aspektin gjinor dhe etnik. Aktualisht, Policia e Kosovës (përveç punonjësve civil) ka rreth 85% shqiptarë, rreth 10% serbë të Kosovës dhe 5% të komuniteteve tjera.

Policia e Kosovës nuk ka të dhëna të ndara etnike për pozitat e këtyre pjesëtareve. Megjithatë, sipas Policisë së Kosovës, asnjë pjesëtar romë, ashkali apo egjiptas i policisë nuk ka post më të lartë se kapiten/komandant i stacionit.⁹² Fakti që këto komunitete në masë të madhe nuk kanë edukim formal (shih gjithashtu kapitullin për edukim) gjithashtu kontribuon në nën-përfaqësimin e tyre në nivelet më të larta të Policisë së Kosovës.

Policia e Kosovës është e formuar mbi bazat e filozofisë së policisë së komunitetit dhe strategjive organizative. Rrjedhimisht, çdo stacion i Policisë së Kosovës ka Policë të Komunitetit. Policia e Kosovës gjithashtu ka patrulla multi-etnike për zonat e banuara me popullsi joshqiptare. Aktualisht Policia e Kosovës ka 139 Policë të Komunitetit.⁹³ Në mesin e tyre janë një ashkali dhe dy egjiptas. Kosova ka një numër lagjesh me popullsi të konsiderueshme romë, ashkali dhe egjiptase. Për ta ndërtuar besimin dhe përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike në mes të këtyre komuniteteve dhe Policia e Kosovës në nivelin lokal, duhet punësuar një numër adekuat i policëve romë, ashkali dhe egjiptas në mesin e Policëve të Komunitetit.

Përveç promovimit të përfaqësimit etnik, trajtimit të barabartë, përparimit në karrierë dhe respektimit për pjesëtarët e pakicave përbrenda Policisë së Kosovës, është esenciale që Policia e Kosovës të ketë trajnime për çështjet e pakicave dhe marrëdhëniet ndëretnike përfshirë vetëdijësimin për dallimet kulturore të komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptase në Kosovë. Trajnimet aktuale përfshijnë modulet për ‘Punën Policore në Shoqërinë Multi-etnike’ dhe ‘Të Drejtat e Njeriut’ për të siguruar që Policia e Kosovës e zbaton ligjin në mënyrë të paanshme dhe jodiskriminuese për të gjitha komunitetet.

Korniza Politike dhe Dokumentet e Referencës

SHPK-ja është e obliguar me ligjin ndërkombëtarë dhe lokal ta respektojë principin e mosdiskriminimit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 3 dhe neni 24 rregullon “barazinë para Ligjit dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë përfshirë komunitetet”⁹⁴. Principi i mosdiskriminimit theksohet edhe në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/54 për Kornizën dhe Principet Udhëzuese të Shërbimit Policor të Kosovës⁹⁵, që thotë se SHPK-ja do të udhëhiqet në mes tjerash nga “Mos-Diskriminimi: Asnjë diskriminim, i drejtpërdrejt apo i tërthortë, i bazuar në gjini, ngjyrë, gjuhë, besim fetar, mendim politik, prejardhje nacionale, etnike apo sociale, përkatësi në një komunitet, pronë, lindje, paaftësi, status

⁹² OSBE-ja i ka marrë këto informata nga zëdhënësi i SHPK-së Veton Elshani më 11.04.2008

⁹³ 139 Policët e Komunitetit përbëhen nga: 109 shqiptarë, 17 serbë të Kosovës, 1 goran, 6 boshnjakë të Kosovës, 2 malazez, 1 ashkali, 2 egjiptas, 1 turk i Kosovës.

⁹⁴ Seksioni 3., Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje shih: Udhëzimi Administrativ Nr. 2006/9 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/54 për Kornizën dhe Principet Udhëzuese të Shërbimit Policor të Kosovës.

⁹⁵ Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2005/54 për Kornizën dhe Principet Udhëzuese të Shërbimit Policor të Kosovës, e miratuar më 20 dhjetor 2005.

familjar, shtatzëni, orientim seksual, moshë apo çfarëdo statusi tjetër.”⁹⁶ Kjo theksohet edhe në Manualin Politik dhe Procedural të SHPK-së Seksioni I. P – 1.23..

Rregullorja e UNMIK-ut nr 2005/54 thotë që SHPK-ja do të udhëhiqet nga principi i përfshirjes dhe që “Rekrutimi në të gjitha nivelet e Shërbimit Policor të Kosovës do të pasqyrojë karakterin multi-etnik të Kosovës dhe nevojën për përfaqësim të barabartë të të gjitha komuniteteve në Kosovë [...]”⁹⁷ Për më tepër, Seksioni 4.5. i Rregullores thotë që: “Shërbimi Policor i Kosovës do të sigurojë që përbërja e policëve në çdo zonë pasqyron komunitetet lokale të cilëve ju shërbejnë ata, si dhe karakterin e përgjithshëm multi-etnik të Shërbimit Policor të Kosovës [...]”.

”Procedura dhe rekrutimi i komuniteteve në forcën policore, është i rregulluar me Ligjin mbi Policinë Nr.03-L-035/2008 neni 2 pika g parasheh : përkushtimi ndaj punësimit, avancimit dhe caktimit të detyrave në mënyrë gjithëpërfshirëse, meritore dhe pa diskriminim, duke reflektuar karakterin shumë-etnik në Republikën e Kosovës dhe duke i njohur parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, neni 11 dhe neni 34 i po këtij ligji përmban dispozitat që kane të bëjnë me komunitetet, mbrojtjen respektivisht përfaqësimin e tyre në polici.

Përveç kësaj, Kodi Europian i Etikës Policore i Këshillit të Evropës, specifikon në Seksionin 25 që “procedurat e rekrutimit do të përqendrohen në baza jodiskriminuese” dhe që “politikat do të synojnë të rekrutojnë meshkuj dhe femra nga pjesët e ndryshme të shoqërisë përfshirë edhe grupet e pakicave etnike, me qëllimin e përgjithshëm që personeli i policisë të jetë pasqyrë e shoqërisë të cilës i shërben.” Kjo theksohet edhe në KPS PMM, Seksioni I. P - 1.23 i cili thotë që “Të gjithë nëpunësit e SHPK-së, pa asnjë diskriminim, gëzojnë të drejta dhe liri të barabarta njerëzore. SHPK-ja ofron përfaqësim korrekt të komuniteteve për punësim dhe avancim në të gjitha nivelet”. Për më tepër, Kodi Evropian për Etikën Policore aplikohet në SHPK në bazë të KPS PM në Seksionin I. P-1.13. Përveç kësaj, KPS PPM thotë që “organizata policore do të pasqyrojë shoqërinë të cilës i shërben, në veçanti, multi-etniciteti i Kosovës duhet të përfaqësohet përbrenda policisë.”

Masat

Rekrutimi

Policia e Kosovës do të :

formojë një databazë qendrore me të dhëna të ndara etnike, përfshirë të gjitha nivelet, për të siguruar që mund të maten synimet dhe rritja e përfaqësimit multi-etnik në Policinë e Kosovës.

përcaktojë politika të qarta për rekrutimin dhe mbajtjen e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Policinë e Kosovës .

zhvillojë fushata të vetëdijesimit të përqendruara në komunitetet pakicë për ti inkurajuar ata të aplikojnë në Policinë e Kosovës .

rris numrin e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve në Policinë e Kosovës si dhe të policëve nga këto komunitete për Punë Policore në Komunitete për të operuar në vendet që banohet nga një numër domethënës i romëve, ashkalijve dhe egjiptasve.

ofrojë trajnime specifike përgatitore për aplikuesit romë, ashkalijë dhe egjiptas në Policinë e Kosovës për t’i përgatitur ata për testin e pranimit në Policinë e Kosovës .

sigurojë që romët, ashkalijtë dhe egjiptasit janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate në të gjitha nivelet, përfshirë këtu edhe nivelet e larta. Nëse është e nevojshme, Policia e Kosovës do të

⁹⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2005/54, Seksioni 1.2 (g)

⁹⁷ Seksioni 1.2 (h) Rregullorja e UNMIK-ut 2005/54

përdor masat afirmative – siç parashihet edhe në Kushtetutë– për të arritur përfaqësim adekuat të tri komuniteteve në pozitën e larta.

sigurojë që policët romë, ashkali dhe egjiptas, si dhe policët që janë pjesëtarë të komuniteteve tjera minoritare, janë të vetëdijshëm për mekanizmat ekzistues të ankesave në Njësitin e Standardeve Profesionale (NSP) dhe t'i përdorin këta mekanizma në rast se ballafaqohen me çfarëdo forme të diskriminimit.

sigurojë një mjedis neutral të punës prej të cilit të gjithë nëpunësit pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike mund të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë diskriminim.

Trajnimi

Policia e Kosovës do të elaborojë, kudo që është e nevojshme, dhe në partneritet të ngushtë me organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare romë, kodin e mirësjelljes, manualët udhëzues praktikë dhe programet e trajnimit për ndjeshmërinë e komuniteteve minoritare dhe punën efektive policore në shoqëritë multietnike.

Policia e Kosovës do të përfshijë përfaqësuesit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase në zhvillimin dhe ofrimin e programeve të trajnimit për policë për çështje të pakicave dhe për marrëdhënie ndëretnike.

Autoritetet relevante do të hartojnë politika që promovojnë vetëdijësimin në mesin e institucioneve për zbatimin e ligjit për gjendjen e romëve, ashkalijve dhe egjiptasve për t'iu kundërvënë paragjytimeve dhe stereotipeve negative që ekzistojnë kundër këtyre komuniteteve.

Praktikat Operacionale

Policia e Kosovës:

do ta vlerësojë zbrazëtinë në mes standardeve ndërkombëtare për punën policore dhe praktikave ekzistuese kombëtare në konsultim me forcat kombëtare të policisë, OJQ-të dhe përfaqësuesit e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptase.

do të bashkëpunojë dhe kërkojë, nëse është e nevojshme, ndihmën e Njësisë për Çështje Strategjike Policore në Sekretariatit e OSBE-së, Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare dhe Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat Njerëzore për zhvillimin e programeve të synuara dhe masave për ndërtimin e besimit, p.sh. Punën Policore në Komunitetet Minoritare, për përmirësimin e marrëdhënieve në mes romëve, ashkalijve dhe egjiptasve dhe policisë, posaçërisht në nivelin lokal.

do të hartojë politika dhe procedura për të siguruar përgjigje efektive policore ndaj dhunës racore kundër romëve, ashkalijve dhe egjiptasve.

do të hartojë politika për të: (1) përmirësuar marrëdhëniet në mes romëve, ashkalijve dhe egjiptasve dhe policisë, për ta parandaluar abuzimin dhe dhunën policore kundër romëve, ashkalijve dhe egjiptasve, dhe (2) për ta përmirësuar besimin e këtyre komuniteteve në punën e policisë.

do të sigurojë zbatimin efikas të ligjit kundër diskriminimit dhe do të inkurajojë raportimin e krimeve të urrejtjes etnike për të siguruar që ato të regjistrohen dhe hetohen.

do të sigurojë hetime dhe procedura efektive, të paanshme dhe jodiskriminuese të rasteve të dhunës policore apo çfarëdo akti diskriminues nga ana e policisë kundër ndonjë pjesëtari të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase.

do të sigurojë që policia do ta zbatojë ligjin në mënyrë jodiskriminuese dhe të paanshme, dhe që kryesit e veprave diskriminuese apo veprave të dhunës do të sillen para drejtësisë, *në mes tjerash*, duke ndërmarrë veprime të shpejta dhe efektive hetuese.

do ta shfrytëzojnë mundësinë e krijimit të Këshillave Lokal për Siguri Publike (KLSP) siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54, Seksioni 7 në fshatrat apo lagjet me popullsi të konsiderueshme romë, ashkali dhe egjiptase për ta përmirësuar përshtypjen e sigurisë në mesin e pjesëtarëve të këtyre tri komuniteteve.

Miratimi, Monitorimi, Raportimi dhe Zbatimi i Strategjisë

Strategjia për integrimin e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në Kosovë, përbën dokumentin themelor të politikave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve dhe do të zbatohet gjatë periudhës kohore 2009 -2015.

Pas miratimit të Strategjisë për integrimin komunitetëve romë, ashkali dhe egjiptas në Kosovë, 2009 – 2015, nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të zbatohet nga Ministria për Kthim dhe Komunitete dhe ministritë tjera të linjës, agjensionet tjera relevante dhe në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Zyra e Kryeministrit e Republikës së Kosovës- Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me Zyrën për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit, dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës- Zyra për Qeverisje të Mirë është organi i ngarkuar, që në bashkëpunim dhe bashkërendim me institucionet e tjera, gjatë vitit 2009 do të bëjë përpilimin e Planit të Veprimit përkatës për zbatimin e kësaj strategjie.

Në përputhje me objektivat specifike të përcaktuara sipas çdo sektori prioritar të Strategjisë për integrimin e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në Kosovë, Plani i Veprimit do të reflektojë dhe përcaktojë masat specifike dhe konkrete për secilin institucion përgjegjës, së bashku me tregues suksesi të prekshëm dhe periudhë kohore të qartë.

Me qëllim të zbatimit dhe realizimit të masave të parapara në Planin e Veprimit për integrimin e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në Kosovë, do të llogaritet implikimi financiar për çdo masë dhe mbështetja e duhur financiare e cila duhet të jepet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Ne përfundim, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës - Zyra për Qeverisje të Mirë, është organi përgjegjës i cili raporton mbi zbatimin e përgjithshëm të Strategjisë për integrimin e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve në Kosovë, dhe në të njëjtë kohë shërben si Sekretariat. Në lidhje më këtë, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës - Zyra për Qeverisje të Mirë, i raporton direkt Qeverisë së Republikës së Kosovës, në baza periodike çdo 6 muaj.⁹⁸

⁹⁸ Procedurat administrative si dhe përshkrimi i detyrave i sipërpërmendur janë derivat i rekomandimeve të nxjerra prej studimi të titulluar një "Një plan veprimi ligjor për strategjinë roma, ashkali, egjiptas" të sponsorizuar prej Bashkimit Evropian dhe të administruar prej Agjencionit Evropian për Rindërtim Bernard-Guele/66/CARDS/KOS.EAR

